



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI AKADEMIK

Nr. 4567 prot.

Shkodër, më 17. 12. 2025

V E N D I M

Nr. 333, datë 17. 12. 2025

"Për miratimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë për vitin akademik 2024-2025"

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 38, pika 1, germa j; Statutin e USH-së Neni 17, pika 6, germa h, Neni 24, pika 2, Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim Raportin e cilësisë së brendshme për vitin akademik 2024-2025, në mbledhjen e tij të datës 17.12.2025

Vendosi:

1. Të miratojë Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë për vitin akademik 2024-2025 (materiali bashkangjitur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Tonia GJURAJ





UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM INSTITUCIONAL 2024 – 2025

GRUPI I VETËVLERËSIMIT

1. Dr. Rezearta Murati;	Kryetar
2. Prof.as dr. Alva Dani (FGJH);	Anëtar
3. Prof.as.dr. Ardita Boriçi (FE);	Anëtar
4. Prof.as.dr. Emanuela Furramani (FD);	Anëtar
5. Dr. Nevila Bushati (FSHN);	Anëtar
6. Dr. Dritan Rrustja (FSHSH);	Anëtar
7. Dr. Arlinda Ymeri (FSHE);	Anëtar
8. Manjola Lulaj (Specialiste e ALUMNI);	Anëtar
9. Prof. dr. Gëzim Dibra (Ekspert i jashtëm);	Anëtar
10. Arba Lohja (Student, Msc.);	Anëtar
11. Ambra Hysa (Student, Msc.).	Anëtar

Përgatitën për grupin e vetëvlerësimit:

Prof. dr. Mimoza Priku
Dr. Ermira Ymeraj
Msc. Olta Smajli

Shkodër, 2025

Përmbajtja e lëndës

SHKURTIME	3
HYRJE NË PROCESIN E VETËVLERËSIMIT	4
HISTORIKU LIAL	5
ORGANIGRAMA E USH DHE HISTORIKU I FAKULTETEVE	6
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOOËRORE	7
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS	8
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT	19
FAKULTETI I DREJTËSISË	14
FAKULTETI EKONOMIK	15
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA	18
VETËVLERËSIMI PËRKUNDREJT FUSHAVE TË VLERËSIMIT PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL	20
I- INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË, MENAXHIMI, AUTONOMIA DHE SIGURIMI I CILËSISË;	22
II- BURIMET DHE PARTNERITETI;	33
III- PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI;	51
IV- AKTIVITETI SHKENCOR/ARTISTIK DHE INOVACIONI;	64
V- STUDENTËT DHE MBËSHTETJA NDAJ TYRE,	75
ANALIZA SWOT	87
PIKA TË FORTA	87
PIKA TË DOBËTA	88
MUNDËSITË	89
RREZIOET	90
LEGJENDA E EVIDENCAVE	91

Treguesi i tabelave

Tabela 1. Skedë informuese për Universitetin “Luigj Gurakuqi”	6
Tabela 2. Skedë informuese për FSHSH-në	7
Tabela 3. Skedë informuese për programet e studimit që ofron FSHSH-ja	8
Tabela 4. Skedë informuese për FSHN-në	10
Tabela 5. Skedë informuese për programet e studimit që ofron FSHN-ja	11
Tabela 6. Skedë informuese për FSHE	12
Tabela 7. Skedë informuese për programet e studimit që ofron FSHE-ja	13
Tabela 8. Skedë informuese për FE-në	15
Tabela 9. Skedë informuese për programet e studimit që ofron FE-ja	15
Tabela 10. Skedë informuese për FD-në	17
Tabela 11. Skedë informuese për programet e studimit që ofron FD-ja	17
Tabela 12. Skedë informuese për FGJH-në	19
Tabela 13. Skedë informuese për programet e studimit që ofron FGJH-ja	19
Tabela 14. Skedë informuese për rekrutimin e pedagogëve të brendshëm.	21

Shkurtime

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
LAL	Ligji për Arsimin e Lartë
MA	Ministria e Arsimit (MAS)
USH	Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
ILP	Instituti i Lartë Pedagogjik
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
KSGC	Komisioni i Sigurimit dhe Garantimit të Cilësisë
AMS	ASCAL Managment System
FSHSH	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
FSHN	Fakulteti i Shkencave të Natyrës
FSHE	Fakulteti i Shkencave të Edukimit
FD	Fakulteti i Drejtësisë
FE	Fakulteti Ekonomik
FGJH	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
BUSH	Biblioteka e Universitetit të Shkodrës
SSC	Sektori i Sigurimit të Cilësisë
DKSC	Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë
BA	Bordi i Akreditimit

Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit

Bazuar në ligjit 80/2015, nenin nr. 130 të “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, si dhe në “Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë”, miratuar me VKM nr. 824, datë 24.12.2021, është krijuar grupi për Vlerësimin e Brendshëm të USH-së, me vendim nr. 320, datë 2.12.2025, të Rektorit të USH-së. (Evidenca A).

SSC-ja kryen prej disa vitesh në mënyrë sistematike procesin e vetëvlerësimit institucional, si pjesë e angazhimit të saj për zhvillimin dhe forcimin e mekanizmave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Gjatë vitit akademik 2024–2025, në institucion është ristrukturuar Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ajo është e përbërë nga 11 anëtarë: 7 pedagogë, 1 përfaqësues nga ALUMNI, 2 studentë dhe 1 ekspert i jashtëm. Ky ristrukturim synon të garantojë një përfaqësim gjithëpërfshirës dhe të balancuar të aktorëve kryesorë institucionalë, si dhe të ndërtojë qëndrueshmëri në diskutim, analizë dhe ndjekjen e mekanizmave të vetëvlerësimit. Përmes kësaj përbërjeje të zgjeruar dhe ndërdisiplinore, NjSBC-ja synon forcimin e proceseve të monitorimit, rritjen e cilësisë së të dhënave, përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të vlerësimit, në funksion të rritjes së cilësisë së përgjithshme institucionale.

Raporti i vlerësimit të brendshëm institucional synon të paraqesë një pasqyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse të Institucionit të Arsimit të Lartë, në lidhje me pesë fushat kryesore të vlerësimit:

I. Institucioni i arsimit të lartë, menaxhimi, autonomia dhe siguri i cilësisë;

II. Burimet dhe partneriteti;

III. Programet e studimit, mësimdhënia dhe vlerësimi;

IV. Aktiviteti shkencor/artistik dhe inovacioni;

V- Studentët dhe mbështetja ndaj tyre.

Grupi i punës ka ndjekur me përpikmëri të gjitha parimet e përcaktuara nga ASCAL për realizimin e procesit të vlerësimit të njësisë së arsimit të lartë, duke respektuar orientimet themelore:

1. Vlerësimi e cilësisë duhet të bazohet në profesionalizëm, vërtetësi, objektivitet, paanshmëri, transparencë të plotë dhe përfshirje të të gjithë aktorëve në çdo fazë të procesit.
2. Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në të gjitha njësitë e IAL-ve mbetet një komponent themelor i procesit të vlerësimit dhe i funksionimit cilësor institucional.
3. Realizimi i Vlerësimit të Brendshëm ka si synim krijimin e një tabloje të qartë, të verifikueshme dhe transparente të njësisë nën vlerësim, duke mundësuar hartimin e politikave të zhvillimit në përputhje me misionin institucional, si dhe duke shërbyer si bazë për proceset e mëtejshme të akreditimit të institucioneve dhe programeve të studimit.
4. Publikimi i informacionit synon garantimin e informimit të plotë të partnerëve dhe të publikut të gjerë (studentë, prindër, staf akademik dhe ndihmës, si edhe aktorë të tjerë socialë, ekonomikë dhe politikë), mbi gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave dhe shërbimeve të ofruara.
5. Kontributi në kultivimin e Kulturës së Cilësisë, si një element integral dhe i qëndrueshëm i funksionimit të IAL-ve, përbën një qëllim të rëndësishëm të procesit të vlerësimit.
6. Procesi i vlerësimit është mbështetur në dokumentacionin zyrtar, procedurat e brendshme, takimet me palët e interesuara dhe burime të tjera të verifikueshme, duke siguruar besueshmërinë dhe koherencën e të dhënave të paraqitura.

Historiku i IAL

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” është një Institucion Publik i Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, veprimtaria e të cilit mbështetet në nenin 57, pika 7 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

USH-ja u hap më 2 shtator 1957 si Instituti i Lartë Pedagogjik 2-vjeçar i Shkodrës, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 18.04.1957. Gjatë periudhës 1970–1971, Instituti kaloi nga afati 2-vjeçar në atë 3-vjeçar, ndërsa në vitin shkollor 1982–1983 u realizua kalimi nga sistemi 3-vjeçar në atë 4-vjeçar. Ky ndryshim përfaqësoi një hap të rëndësishëm në zhvillimin e punës mësimore-shkencore dhe edukative të institucionit. Po gjatë kësaj periudhe u shënua edhe rritja e numrit të pedagogëve, e cila u shoqërua me zgjerimin dhe konsolidimin e katedrave.

Gjatë viteve 1957–1991, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës ishte qendra kryesore e përgatitjes së mësuesve për arsimin 8-vjeçar në vend. Gjatë kësaj periudhe janë diplomuar 9586 mësues, që përbëjnë rreth një të katërtën e numrit të përgjithshëm të arsimtarëve në Shqipëri në ato vite.

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 28.05.1991, institucioni mori statusin ligjor të Universitetit, duke u shndërruar në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. USH-ja është një person juridik publik, i financuar nga Buxheti i Shtetit dhe/ose i vetëfinancuar nga burime të tjera të ligjshme.

Aktualisht, Universiteti është i organizuar në 6 fakultete dhe 22 departamente dhe ofron tre cikle studimi:

1. Ciklin e parë “Bachelor”,
2. Ciklin e dytë “Master Profesional” dhe “Master Shkencor”,
3. Program i Integruar i Ciklit të dytë të Studimeve;
4. Ciklin e tretë “Doktoratë”.

Sot, USH-ja renditet ndër universitetet më të mëdha në vend, duke tërhequr studentë nga gjithë njësitë administrative të Shqipërisë, veçanërisht nga zona e Veriut dhe trevat shqiptare në Mal të Zi, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Universiteti ka për mision krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijes përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve akademike, si dhe promovimin e arteve, edukimit fizik dhe sporteve.

EMRI I INSTITUCIONIT	UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI"
Adresa:	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Rektorati, "Sheshi 2 Prilli", Shkodër, Albania P.O.BOX 4001
Kontakt:	e-mail: info@unishk.edu.al Telefon: +355 (22) 800 651 Website: www.unishk.edu.al
Rektor	Prof. dr. Tonin Gjuraj Email: tonin.gjuraj@unishk.edu.al
Licencuar:	VKM Nr. 150, datë 18.04.1957 si <i>Institut i Lartë Pedagogjik</i> .
Statusi ligjor aktual:	VKM Nr.124, datë 28.05.1991 si <i>Universiteti "Luigj Gurakuqi"</i> .
Akreditime:	Vendim i ASCAL, Nr.70, datë 21.09.2017. Vendim i ASCAL Nr. 03, datë 24.01.2020.
Fakultete:	1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore; 2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës; 3. Fakulteti i Shkencave të Edukimit; 4. Fakulteti i Drejtësisë; 5. Fakulteti Ekonomik; 6. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.
Cikle studimi:	Programe profesionale; Cikli parë i Studimeve: Bachelor; Cikli dytë i studimeve: Master Profesional; Master Shkencor; Program i Integruar i Ciklit të dytë të Studimeve; Cikli i tretë i studimeve: Doktoratë.

Tabela1: Skedë informuese për Universitetin "Luigj Gurakuqi"

Organigrama e USH dhe historiku i fakulteteve

Struktura organizative e USH- së është e publikuar edhe në faqen web të Universitetit, vendimi Nr. 22, datë 24.01.2025 "Për miratimin e përkohshëm të strukturës së përgjithshme në USH për periudhën janar-shkurt 2025. (Ref. Link)

Vendim nr. 56, datë 21.02.2025 "Për miratimin e strukturës organizative të universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" për vitin 2025". (Ref. Link)

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" përbëhet nga 6 fakultete, 22 departamente dhe 2 qendra kërkimore.

1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, është një prej themelvënësve të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe e ka gjenezën e tij që në vitin 1957, vit kur u hap për herë të parë Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 167, datë 28.05.1991, institucioni fitoi statusin e universitetit dhe brenda tij Fakulteti i Shkencave Shoqërore vijoi aktivitetin si njësi e veçantë me dy drejtime studimi: Gjuhë - Letërsi dhe Histori - Gjeografi. Që nga viti 1995 pranë këtij Fakulteti është ngritur dhe funksionon Qendra e Studimeve Albanologjike, në vitin 2006 u bë ndarja e degëve të Historisë dhe Gjeografisë si departamente më vete.

Ky Fakultet është i organizuar sot në 4 njësi bazë dhe një qendër studimi. Departamenti i Gjuhës Shqipe, Departamenti i Letërsisë, Departamenti i Historisë dhe Departamenti i Gjeografisë që ofrojnë programe të ndryshme studimi. Me Urdhrin nr. 498, dt. 07. 10. 2011 në vitin akademik 2011-2012 u hap shkolla doktorale “Gjuhë shqipe”, që synon të kryejë studime komplekse në fushë të gjuhësisë, si në rrafshin sinkronik, ashtu edhe në atë diakronik. Për disa vite pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore ka funksionuar edhe “Këshilli i Profesorëve” i kësaj njësie, i cili e ka promovuar stafin akademik me titujt “Profesor i asociuar” dhe “Docent”. Përveç mësimdhënies, pjesë integrale e punës në këtë fakultet është edhe kërkimi shkencor. Një pjesë e këtij produkti shkencor është i pasqyruar në revistën shkencore “Buletin shkencor” (Seria e Shkencave Shoqërore) dhe në kolanën “Studime shqiptare”, e cila përbën një manifestim të pasur të zhvillimit të mendimit kërkues shkencor në fusha të shkencave humane. Sot Fakulteti i Shkencave të Shoqërore ka 40 pedagogë, prej të cilëve 4 mbajnë titullin “Profesor”, 9 “Profesorë të asociuar”, 22 “Doktorë”, 2 “Docentë” dhe 3 pa tituj e grada.

EMRI I FAKULTETIT	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
Adresa:	Rruga “Jeronim de Rada” 4, Shkodër
Kontakt:	Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet
Licencimi:	VKM nr.167, datë 28.03.1991
Dekan:	Prof. dr. Artan Haxhi e-mail: artan.haxhi@unishk.edu.al
Departamente:	1. Departamenti i Gjuhësisë. 2. Departamenti i Letërsisë. 3. Departamenti i Historisë. 4. Departamenti i Gjeografisë. Qendra e Studimeve Albanologjike
Cikle studimi:	1. Cikli I i studimeve (4 programe studimi Bachelor). 2. Cikli II i studimeve (3 programe studimi Master Profesional dhe 3 programe studimi Master Shkencor). 3. Cikli i III i studimeve (Doktoraturë në “Gjuhë shqipe”).

Tabela 2. Skedë informuese për FSHSH-në

Departamenti	Programi studimit	Dokumenti Licencimit
Gjuhësisë	Bachelor në “Gjuhë – Letërsi”	VKM Nr.150 prot., datë 18.04.1957

Letërsisë	Bachelor në “Gazetari dhe Komunikim”.	Shkresë MASH Nr. 2743 prot., datë 27.04.2006
	Master Profesional në “Mësuesi në Gjuhë – Letërsi”.	VKM nr. 1291, datë 24.09.2008
Historisë	Bachelor në “Histori”.	Shkresë MASH Nr. 1127 prot, datë 20.02.2006
	Bachelor në “Histori dhe trashëgimi kulturore”.	Urdhër nr. 272, datë 21.07.2021
	Master i Shkencave në “Studime të Historisë dhe të Kulturës Shqiptare”	Urdhër Nr. 583, datë 04.10.2022
Gjeografisë	Bachelor në “Gjeografi”	Shkresë MASH Nr. 1127 prot, datë 20.02.2006
	Bachelor në “Gjeografi dhe Zhvillim Territori”	VKM nr.440, dt20.07.2022
	Master i Shkencave “Studime Regjionale në Gjeografi”	Urdhër Nr. 212, datë 31.05.2013
	Master Profesional në “Mësuesi Histori dhe Gjeografi”	VKM Nr. 1212, datë 11.12.2009
	Program studimi me karakter profesional “Udhërrëfyes Turistik dhe Menaxhuese i Itinerareve Turistike për Rajonin Verior”	Urdhër nr. 196, datë 03.07.2020
QSA	Cikli i tretë “Doktoratë” në “Gjuhë Shqipe”.	VKM Nr. 498, datë 07.10.2011

Tabela 3. Skedë informuese për programet e studimit që ofron FSHSH-ja

2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), si njësi kryesore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, e ka filluesën e tij në themelimin e Institutit të Lartë Pedagogjik, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 18.04.1957, i cili u vu në zbatim më 2 shtator 1957. Në fazën fillestare, veprimtaria mësimore–profesionale drejtohej nga Katedra e Matematikës dhe Fizikës. Gjatë viteve 1965–1966 u krijuan Dekanati i Shkencave Natyrore, i cilat ende nuk kishte statusin e fakultetit. Ndarja e katedrave nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës u realizua në vitin 1970, duke i miratuar ato si njësi të veçanta mësimore, përfshirë katedrat e matematikës, fizikës, kimisë dhe biologjisë. Me Vendim të Këshillit të Ministrave, në vitin akademik 1982–1983, u bë kalimi nga sistemi 3-vjeçar në sistemin 4-vjeçar të studimeve, duke mundësuar një nivel më të gjerë dhe më cilësor të mësimdhënies dhe formimit akademik. Më pas, me vendimin nr. 167, datë 28.05.1991 të Këshillit të Ministrave, u themelua zyrtarisht si Fakultet i Shkencave të Natyrës (FSHN). Që nga krijimit e deri më sot, FSHN-ja është zgjeruar vazhdimisht me programe të reja studimi, departamente dhe qendra shkencore, duke u përshtatur me nevojat e zhvillimit akademik, shkencor dhe tregun e punës.

Misioni

Misioni i Fakultetit të Shkencave të Natyrës është në përputhje të plotë me misionin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. FSHN synon formimin e studentëve me njohuri bashkëkohore dhe përgatitje cilësore, duke nxjerrë profesionistë konkurrues në fushat e:

1. Mësuesisë: Biologji–Kimi, Fizikë, Matematikë, Informatikë
 2. Shkencave të Natyrës dhe Teknologjisë
 3. Informatikë dhe Teknologji Informacioni
 4. Shkencave mjekësore teknike: Infermieri, Mami, Fizioterapi
 5. Shkencave të ushqimit
 6. Programeve profesionale: Teknik elektrik; Teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike
- Fakulteti synon të përgatisë profesionistë që i shërbejnë zhvillimit të qëndrueshëm shoqëror dhe ekonomik në nivel lokal dhe kombëtar.

Politika e Cilësisë

Fakulteti i Shkencave të Natyrës angazhohet të ruajë dhe të zhvillojë më tej rolin e tij si garant i cilësisë në arsimin e lartë, duke:

1. siguruar standarde të larta akademike dhe profesionale,
2. garantuar procese efektive të brendshme të sigurimit të cilësisë,
3. promovuar përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit,
4. kontribuar në formimin e të gjitha shtresave të shoqërisë në funksion të prioriteteve të zhvillimit të vendit.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron:

1. Kurrikul të pasur dhe të larmishme në të gjitha nivelet e studimit (Programe Profesionale 2-vjeçare, Cikli I dhe Cikli II), të hartuara në përputhje me Deklaratën e Bolonjës, legjislationin në fuqi për Arsimin e Lartë dhe udhëzimet e MASR. Programet pasqyrojnë kërkesat e tregut të punës dhe u mundësojnë studentëve fitimin e njohurive bashkëkohore dhe aftësive praktike të nevojshme.
2. Staf akademik të kualifikuar, me tituj dhe grada shkencore, profesionalizëm dhe përkushtim të lartë në realizimin e misionit dhe objektivave të Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
3. Veprimtari të avancuara kërkimore-shkencore dhe botuese, të reflektuara në publikime të rregullta shkencore dhe në angazhimin e pedagogëve në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. Monitorim të rregullt dhe sistematik të cilësisë së mësimdhënies, me synimin e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor dhe performancës akademike.
5. Organizime veprimtarish akademike për studentët, duke përfshirë orë të hapura, ligjërata nga ekspertë të fushës, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe workshope profesionale.
6. Marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes vendore dhe organizatat joqeveritare, ku studentët realizojnë praktikatat profesionale dhe fitojnë përvojë praktike.
7. Zhvillim të vazhdueshëm, bashkëpunim me komunitetin akademik dhe aktorë të tjerë institucionalë, brenda dhe jashtë vendit, në funksion të rritjes së cilësisë brenda Fakultetit.

EMRI I FAKULTETIT	Fakulteti i Shkencave të Natyrës
Adresa:	Rruga Jeronim de Rada 12, Shkodër
Kontakt:	website: www.unishk.edu.al/Fakultetet
Licensuar:	2 Shtator 1957 si ILP Në vitin 1991, themelohet si fakultet më vete

Dekani	Prof. as. Dr. Rrok Smajlaj Email: rrok.smajlaj@unishk.edu.al
Departamentet	1. Departamenti i Biologji-Kimisë 2. Departamenti i Matematikës 3. Departamenti i Fizikës 4. Departamenti i Lëndëve Klinike 5. Departamenti i Lëndëve Paraklinike Qendra e Studimit të Ujërave të Rajonit të Shkodrës
Ciklet e studimit	1. Cikli I i studimeve (7 programe studimi Bachelor) 2. Cikli II i studimeve (6 programe studimi Master Profesional dhe 1 program studimi Master Shkencor) Programe formimi profesional (2 programe)

Tabela 4. Skeda informuese për FSHN-në

Departamenti	Programi i studimit	Dokumenti i Licencimit
Departamenti i Biologji - Kimisë	Bachelor në “Biologji – Kimi”	VKM Nr.150 prot., datë 18.04.1957
	Bachelor në “Shkencat e Ushqimit”	Urdhër Nr.392, datë 19.07.2023
	Master i Shkencave në “Biologji Mjedisore”	VKM Nr. 1162, datë 25.11.2009
	Master i Shkencave në “Mësuesi në Biologji-Kimi”	Urdhër Nr.453, datë 26.08.2024.
	“Master i shkencave” në “Sigurim i Cilësisë së Ushqimit dhe të Ushqyerit “	Urdher 441 Prot. ,date 10.09. 2025

Fizikës	Bachelor në Fizikë	Vendim Nr. 4/1 i Ministrit, datë 15.01.1999
	Master i shkencave” në “Mësuesi në Matematikë – Fizikë”	Urdhër Nr.451, datë 26.08.2024
	Program studimi me karakter profesional “Specialist i Lartë Elektrik”	VKM Nr. 459, datë 27.07.2022
Matematikës	Bachelor në “Matematikë”	VMASh Nr. 4, datë 15.01.1999
	Bachelor në “Informatikë”	Shkrese MASh Nr.2571/1 prot, datë 19.07.2002
	Master i shkencave” në “Mësuesi në Informatikë”	Urdhër Nr.452, datë 26.08.2024.
	Master i shkencave” në “Mësuesi në Matematikë”,	Urdhër Nr.396, datë 31.07.2024.
	Program studimi me karakter profesional “Teknik Sistemeshe dhe Rrjetesh Kompjuterike”	Urdhër nr. 190, datë 03.07.2020
	Master Profesional në “Zhvillim programesh të avancuara” (Advance software development)	Urdhër nr.591, datë 04.10.2022
Departamenti i Lëndëve Klinike	Bachelor në “Infermieri e Përgjithshme”	Shkresë MASh Nr. 784/1 prot, datë 05.06.2001
	Master i Shkencave në “Infermieri Klinike”	Urdhër 359 Prot, datë 23.07.2025.
Departamenti i Lëndëve Paraklinike	Bachelor në “Infermieri (Mami)”	Shkresë MASh Nr. 3955 prot, datë 01.06.2007
	Bachelor në Fizioterapi	Shkresë MASh Nr. 3954 prot, datë 01.06.2007
	Master Profesional në “Psikologji Shëndeti”	Urdhër Nr. 503, datë 18.10.2012

Tabela 5. Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHN-ja

3. Fakulteti i Shkencave të Edukimit

Fillesa e tij është në vitin akademik 1981 – 1982 me hapjen e programit të studimit për Mësues për klasat I – IV të shkollës 9 – vjeçare (Cikli Ulët). Po në këtë vit akademik, u krijua për herë të parë në Universitetin e Shkodrës katedra e Psikologjisë dhe Pedagogjisë, e cila merret me problemet e degës së Mësuesisë për Ciklin e Ulët.

Misioni:

Misioni i FSHE-së vjen në të njëjtën linjë me misionin e USH, duke synuar krijimin, zhvillimin, mbrojtjen dhe transmetimin e dijeve me anën e mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore, formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkencëtarëve të rinj në fushën e mësimdhënies në arsimin parashkollor, në arsimin fillor, edukimin fizik, në fushën e arteve dhe në fushat e shkencave sociale me specialitet psikologjinë dhe punën sociale. FSHE punon në realizimin e objektivave me qëllim që të sigurojë një mësimdhënie të kualifikuar, të krijojë kushte për mësim dhe kërkim shkencor si dhe të përgatisë specialistë të aftë në të gjitha disiplinat që mbulon FSHE.

Të mbajë dhe të zhvillojë më tej rolet dhe funksionin e fakultetit si sigures i cilësisë në arsimimin e të gjitha shtresave në funksion të prioriteteve të zhvillimit të vendit.

Fakulteti ofron:

1. Kurrikul të pasur dhe të larmishme të programeve mësimore për ciklet e studimit, (Cikli I dhe Cikli II), në zbatim të Deklaratës së Bolonjës, legjislacionit për Arsimin e Lartë, udhëzimeve të MASR, në përputhje me nevojat e tregut, duke iu siguruar studentëve mundësinë për të fituar njohuritë akademike dhe aftësitë praktike.
2. Staf akademik të kualifikuar me tituj e grada shkencore, profesionalizëm dhe përkushtim për t'u përballuar me sfidat në përmbushje të qëllimeve që ka FSHE-ja.
3. Nivel të lartë të punës kërkimore - shkencore të pedagogëve dhe të aktivitetit të tyre botues.
4. Monitorim të përvitshëm të cilësisë së mësimdhënies.
5. Numër të lartë të aktiviteteve, realizuar nga pedagogë me studentë (orë të hapura me specialistë të fushës).
6. Marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes lokale dhe shërbimet e ofruara nga OJF – të, ku studentët zhvillojnë praktikat profesionale.
7. Bashkëpunim të vazhdueshëm të Fakultetit të Shkencave të Edukimit me komunitetin akademik, e më gjerë.

EMRI I FAKULTETIT	Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Adresa:	Rruga "Kolë Heqimi", Shkodër
Kontakt:	Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet
Licencimi:	VKM nr.125, datë 01.09.1991 si Fakultet i Ciklit të Ulët. Vendim Senati nr.117, datë 31.10.2000 si Fakulteti i Shkencave të Edukimit
Dekan:	Prof. as. dr. Eranda Bilali (Halluni) e-mail: eranda.bilali@unishk.edu.al
Departamente:	Departamenti Psikologji-Punë Sociale. Departamenti i Mësuesisë. Departamenti Edukim fizik dhe sporte. Departamenti i Arteve.

Cikle studimi:	Cikli I i studimeve (7 programe studimi Bachelor). Cikli II i studimeve (5 programe studimi Master Profesional), 3 programe studimi Master Shkencor). Program studimi i Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko – Pedagogjike.
----------------	---

Tabela 6. Skedë informuese për FSHE

Departamenti	Programi i studimit	Dokument Licencimi
Departamenti i Mësuesisë	Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”	VKM 167, datë 28.05.1991
	Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”	VKM 332, datë 13.05.1996
	Master Profesional në “Mësuesi për Arsimin Fillor”	Urdhër Nr. 598, datë 07.12.2012
	Master Profesional në “Pedagogji Speciale”	Urdhër Nr.441, datë 10.08.2023
	Program studimi i Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko - Pedagogjike	Urdhër Nr.375, datë 14.07.2023
Departamenti i Psikologjisë dhe Punës sociale	Bachelor në “Psikologji”	Shkresë MAS Nr. 4276 prot, datë 01.07.2004
	Bachelor në “Punë Sociale”	VKM Nr.596, datë 22.09.2005
	Master i Shkencave në” Psikologji Klinike”	Urdhër Nr. 395, datë 10.08.2011
	Master i Shkencave në “Psikologji Organizative”	Urdhër nr. 395 datë 10.08.2011
	Master Profesional “Shërbimet sociale”	Urdhër nr. 334, datë 17.09.2021,
Edukim Fizik dhe Sporte	Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”	Shkresë MASH Nr. 2742 prot., datë 27.04.2006
	Master Shkencor në “Mësuesi në lëndët Edukim Fizik dhe Sporte”	VKM Nr. 1212, datë 11.12.2009 VKM Nr. 468, datë 03.09.2024
Departamenti i Arteve	Bachelor në “Pedagogji Muzikore”	Urdhër nr. 272, datë 20.07.2015
	Bachelor në “Pikturë dhe Grafikë”	Urdhër nr. 272, datë 20.07.2015
	Master Profesional në “Mësues Muzike”	Urdhër nr. 581, datë 04.10.2022,
	Master Profesional “Mësues i Artit Pamor”	Urdhër nr. 504, datë 06.09.2022,

Tabela 7. Skedë informuese për programet e studimit që ofron FSHE-ja

4. Fakulteti i Drejtësisë

U hap me VKM nr.332, datë 13.05.1996, ndërsa studimet e larta në Drejtësi në Universitetin e Shkodrës u hapën me VKM nr.349, datë 10.08.1992 “Për hapjen e degës së Drejtësisë dhe Administrim-Biznesit në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër”. Aktualisht ofron 3 programe studimi dhe 3 departamente si: departamenti i të Drejtës Publike, departamenti i të Drejtës Civile dhe departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane. Me VKM Nr. 191, datë 03.07.2020 në këtë fakultet është hapur Programi i Integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi me kohëzgjatje 5-vjeçare. Diplomat e lëshuara nga ky fakultet njihen prej vitesh në universitete të ndryshme, si p.sh., ato evropiane dhe amerikane.

Misioni:

Fakulteti i Drejtësisë ka si mision t’u ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme dhe specifike profesionale dhe shkencore në përshtatje me tregun e punës në fushën e të drejtës për:

1. Shkollën e magistraturës,
2. Nëpunës civilë gjyqësorë,
3. Administratën publike dhe administratën gjyqësore,
4. Profesionet e lira.

Ky fakultet ka si objektiv, aftësimin të studentëve në zbatimin dhe interpretimin e legjislacionit, në hartimin e akteve ligjore si juristë në administratën gjyqësore, publike e private, në aftësimin për argumentim të përshtatshëm për zgjidhjen e çështjeve juridike të përgjithshme dhe të veçanta të nevojshme për specialitetin përkatës dhe tregun e punës.

Politika e Cilësisë:

Fakulteti i Drejtësisë synon rritjen e cilësisë së arsimit të studentëve nëpërmjet rritjes së cilësisë së mësimdhënies me metoda bashkëkohore dhe staf të kualifikuar në universitetet perëndimore.

Fakulteti ofron:

1. Një kurrikul të pasur dhe të larmishme programesh mësimore në të dy ciklet e studimeve, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë praktike që do t’u shërbejnë atyre në ushtrimin e profesionit të juristit në administratën gjyqësore, publike dhe private.
2. Një kurrikul në bashkërendim me kërkesat dhe parimet evropiane, që mundëson lëvizshmërinë e studentëve në programe studimi jashtë vendi me mundësi ekuivalentimi.
3. Infrastrukturë mbështetëse për studentët, mjedise me hapësira të përshtatshme dhe teknologji bazë, pajisje dhe programe kompjuterike, internet, bibliotekë universitare etj.
4. Bashkëpunim të ngushtë student-pedagog dhe mbështetje të vazhdueshme për formimin profesional të studentëve.

EMRI I FAKULTETIT	Fakulteti i Drejtësisë
Adresa:	Rruga “Jeronim de Rada” 12, Shkodër
Kontakt:	Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet
Licencimi:	VKM nr.332, datë 13.05.1996

Dekani:	Prof.as. dr. Paulina Guli Hoti e-mail- paulina.hoti@unishk.edu.al
Departamente:	1. Departamenti i të Drejtës ndërkombëtare dhe Evropiane 2. Departamenti i të Drejtës publike dhe penale 3. Departamenti i të Drejtës civile
Cikle studimi:	1. Cikli II i studimeve (2 programe studimi Master Shkencor , si dhe 1 Programi integruar i ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Drejtësi” 300 ECTS).

Tabela 8. Skedë informuese për Fakultetin e Drejtësisë

Programi i studimit	Dokument Licencimi
Program i Integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi (300 ECTS) (5 vjeçar) PIND	VKM Nr. 191, datë 03.07.2020 Nr. prot. 2329/2, datë 03.07.2022
Master Shkencor “E Drejta kushtetuese dhe administrative” (120 ECTS)	VKM Nr. 682, datë 25.08.2010
Master Shkencor “E Drejta private dhe e biznesit” (120 ECTS)	VKM Nr. 1162, datë 25.11.2009

Tabela 9. Skedë informuese për programet e studimit që ofron FD-ja

5. Fakulteti Ekonomik

Për disa vite, pranë Institutit të Lartë Pedagogjik në Shkodër ka funksionuar një filial i Fakultetit të Ekonomisë së Universitetit të Tiranës. Më 28 Maj 1991, Instituti i Lartë Pedagogjik u transformua në Universitet, ndërsa Fakulteti Ekonomik u hap zyrtarisht në shtator të vitit 1993, me Vendimin nr. 349, datë 10.8.1992 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Evidenca B – Vendimi i MAS).

Nga viti 1993 deri në vitin 2000, Fakulteti ofronte vetëm degën Administrim-Biznes, e cila fillimisht funksiononte si njësi mësimore në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 13.05.1996 (Evidenca C – Vendimi i Këshillit të Ministrave), Fakulteti i Ekonomisë fitoi statusin e një njësie të pavarur akademike brenda Universitetit të Shkodrës. Në vitin 2000 (Evidenca D – Miratimi për hapjen e degës Financë-Kontabilitet) u miratua hapja e degës Financë-Kontabilitet, ndërsa në vitin 2001 u shtua edhe dega Marketing-Turizëm. Dega e Turizmit aplikoi për herë të parë sistemin e Bolonjës gjatë vitit akademik 2005–2006, me mbështetjen e Konferencës së Rektorëve Gjermanë (Evidenca E – Aplikimi i degës Turizëm në sistemin e Bolonjës).

Në vitin akademik 2008–2009, të tre programet e Fakultetit filluan zbatimin e ciklit të parë të studimeve trevjeçare, sipas Deklaratës së Bolonjës. Më pas, në vitin akademik 2009–2010, Fakulteti ofroi për herë të parë ciklin e dytë të studimeve me Masterin Shkencor në Turizëm të Qëndrueshëm, ndërsa në vitin 2011 u hapën edhe programet e Masterit Shkencor në Administrim-Biznes, Financë dhe Kontabilitet (Evidenca F – Hapja e Masterit Shkencor në AB, Financë dhe Kontabilitet). Gjatë vitit akademik 2012–2013 u shtuan tre programe të Masterit Profesional: Trashëgimi Kulturor dhe Menaxhim Turizmi, Administrim-Biznes dhe Financë-Bankë (Evidenca G – Hapja e tre Masterave Profesionale).

Në vitin 2018–2019, Fakulteti pasuroi ofertën akademike me Masterin Profesional “Menaxhim Financiar, Kontabilitet dhe Kontroll në Administratën Publike”, i zhvilluar në kuadër të

projektit FINAC dhe i mbështetur nga fondet e Bashkimit Evropian. Me Urdhrin nr. 174, datë 04.04.2022, Ministria e Arsimit dhe Sportit i dha Fakultetit Ekonomik të drejtën për hapjen e programit të ciklit të tretë – Doktoratë në “Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm”. Ky program filloi pranimin e brezit të parë të kandidatëve më 14.11.2022, sipas Urdhrit të Rektorit nr. 86, po me datë 14.11.2022 (Evidenca H. Urdhri i Rektorit. Doktoratë).

Me Urdhrin nr. 400, datë 20.08.2025, Ministria e Arsimit dhe Sportit i dha Fakultetit Ekonomik të drejtën për hapjen e programit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Marketing Inovativ”. (Evidenca 1– Urdhri MASR për hapjen e Master i Shkencave në Marketing Inovativ).

FE zhvillon aktivitetin e tij arsimor dhe shkencor në një rajon me tradita të konsoliduara në arsim, kulturë, histori dhe sipërmarrje. Qyteti i Shkodrës, si një qendër e rëndësishme për veriun e vendit dhe me një histori të hershme në tregti, zanate dhe mikpritje, ofron një mjedis të favorshëm për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të Fakultetit Ekonomik. Fakulteti Ekonomik është një nga gjashtë njësitë kryesore përbërëse të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe përfshin tre departamente: Departamentin e Administrim-Biznesit, Departamentin e Financë-Kontabilitetit dhe Departamentin e Turizmit.

Misioni:

Fakulteti Ekonomik ka si mision formimin e studentëve me njohuri bashkëkohore, duke synuar përgatitjen e tyre, si: menaxherë, financierë, kontabilistë dhe specialistë në fushën e turizmit të aftë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të komunitetit e të vendit, si dhe në kërkimin shkencor dedikuar fushës së ekonomisë.

Politika e Cilësisë:

Të mbajë dhe të zhvillojë më tej rolet dhe funksionin e fakultetit, si sigures i cilësisë në arsimimin e të gjitha shtresave në funksion të prioriteteve të zhvillimit ekonomik të vendit.

Fakulteti ofron:

1. Një kurrikul të pasur dhe të larmishme programesh mësimore në të tre ciklet e studimeve, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë praktike.
2. Pjekuri e profesionalizëm, përkushtim i një personeli akademik dinamik për t'i përballuar me sukses sfidat në përmbushje të misionit të fakultetit.
3. Mbështetje nga profesorë të ftuar vendas dhe të huaj, të cilët pasurojnë programet duke ndarë përvojat e tyre.
4. Mundësi kombinimi të vazhdueshëm të njohurive teorike me praktikën profesionale në organizata biznesi, institucione të ndryshme, sipas fushës së studimit.
5. Studime universitare që zhvillohen në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.
6. Mundësi për të marrë pjesë në programet mësimore të ofruara nga Fakulteti Ekonomik edhe për studentët e trojeve shqiptare.
7. Bashkëpunime me universitete në Evropë dhe në SHBA për kërkimin shkencor, mobilitete për stafin akademik dhe studentët e këtij fakulteti.
8. Bashkëpunime me komunitetin akademik, autoritetet e qeverisjes qendrore e vendore, komunitetin e biznesit dhe OJF-të, për realizimin e misionit të tij.

EMRI I FAKULTETIT	Fakulteti Ekonomik
Adresa:	Rruga “Jeronim de Rada”
Kontakt:	Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet

Licencuar:	VKM nr.332, datë 1996
Dekani	Prof. as. dr. Elidiana Bashi e-mail: elidiana.bashi@unishk.edu.a/
Departamentet	1. Departamenti i Financë-Kontabilitetit 2. Departamenti i Administrim-Biznesit 3. Departamenti i Turizmit
Ciklet e studimit	1. Cikli I i studimeve (3 programe studimi Bachelor) 2. Cikli II i studimeve (4 programe studimi Master Profesional dhe programe studimi Master Shkencor), 3. Doktoratë në “Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm”.

Tabela 10. Skedë informuese për FE-në

Departamenti	Programi i studimit	Dokument Licensimi
Financë – Kontabilitetit	Bachelor në “Financë – Kontabilitet”	Shkresë MAS Nr. 4390 Prot. datë 23.10.2000
	Master i Shkencave në “Kontabilitet”	UMAS Nr. 395, datë 10.08.2011
	Master i Shkencave në “Financë”	UMAS Nr. 395, datë 10.08.2011
	Master Profesional në “Financë – Bankë”	UMASh Nr. 503, datë 18.10.2012
	Master Profesional në “Menaxhimi Financiar, Kontabiliteti dhe Kontrolli në Administratën Publike”	UMAS Nr. 702, datë 19.10.2018
Administrim – Biznes	Bachelor në “Administrim – Biznes”	VKM Nr. 349, datë 10.08.1992
	Master i Shkencave në “Administrim Biznesi”	UMASh Nr. 395, datë 10.08.2011
	Master Profesional në “Administrim Biznes”	UMASh Nr. 503, datë 18.10.2012
Turizëm	Bachelor në “Turizëm”	MAS vendim 1803/1 datë 05.06.2001
	Master i Shkencave në “Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm”	VKM Nr. 1370, datë 10.10.2008
	Master Profesional në Trashëgimi Kulturore dhe Menaxhim Turizmi	UMASh Nr. 503, datë 18.10.2012
	Cikli i tretë “Doktoratë” në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”	Urdhër nr. 174, datë 04.04.2022

Tabela 11. Skedë informuese për programet e studimit që ofron FE-ja

6. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Shkodër është një fakultet relativisht i ri, i krijuar si i tillë me vendim të MASH, nr.28, dt. 20.01.2001, mbi bazën e Departamentit të Gjuhëve të Huaja dhe Departamentit të Gjermanistikës. Në përbërje të tij sot ka tre departamente, përkatësisht Departamentin e Gjuhës Angleze, Departamentin e Gjermanistikës dhe Departamentin e Romanistikës.

Misioni:

Fakulteti Gjuhëve të Huaja ka si mision formimin e studentëve të nivelit Bachelor me njohuritë më bashkëkohore, duke synuar përgatitjen e tyre si specialistë në fushën e gjuhësisë, të letërsisë, të përkthimit dhe të komunikimit ndërkulturor, aftësimin e studentëve për të kryer punë kërkimore edhe në rrafshet krahasuese mes gjuhës dhe kulturës së studiuar dhe asaj shqipe, formimin e studentëve të nivelit Master Profesional me metodologjitë dhe teknikat më bashkëkohore dhe të njohura në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës së huaj.

Politika e Cilësisë:

Të ruajë standardet dhe të zhvillojë më tej rolet dhe synimin e fakultetit, si sigures i cilësisë në arsimimin e brezave në funksion të kërkesave për specialistë dhe përkthyes të gjuhëve të huaja.

Fakulteti ofron:

1. Një kurrikul të pasur dhe të larmishme programesh mësimore në të dy nivelet, Bachelor dhe Master profesional, të hartuara me mbështetjen e fortë dhe të qëndrueshme të universiteteve dhe institucioneve partnere evropiane në bashkërendim me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësi për të fituar njohuritë më të përditësuara në fushën akademike dhe aftësitë praktike.
2. Një kurrikul në bashkërendim me kërkesat dhe parimet evropiane që mundëson lëvizshmërinë e studentëve në programe studimi jashtë vendi me mundësi ekuivalentimi.
3. Formim, përkushtim, korrektësi dhe profesionalizëm të stafit akademik të specializuar në universitete perëndimore për të përballuar dhe përmbushur me sukses sfidat dhe detyrimet në përmbushje të misionit të fakultetit dhe për t'u formuar në vazhdimësi.
4. Mbështetje nga profesorë dhe personalitete të ftuar, vendas dhe të huaj, nga universitetet partnere që pasurojnë programet e studimit pranë këtij fakulteti, duke bashkëndarë përvojat e tyre me stafet e FGJH-së, përmes leksioneve të hapura dhe konferencave që realizohen me nisma të përbashkëta.
5. Ndërrurje të shkëlqyer të njohurive teorike me ato praktike, përmes materialeve autentike që u ofrohen studentëve të nivelit Bachelor dhe Master.
6. Bashkëpunime të frytshme me Universitete Evropiane, që ofrojnë mundësi të shkëlqyera studimi përmes akordimit të bursave për studentët dhe përvoja shkëmbimi dhe pasurimi profesional për stafin akademik.
7. Ofrimi i bursave semestrale në kuadër të programit Erasmus+ në universitete gjermane dhe italiane
8. Mësimdhënie nga lektorë të huaj austriakë, italianë, amerikanë, të cilët ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së studimit akademik.
9. Klimë pozitive bashkëpunimi mes stafit akademik dhe studentëve.
10. Mirëpritje të studentëve të huaj dhe trojet me kuota të veçanta.

EMRI I FAKULTETIT	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Adresa:	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja , Rruga Dom Bosko, nr.2, P.O.BOX 4001

Kontakt:	Website: www.unishk.edu.al/Fakultetet
Dekani	Prof. as.dr. Edlira Bushati e-mail: edlira.bushati@unishk.edu.al
Licencuar:	VKM Nr. 28, datë 20.01.2001 si Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
Akredituar:	Vendim i KA, Nr.130/4, datë 16.10.2006
Departamentet	Departamenti i Gjuhës Angleze Departamenti i Romanistikës Departamenti i Gjermanistikës
Ciklet e studimit	Cikli I i studimeve (Bachelor) Cikli II i studimeve (Master Profesional i riorganizuar në Master Shkencor)

Tabela 12. Skedë informuese për FGJH-në

Departamenti	Programi i studimit	Dokument Licencimi
Departamenti i Gjuhës Angleze	Bachelor në “Gjuhë Angleze “	VKM Nr. 300, datë 21.06.1994
	Master Profesional në “Mësuesi në Gjuhë Angleze”	VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008
	Master Profesional në “Mësuesi në Gjuhën Angleze”	Urdhër të MASR nr.335, datë 17.09.2021
Departamenti i Gjermanistikës	Bachelor në “Gjuhë Gjermane”	Shkresë MASH Nr. 960 prot. datë 11.03.1996. bazuar në Marrëveshjen ndëruniversitare ndërmjet Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe Universitetit “Karl-Franzens” Graz;
	Master Profesional në “Mësuesi në Gjuhë Gjermane”	VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008
	Master profesional në Mësuesi “Mësuesi në Gjuhë Gjermane” (riorganizim)	Urdhër të MASR nr.333, datë 17.09.2021.
Departamenti i Romanistikës	Bachelor në “Gjuhë Italiane”	V MAS Nr. 146, datë 04.08.1998
	Bachelor në “Gjuhë Frënge”	VKM Nr.596, datë 22.09.2005
	Master Profesional në “Mësuesi në Gjuhë Frënge”	VKM Nr. 1333, datë 01.10.2008
	Master profesional në Mësuesi “Mësuesi në Gjuhë Frënge” (riorganizim)	Urdhër të MASR nr.336, datë 17.09.2021
	Master Profesional në Mësuesi në “Gjuhë Italiane”	VKM nr. 28, datë 20.01.2001
	Master profesional në Mësuesi në “Gjuhë Italiane” (riorganizim)	Urdhër të MASR nr.337, datë 17.09.2021.

Tabela 13. Skedë informuese për programet e studimit që ofron FGJH

Vetëvlerësimi përkundrejt fushave të vlerësimit për Akreditimin Institucional

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike"; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", i ndryshuar; Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, "Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë"; Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, "Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit" dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 "Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit", në mbledhjen e tij të datës 24.01.2020, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, me Vendim nr. 03, datë 24.01.2020 vendosi për Akreditimin Institucional të Universitetit "Luigj Gurakuqi", me kohëzgjatje për 4 (katër) vite deri më 23/01/2024 me 5 rekomandime për t'u përmbushur nga USH-ja.

Rekomandimet janë:

1. Institucioni të sigurojë një rrjedhje më të mirë të informacionit nga nivelet e sipërme të menaxhimit tek ato të ulëta dhe anasjelltas.

Në kuadër të këtij rekomandimi, USH-ja ka marrë masat e duhura për pajisjen me një email zyrtar nga platforma Microsoft office 365 (@unishk.edu.al), për të gjithë stafin administrativ, stafin akademik me kohë të plotë dhe atë me kohë të pjesshme, si dhe ka krijuar grupet e pedagogëve,

shefat.departamente@unishk.edu.al;

dekanet@unishk.edu.al;

pedagogetebrendshem@unishk.edu.al

stafjoakademik@unishk.edu.al

Përcjellja e informacionit bëhet në mënyrë periodike dhe në kohë reale, duke pasqyruar informacionin e marrë nga ministria apo agjencitë përkatëse tek fakultetet dhe departamentet, si dhe tek vetë pedagogët. Përveç informacionit periodik dhe njoftimeve në faqen zyrtare të Universitetit, projekt-vendimet dhe raportet e takimeve u dërgohen qoftë në mënyrë protokollare dhe qoftë online nga nivelet e sipërme të menaxhimit deri tek ato më të ulëta. (Ref. 1 [Link](#) , Ref. 2 [Link](#) , Ref.3. [Link](#))

2. Institucioni, të mundësojë autonominë financiare në nivelin e njësive bazë.

Në lidhje me përmbushjen e këtij rekomandimi mungojnë aktet nënligjore përkatëse për ta realizuar.

3. Institucioni, të sigurojë mbulimin e ngarkesës mësimore në programet e studimit të ciklit të parë nga staf akademik efektiv në masën të paktën 70%.

Për përmbushjen e këtij rekomandimi, gjatë vitit akademik 2024-2025 janë rekrutuar 5 pedagogë me kohë të plotë të ndarë sipas fakulteteve dhe departamenteve.

Nr.	Fakulteti	Departamenti	Emri Mbiemri
1	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	Departamenti i Arteve	Msc. Eros Dibra
2	Fakulteti i Shkencave Natyrore	Departamenti i Lëndëve Klinike	Prof. as. dr. Astrit Beci*
3	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Departamenti i Matematikës/Informatikës	Msc. Ditmira Tahiri
4	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	Departamenti i Letërsisë	Dr. Laert Miraku
5		Departamenti i Gjeografisë	Dr. Ylber Dyli
6		Departamenti i Historisë	Prof.as.dr. Ilirjana Kaceli

Tabela 14. Rekrutimet

*Prof. As. Dr. Astrit Beci pranë FSHN-së (Departamenti i Lëndëve Klinike), nuk ka filluar marrëdhënie pune me kohë të plotë në USH.

- Institucioni, të gjejë mënyra më efektive për shpërndarjen e buxhetit për kërkim shkencor.

Me vendimin e BA Nr. 220 dt. 29.09.2023 është vendosur që të shpërndahet shuma e parashikuar në buxhet të zëri për shpenzime për pjesëmarrjen në konferenca (kërkim shkencor), në mënyrë të barabartë për çdo njësi kryesore për vitin akademik 2023-24. (Ref.4 [Link](#))
Për vitin akademik 24-25, bazuar në vendimin e BA, Nr.140, dt. 28.04.2025, pedagogët janë rimbursuar për botime në revista shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca të BE/OECD. (Ref.5 [Link](#))

Evidentimi i procedurave të alokimit të buxhetit për kërkimin shkencor është arritur në masën 100%. Tashmë ky rekomandim i ASCAL-it është shndërruar në pikë të fortë të USH-së.

- Institucioni, të riorganizojë ambientet ekzistuese të stafit akademik, në mënyrë që të rriten standardet teknike për hapësirat e punës dhe gjithashtu të sigurojë dritën natyrale.

Është bërë riorganizim i disa zyrave, në ato fakultete, ku ka pasur hapësira për të bërë lëvizje të tilla, si p.sh.: për departamentin e Edukimi Fizik dhe Sportet dhe për departamentin e Lëndëve Klinike dhe Paraklinike.

FUSHA 1. INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË, MENAXHIMI, AUTONOMIA DHE SIGURIMI I CILËSISË

Standardi I.1 Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit.

USH e ushtron veprimtarinë e tij akademike dhe shkencore bazuar në aktet ligjore në fuqi, në Statutin e USH-së dhe në të gjitha aktet e tjera të miratuara nga organet dhe autoritetet qeverisëse të USH-së. Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” USH, ka si bazë të funksionimit të tij për të gjithë programet e studimit, statutin dhe rregulloren e tij. Statuti i USH-së është miratuar me Vendim të Senatit nr. prot. 725, datë 02.03.2018, (Ref.1.1 [Link](#)) dhe është miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, nr. 366, dt. 05/07/2018. (Ref.1.2 [Link](#)) Statuti në kuadër të zgjerimit të fakulteteve me departamente dhe nevojës për t’i pasqyruar ato në organigramë, ka pësuar ndryshime. (Ref.1.3 [Link](#))

Bashkangjitur, vendimi për miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e USH-së. (Ref.1.4 [Link](#)) Në Statutin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” përcaktohet qartë misioni i institucionit, autonomia dhe liria akademike, paprekshmëria e tij, organizimi dhe strukturat përbërëse, veprimtaritë dhe kompetencat e autoriteteve e organeve drejtuese, mënyrat e zgjedhjes dhe emërimit të tyre, si dhe nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative. Statuti rregullon periudhat dhe mënyrat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave dhe të programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, të studentëve, si dhe çdo çështje tjetër që garanton funksionimin e institucionit. Në mbështetje të statutit janë miratuar një sërë aktesh rregullatore si:

1. Rregullorja e Administratës së Rektoratit të USH-së, e cila rregullon veprimtarinë administrative të institucionit në përputhje me objektivat dhe misionin e tij ligjor. Kjo rregullore mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin e Punës, në Kodin e Procedurave Administrative, në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë”, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij dhe në Statutin e USH-së. Rregullorja, e miratuar nga Senati Akademik, është e harmonizuar me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL”. (Ref.1.5 [Link](#))
2. Rregullorja e Punësimit në USH, e cila përcakton parimet dhe procedurat e punësimit të stafit akademik dhe administrativ, në përputhje me kuadrin ligjor të arsimit të lartë dhe me Statutin e institucionit. (Ref.1.6 [Link](#))
3. Rregullorja e Studimeve në Universitetin e Shkodrës, e miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr. 182, datë 28.05.2019, pasuar nga vendimi nr. 218, datë 22.01.2020, si dhe ndryshimet e mëvonshme të miratuara me vendimin nr. 109, datë 27.03.2025. Kjo rregullore rregullon veprimtarinë mësimore, kërkimore-shkencore dhe administrative të Fakulteteve të USH-së, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 dhe me Statutin e Universitetit. (Ref.1.7 [Link](#))
4. Rregullorja “Mbi hartimin, zbatimin dhe menaxhimin e projekteve në Universitetin e Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’, miratuar me vendimin nr. 271, datë 30.10.2025, e cila përcakton procedurat, përgjegjësitë dhe standardet në menaxhimin e projekteve kërkimore-shkencore dhe zhvillimore. 1.9 [Link](#))

Çdo rregullore e hartuar miratohet në Senat: “Për miratimin e Rregullores së studimeve në USH”, vendim i Senatit Akademik Nr. 218 dt.22/01/2020; (Ref.1.10 [Link](#)) Rregulloret e studimeve në përputhje me kërkesat e kohës kanë pësuar ndryshime, (Ref.1.11 [Link](#)) (Evidenca 1.1.1).

Çdo fakultet harton rregulloret e brendshme, të cilat përfshijnë dispozita që rregullojnë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiave për mbarëvajtjen e punës. Rregulloret e Fakulteteve miratohen me vendim të Senatit Akademik.

Në zbatim të kuadri rregullator, njësitë bazë të fakulteteve hartojnë rregulloret e tyre të brendshme. Në këto rregullore përcaktohet qartë roli i drejtuesit të njësisë bazë dhe i koordinatorit të programit të studimit.

Në procesin e miratimit së akteve rregulluese në nivel fakulteti dhe departamenti, është respektuar plotësisht kuadri ligjor dhe statuti i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Fakultetet disponojnë Rregulloret e Programeve të Studimit. (Evidenca 1.1.2), (Evidenca 1.1.3), (Evidenca 1.1.4.), (Evidenca 1.1.5.).

Për konkretizim, hartimi dhe miratimi i Rregullores së Fakultetit të Shkencave Shoqërore është realizuar me mbi 2/3 e votave të Asamblesë së Personelit Akademik, në përputhje me kërkesat e statutit. (Evidenca 1.1.6.)

Po ashtu, janë hartuar dhe miratuar aktet rregulluese për ciklet e avancuara të studimeve, ndër të cilat:

- Rregullore për Ciklin e Dytë të Studimeve “Studime të Historisë dhe Kulturës Shqiptare”,
- Rregullore për Ciklin e Tretë të Studimeve “Doktoratë në Gjuhë Shqipe”, (Evidenca 1.1.7). (Ref.1.13 [Link](#))

Në të gjithë fakultetet këto akte plotësojnë kuadrin rregullator të drejtimit të tyre dhe garantojnë funksionimin akademik e administrativ në përputhje me standardet institucionale. (Evidenca 1.1.8.); (Evidenca 1.1.9); (Evidenca 1.1.10), (Evidenca 1.1.11), (Evidenca 1.1.12), (Evidenca 1.1.13).

Standardi I.2 Institucioni organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë efikasitet në menaxhim.

Organet kolegjinale të USH-së janë: Asambleja e personelit akademik, Senati Akademik, Komisionet e Përhershme, Rektorati, Dekanati, Bordi i Administrimit dhe Këshilli i Etikës. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” është i organizuar në fakultete, departamente dhe qendra kërkimore, në përputhje të plotë me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. Strukturat menaxhuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara qartë nga strukturat akademike dhe njësitë organizative, duke garantuar funksionimin e duhur institucional. Stafit akademik zotëron kualifikimet e kërkuara shkencore dhe gëzon liri të plotë akademike në mësimdhënie, kërkimin shkencor dhe në të gjitha veprimtaritë e tjera profesionale.

Universiteti përbëhet nga gjashtë fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore
2. Fakulteti i Shkencave të Edukimit
3. Fakulteti Ekonomik
4. Fakulteti i Shkencave të Natyrës
5. Fakulteti i Drejtësisë
6. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Pranë fakulteteve janë ngritur klinika dhe laboratore të cilat ofrojnë shërbime edhe për palët e treta. Një shembull është Klinika e Ligjit në Fakultetin e Drejtësisë, e ngritur mbi bazën e Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 1890, datë 14.06.2021, ndërmjet Universitetit të Shkodrës dhe LëvizAlbania me mbështetjen e OSFA-së. Klinika është themeluar dhe ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili parashikon ngritjen e klinikave ligjore pranë fakulteteve të drejtësisë si struktura që ofrojnë ndihmë juridike parësore. Klinika e Ligjit në USH ka si mision ofrimin e ndihmës juridike falas

për shtetasit në kushte të vështira ekonomike. Studentët dhe laboranti presin qytetarët dhe ofrojnë këshillim juridik fillestar nën mbikëqyrjen profesionale të pedagogut përgjegjës. (Evidenca 1.2.1)

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” disponon faqen zyrtare të internetit: <https://unishk.edu.al/>, ku pasqyrohet informacion i plotë mbi programet e studimit, planet mësimore, stafin akademik, relacionet e mbledhjeve të Rektoratit, vendimet e Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit. Të gjitha aktivitetet dhe njoftimet institucionale publikohen në kohë reale në faqen zyrtare.

Bordi i Administrimit miraton detajimin e grantit të mësimdhënies. (Evidenca 1.2.2.)

Në këtë vijimësi, për çështjen e miratimit të përkohshëm të strukturës së përgjithshme për periudhën janar–shkurt 2025, Bordi i Administrimit, duke u mbështetur në kuadrin ligjor dhe vendimet e Senatit Akademik, ka zhvilluar dhe finalizuar procedurën vendimmarrëse. (Evidenca 1.2.3.)

Këshilli i Etikës i USH-së, si organ kolegjal, trajton çështje që lidhen me etikën, me shkeljet e saj dhe sjelljet e parashikuara nga Kodi i Etikës së USH. (Evidenca 1.2.4)

Dekanati është organ kolegjal vendimmarrës që koordinon veprimtarinë e njësive bazë. Kompetencat e tij janë të përcaktuara në Nenin 27 të Statutit. Dekanati shprehet me vendime. (Evidenca 1.2.5)

Një shembull i menaxhimit efektiv të USH-së është mbledhja e datës 24.01.2025, në të cilën Senati Akademik vendosi ngritjen e grupit të punës për hartimin e Rregullores për organizimin e programeve të studimit të doktoratës në USH. Në vijim, Senati Akademik, me vendimin nr. 13, datë 29.04.2025, “Për miratimin e Rregullores për organizimin e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, duke treguar se organet vendimmarrëse funksionojnë në përputhje me Statutin dhe Ligjin nr. 80/2015. (Evidenca 1.2.6), (Evidenca 1.2.7.)

Në funksion të transparencës dhe komunikimit publik, USH-ja dhe fakultetet e saj kanë forcuar ndjeshëm praninë në rrjetet sociale. Secili fakultet administron llogaritë, ku publikohen njoftime për studentët dhe pedagogët, si edhe aktivitete, projekte dhe arritje të ndryshme akademike të fakultetit. (Evidenca 1.2.8)

Faqet e rrjeteve sociale të USH-së dhe fakulteteve. (Ref.1.2.1. [Link](#), Ref.1.2.2. [Link](#), Ref.1.2.3 [Link](#), Ref.1.2.4. [Link](#), Ref.1.2.5. [Link](#), Ref.1.2.6. [Link](#), Ref.1.2.7. [Link](#))

Standardi I.3 Institucioni harton një strategji zhvillimi.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Zhvillimit, e cila orienton zhvillimin institucional në përputhje me misionin, vizionin dhe prioritetet strategjike të universitetit. Strategjia është miratuar nga Senati Akademik me Vendimin nr. 115, datë 31.05.2022 “Për miratimin e Strategjisë së zhvillimit të USH-së”. (Evidenca 1.3.1) (Ref. 1.3.1 [Link](#))

Procesi i hartimit të Strategjisë së Zhvillimit është realizuar nga një grup pune i përbërë nga pedagogë me eksperiencë, të caktuar me urdhër të Rektorit. Dokumenti strategjik është diskutuar gjerësisht në organet drejtuese dhe autoritetet akademike të universitetit, duke reflektuar kontributet e njësive përbërëse dhe prioritetet e zhvillimit afatmesëm. Strategjia është e vlefshme për periudhën 2022–2026 dhe përfshin iniciativa dhe projekte konkrete të harmonizuara me fushat e zhvillimit të secilit fakultet.

Në përputhje me dokumentin institucional, të gjithë fakultetet përgatitin strategjitë e tyre. Për shembull, FSHE ka përgatitur strategjinë e tij të zhvillimit, e cila pasqyron misionin e fakultetit dhe objektivat zhvillimore në linjë me platformën strategjike të USH-së. (Evidenca 1.3.2).

Përveç Strategjisë kryesore të zhvillimit, Senati Akademik ka miratuar edhe strategjitë sektoriale, të cilat garantojnë një planifikim të plotë në të gjitha fushat kyçe të veprimtarisë akademike dhe administrative. (Evidencë 1.3.3.)

Vendimi nr. 79, datë 25.03.2022 “Për miratimin e Strategjive sektoriale në USH”. (Ref.1.3.3 [Link](#))

Senati Akademik ka miratuar gjithashtu: Strategjinë e komunikimit dhe informimit publik, Strategjinë e mësimdhënies, Strategjinë e kërkimit shkencor dhe Strategjinë e ndërkombëtarizimit. (Ref. 1.3.4 [Link](#))

Gjithashtu, me Vendimin nr. 93, datë 13.04.2022 “Për miratimin e Strategjisë sektoriale të tregut të punës në USH”, Senati Akademik ka miratuar *dokumentin strategjik* që synon forcimin e lidhjeve të programeve të studimit me nevojat e tregut të punës, rritjen e punësimit të studentëve dhe bashkëpunimin me aktorë lokalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë. (Evidenca 1.3.4),(Ref.1.3.5.

https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2023/Dokumenta_User/Strategjite/Vendim_nr_92_dt_13-04-2022.pdf, Ref.1.3.6.[Link](#), Ref.1.3.8.[Link](#), Ref.1.3.9.[Link](#))

Në këtë mënyrë, USH garanton një qasje të integruar strategjike, duke kombinuar planifikimin afatgjatë institucional me strategjitë sektoriale që mbështesin zhvillimin në fusha specifike si mësimdhënia, kërkimi shkencor, ndërkombëtarizimi dhe orientimi drejt tregut të punës.

Standardi I.4 Institucioni respekton kufijtë e autonomisë së tij.

Autonomia e USH-së është e rregulluar me ligj dhe institucioni i përmbahet plotësisht kufijve të kësaj autonomie. USH-ja zgjedh në mënyrë të pavarur organet dhe autoritetet e veta drejtuese. Duke u bazuar në nenin 3, pika 3 dhe pika 4 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, autonomia universitare nënkupton ushtrimin e autonomisë financiare dhe organizative, përmes së cilës institucioni gëzon të drejtën për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaria mësimdhënëse, për të përfutur fonde nga shteti, për të përcaktuar rregullat e brendshme dhe tarifat e studimit, për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe për t’u vetëqeverisur nëpërmjet zgjedhjes së organeve dhe autoriteteve drejtuese, përcaktimit të kriterëve të pranimit të studentëve Ref. 1.4.1.

https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2024/Vendime/Senati/Vendimi_nr_34_date_05.02.2024.pdf, lidhjes së marrëveshjeve me persona juridikë dhe vendimmarrjes së pavarur mbi numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes; në këtë kuadër, në përputhje me Standardin I.4, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” respekton kufijtë ligjorë të autonomisë së tij dhe i ushtron këto kompetenca në mënyrë të rregulluar dhe transparente, duke garantuar zbatimin efektiv të saj përmes funksionimit të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë dhe Sektorit të Sigurimit të Cilësisë, të ngritur mbi bazën e legjislationit në fuqi dhe Statutit të USH-së, i cili realizon monitorimin dhe vlerësimin periodik të pyetësorëve të miratuar nga Senati, siguron mbledhjen, analizimin dhe përdorimin e informacionit të nevojshëm për administrimin efektiv të programeve të studimit dhe aktiviteteve akademike, si dhe publikon rregullisht informacion të përditësuar, objektiv dhe të paanshëm, si sasi ashtu edhe cilësor, për stafin akademik në sistemin AMS të ASCAL.

Në Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, funksionon *Spektori i Sigurimit të Cilësisë*, i ngritur mbi bazën e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ky sektor në përputhje me aktet ligjore të LAL-së dhe Statutit të USH-së kryen:

- Monitorim dhe vlerësim periodik të pyetësorëve të hartuar dhe të miratuar në Senat;
- Siguron mbledhjen, analizimin dhe përdorimin e të gjithë informacionit të përshtatshëm për administrimin efektiv të programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera.
- Publikon rregullisht informacion të përditësuar, objektiv dhe të paanshëm, si sasi ashtu edhe cilësor, për stafin akademik në sistemin *ams* ASCAL.

Në rang institucioni, Rektori krijon Komisionin për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme, ndërsa njësitë kryesore në Fakultete, kanë të ngritura KSGC-të, këto komisione kanë në përbërje studentë dhe ekspertë të jashtëm të fushës.

Çdo vit SSC, duke u mbështetur në *Paketën e Pyetësorëve* të miratuar në Senat, në bashkëpunim me KSGC-të e njërive bazë, organizon, monitoron, shpërndan, vlerëson pyetësorë drejtuar studentëve, stafit akademik, stafit jo akademik, të diplomuarve dhe punëdhënësve. Fakultetet disponojnë analiza të pyetësorëve sipas kohës së zhvillimit. (Evidencë 1.4.1),

Vendim i NJSBC-së Institucionale. (Evidencë 1.4.2.).

(Ref.1.4.3.

https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2025/Vendime/Senati/vendim_S.A_nr.270-30.10.25.pdf

Vendim i ngritjes së NJSBC-së për vitin 2024-2025. (Evidenca 1.4.3), (Evidencë 1.4.4).

USH-ja është organizuar në mënyrë të tillë që të përfitojë financime nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përveç SSC-së në Rektorat është krijuar Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Ndërkombëtarizimit, që siguron për stafin akademik mbështetje dhe përfitime financiare të vazhdueshme në botime, në marrjen e titujve dhe në aplikime në projekte. Vendim 140, datë 28.4.2025, "Për kryerjen e disa ndryshimeve në vendim të BA-së nr. 220, datë 29.9. 2023 dhe vendimit të SA, nr.270, datë 25.9.2023 "Për financimin e pjesëmarrjes në konferenca shkencore të stafit akademik të USH-së si dhe për trajtimin financiar të koordinatorit të Programit kombëtar për zhvillimin profesional të mësuesve 2024-2025. (Ref. 1.4.5. https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2024/Vendime/Senati/vendim_nr.162_1_.pdf

Ref.1.4.6.[Link](#))

Në mënyrë të vazhdueshme fakultetet kanë përfituar financime dhe vazhdojnë të përfitojë nga pjesëmarrja në këto projekte. (Evidencë 1.4.5)

Në fakultete kemi ndërveprim dhe vetëdrejtim në përcaktimin e projekteve të kërkimit që shprehet nëpërmjet kërkesës për projekte dhe relacioneve për ta. (Evidenca 1.4.6)

Vetëdrejtim për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse. (Evidenca 1.4.7).

Standardi I.5. Institucioni favorizon debatin konstruktiv.

USH-ja ushtron autonominë e saj organizative përmes funksionimit të strukturave drejtuese dhe vendimmarrëse të organizuara sipas niveleve institucionale, ku përfshihen organet drejtuese si Bordi i Administrimit dhe Dekanatet, si dhe struktura të tjera me rol këshillimor dhe rregullator, përfshirë Këshillin e Etikës dhe komisionet përkatëse, të cilat kontribuojnë në garantimin e standardeve akademike, etike dhe institucionale. Këto struktura luajnë një rol të rëndësishëm në formulimin e mendimeve, propozimeve dhe rekomandimeve, të cilat, sipas kompetencave të përcaktuara në Statutin e USH-së dhe aktet nënligjore përkatëse, i përcillen autoriteteve drejtuese për shqyrtim dhe vendimmarrje. Një rol thelbësor në këtë proces ka edhe personeli akademik, i cili merr pjesë aktivisht në debatin e brendshëm dhe në proceset vendimmarrëse përmes Asamblesë së personelit akademik, në përputhje me procedurat institucionale të parashikuara në Statut, ku aktet themelore rregullatore të institucionit, si Statuti, Rregullorja e Studimeve dhe rregulloret e tjera të brendshme, miratohen me shumicë të cilësuar prej 2/3 të votave të Asamblesë, duke garantuar transparencë, përfaqësim dhe respektim të kufijve ligjorë të autonomisë institucionale. Materialet e nevojshme për diskutim përgatiten dhe vihen në dispozicion të anëtarëve të organeve kolegjiale përpara marrjes së vendimeve. Senati dhe organet e tjera kolegjiale mblidhen periodikisht, sipas përcaktimeve të Statutit të USH-së, dhe informacioni për pikat e rendit të ditës u shpërndahet anëtarëve paraprakisht në mënyrë elektronike. Senati Akademik mblidhet, si rregull, një herë në muaj; Bordi i Administrimit

mblidhet të paktën një herë në dy muaj; ndërsa organet e tjera mblidhen sipas nevojave. Mendimet dhe propozimet e Senatit Akademik dhe organeve kolegjiale përkthehen në vendime të detyrueshme për zbatim në njësitë bazë.

Fakultetet nxisin debatin konstruktiv duke filluar nga njësitë bazë e deri te dekanati, përmes mbledhjeve që shpallen paraprakisht, duke u dhënë anëtarëve mundësinë të njihen me agjendën dhe të përgatiten për diskutim. Raport i mbledhjeve të 3 departamenteve të FGJH-s për kërkimin shkencor. (Evidencë 1.5.1),

E njëjta frymë diskutimi ndiqet edhe në nivel njësisht qendrore.

Grupet e vetëvlerësimit kanë në përbërjen e tyre studentë dhe ekspertë të jashtëm që japin ide e propozime që synojnë rritjen e cilësisë: (Evidenca 1.5.2/3/4/5); (Evidenca 1.5.6.).

E njëjta procedurë ndiqet edhe në nivele të tjera drejtimi. (Evidenca 1.5.7).

Vendim për Komisionin Ad-hoc për GVB, (Evidenca 1.5.8).(Evidenca 1.5.9). (Evidenca 1.5.10).

Standardi I.6. Institucioni publikon veprimtarinë kryesore të organeve kolegjiale, raportin vjetor dhe aspekte të tjera të lidhura me transparencën.

Raporti vjetor i USH-së hartohet në fund të çdo viti akademik. Raporti përgatitet nga Rektorati dhe paraqitet përpara Senatit Akademik. Raporti pasqyron veprimtarinë dhe aktivitetet e brendshme, si dhe veprimtaritë e jashtme të institucionit. Prej tre vitesh, këtij raporti i është shtuar edhe seksioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në USH, i hartuar nga një grup pune ku përfshihet edhe një ekspert i jashtëm.

(Ref.1.6.1 https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2024/Vendime/Senati/4243.1_rek_24_-3-130.pdf 1.6.2.Link), (Evidencë 1.6.1).

Raporti shërben si mjet i rëndësishëm për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, pasi përmban një analizë të detajuar që rezulton nga analizat e veçanta të çdo fakulteti, duke përfshirë arritjet dhe problematikat e institucionit në tërësi. Çdo fakultet paraqet raportet dhe analizat e veta, të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e raportit të përgjithshëm të USH-së.

Raporti i veprimtarisë së USH-së paraqitet pranë MAS. Pas dorëzimit në MAS, publikohet në faqen zyrtare të USH-së, në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi. (Ref.1.6.5. [Link](#))

Raportet e miratuara në njësitë bazë për punën mësimore dhe shkencore gjatë një viti akademik miratohen në Dekanat, i cili harton raportin dhe ia përcjell atë Rektoratit, (Evidenca 1.6.12, 1.6.13, 1.6.14, 1.6.15, 1.6.16, 1.6.17). (Evidencë 1.6.18).

Në fakultete, Dekanët dhe zv. dekanët hartojnë raportin e punës mësimore-shkencore për të gjithë fakultetin, i cili më pas diskutohet në mbledhjen e Dekanatit. Pasi miratohet, raporti i përcillet Rektoratit (Evidenca 1.6.2), (Evidenca 1.6.3), (Evidenca 1.6.4), (Evidenca 1.6.5), (Evidenca 1.6.6), (Evidencë 1.6.7).

Krahas raporteve të punës kërkimore-shkencore, hartohen, diskutohen dhe miratohen në mbledhjet e departamenteve dhe ato të dekanatit edhe RVB-të e programeve të studimit, të cilat pasqyrojnë ecurinë dhe problematikat e secilit program. Këto raporte përgatiten dhe paraqiten nga grupet përkatëse të përzgjedhura në mbledhjet e departamenteve. (Evidencë 1.6.8), (Evidencë 1.6.11)

Komisionet e diplomave, miratimi i temave dhe dokumentet e tjera përkatëse publikohen në këndin informativ të universitetit dhe në faqen online (Evidenca 1.6.9).

Anëtarët e Senatit paraqesin për kolegët relacione mbi mbledhjet e Senatit Akademik. (Evidenca 1.6.10.)

Standardi I.7 Institucioni harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë në programe e studimit që ofron.

Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë (LAL 80/2015), në USH janë miratuar akte dhe rregullore përkatëse, të cilat përfshijnë rregullime normative lidhur me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Statuti i Universitetit parashikon komisionet përgjegjëse për monitorimin e standardeve të cilësisë dhe të proceseve të lidhura me to. Konkretisht, neni 23 i Statutit përcakton ngritjen e Komisionit për Garantimin e Standardeve të Cilësisë (KGSC) në nivel universiteti (Ref.1.7.1 [Link](#)), (Evidenca 1.7.1) dhe në njësitë kryesore, si dhe detyrimin për ngritjen e komisioneve për garantimin e standardeve të programeve të studimit. Me vendimin e Senatit të USH-së nr. 92, datë 13.04.2022, është miratuar “Manuali i Cilësisë në USH”, i cili synon të sigurojë dhe të monitorojë cilësinë në institucion dhe në programet e studimit. (Evidenca 1.7.2), (Ref.1.7.2 [Link](#))

NJSBC e fakultetit harton raporte në lidhje me respektimin e standardeve dhe kriterëve të cilësisë. NJSBC e fakultetit diskuton dhe vendos çështje të fushës së menaxhimit të cilësisë, promovon, bashkëpunon dhe monitoron veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në Fakultet. Çdo vit, NJSBC e fakultetit harton RVB-në në nivel Fakulteti, e cila shërben si bazë së bashku me RVB-të e fakulteteve të tjera për përgatitjen e RVB-së në nivel institucioni. (Evidenca 1.7.3; Evidenca 1.7.4).

SSC organizon takime të herëpashershme me grupet e NJSBC-ve të fakulteteve për përmirësimin e cilësisë në fakultete. (Evidencë 1.7.5). Në datat 11, 12 Nëntor 2025, zyra e Sigurimit të Cilësisë zhvilloi takime me anëtarët e KGSC-ve, për hartimin e RVB-së së fakultetit në përputhje me modelin zyrtar të vetëvlerësimit. (Evidenca 1.7.13)

Për shembull, me vendimin e Dekanatit të datës 10.11.2025, nr. prot. 697, është ngritur KGSC në Fakultetin e Drejtësisë (Evidenca 1.7.6), dhe në FSHN në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 2 pika ç, Neni 103, pika 1, bazuar në propozimet e përgjegjësve të Departamenteve dhe në dakordësimin e anëtarëve të NJSBC-së, dekanati i Fakultetit në mbledhjen e datës 17.11.2025 ristrukturoi Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë (Evidenca 1.7.14). Paralelisht, bazuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Fakulteti i Drejtësisë ka krijuar Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), (Evidenca 1.7.7) për programet e studimit që ofron, me vendimin e Dekanatit të datës 10.11.2025, nr. prot. 696 (Evidenca 1.7.8). (Evidenca 1.7.9).

Pyetësi për vitin akademik 2024–2025 është organizuar nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë e UNISHK dhe rezultatet janë analizuar gjithashtu nga departamentet përkatëse. (Evidenca 1.7.10).

Zyra e Sigurimit të Cilësisë ka realizuar dhe përpunuar pyetësorët, duke ofruar vlerësimin e saj për vitin akademik 2024–2025.

Standardi I.8 Institucioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programet e studimit për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Fakultetet në USH bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të monitoruar programet e studimit që ofrojnë. Përveç analizës vjetore të punës mësimore-shkencore, në fillim të çdo viti akademik secili departament miraton, në një mbledhje të posaçme, syllabuset e lëndëve përkatëse, duke raportuar ndryshimet e kryera dhe arsyet që i kanë motivuar ato. (Evidencë 1.8.1).

Institucioni kryen në mënyrë periodike kontrole mbi hartimin e syllabuseve nga departamentet, dhe harton raportin përfundimtar, bazuar në aktet nënligjore në fuqi (MAS), si dhe në aktet ligjore të USH-së. (Evidencë 1.8.2).

Po ashtu, në fakultete është kthyer tashmë në traditë mbledhja e mendimit të studentëve që diplomohen, përmes pyetësorëve. Pyetësi për vitin akademik 2024-25 është organizuar nga Sektori i Sigurimit të Cilësisë dhe rezultatet janë analizuar nga departamentet përkatëse.

(Evidenca: 1.8.3.). Sektori i Sigurimit të Cilësisë përpunon të dhënat që dalin nga pyetësorët. Këto të dhëna analizohen nga njësitë bazë të cilat hartojnë raportet përkatëse që u përcillen Sektorit të Sigurimit të Cilësisë (Evidenca:1.8.4./5/6/7).

Fakultetet organizojnë rregullisht, në fillim të çdo semestri, seanca orientuese dhe informuese, në të cilat departamentet prezantojnë informacionet e nevojshme mbi përmbajtjen e programeve të studimit. (Evidenca 1.8.8).

Studentëve u vihet në dispozicion informacion i përditësuar online, përmes faqes zyrtare të Universitetit <https://unishk.edu.al/>.

Në ambientet e përbashkëta të fakulteteve ka kënde të posaçme informuese, ku publikohen njoftime lidhur me programet e studimit dhe oraret mësimore.

Universiteti mban kontakte të vazhdueshme dhe konsultohen me të dhënat e institucioneve publike dhe private. (Ref.1.8.2. [Link](#)) (Evidenca 1.8.9) (Ref.1.8.3. [Link](#)) (Ref.1.8.4. [Link](#), Ref.1.8.5.[Link](#)), (Evidencë 1.8.10) (Ref.1.8.6. [Link](#), Ref.1.8.7. [Link](#)), (Evidencë 1.8.11).

Të dhëna nga Alumni (Evidenca 1.8.12).

USH-ja mban kontakte të rregullta me ZVA-në dhe drejtuesit e shkollave të mesme. Në këtë kuadër, universiteti organizon “Ditët e hapura” në shkollat e mesme të Shkodrës dhe më gjerë, me qëllim informimin e maturantëve mbi programet e studimit që ofron.

Hapja e programeve të reja të studimit bazohet në VKM-të, në udhëzimet e MAS-it dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, të cilat përcaktojnë kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për hapjen ose riorganizimin e programeve. Sa i përket politikave të pranimit të studentëve vendas dhe të huaj, USH-ja zbaton udhëzimet e dërguara nga MAS-i dhe parashikimet e Statutit të vet. (Evidencë 1.8.14) (Ref.1.8.11.[Link](#))

Programet e studimit përmirësohen në bazë të rezultateve të vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe nga studentët. (Evidencë 1.8.15) .

Procesi i përmirësimit të programeve realizohet përmes disa analizave si: analizës SWOT, veprimtarisë mësimore, raportit vjetor të punës shkencore, analizës së punës mësimore-shkencore, të cilat përfshihen në çdo RVB. (Evidencë 1.8.16), (Evidencë 1.8.17), (Evidencë 1.8.18), (Evidencë 1.8.19) .

RVB-të diskutohen dhe miratohen fillimisht në departamentet përkatëse, pastaj kalojnë për shqyrtim dhe miratim në dekanat dhe më pas në Rektorat. (Evidencë 1.8.20), (Evidencë 1.8.21), (Evidencë 1.8.22), (Evidencë 1.8.23).

Testimi i aftësive të studentëve mbështetet në rregulloret e studimit të USH-së, miratuar nga SA i USH-së me Vendim nr.182, dt. 28.05.2019. (Ref.1.8.13. [Link](#)), ndryshuar me vendim Nr. 218 datë 22.01.2020. (Evidencë 1.8.24.).

Për shembull, në FSHSH p.sh., të gjitha programet u prezantohen studentëve në faqen online të fakultetit. (Ref.1.8.15. [Link](#)), (Evidencë 1.8.25.), (Ref.1.8.16. [Link](#)), (Evidencë 1.8.26.).

Standardi I.9 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës.

Universiteti “Luigj Gurakuqi” përdor procedura dhe metodologji të qarta vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese, të cilat shërbejnë për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, në procesin e diplomimit dhe përgatitjen e studentëve për dalje në tregun e punës. Në vlerësimin e programeve, Drejtoria e Kurrikulave, monitoron përmbushjen e standardeve dhe respektimin e akteve nënligjore, si dhe ndihmon në hartimin e tyre. Në funksion të realizimit të zhvillimit dhe ecurisë së programeve të studimit është miratuar *Paketa e instrumenteve* për matjen e cilësisë në USH, me Vendim të Senatit Akademik, Nr. 270, datë 19.12.2022 dhe Rregullorja e studimeve. (Evidencë 1.9.1.).

Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të rajonit, duke vënë theksin në aftësimin e studentëve, që përbën një nga objektivat kryesore të strategjisë së universitetit.

Në këtë kuadër, FSHN, për vitin akademik 2024-2025, ka hapur këto programe studimi: Master i Shkencave “Infermieri Klinike” me 120 kredite; Master i Shkencave në Mësuesi në “Biologji-Kimi” me 120 kredite; Master i Shkencave në “Sigurimin e cilësisë së ushqimit dhe të ushqyerit” me 120 kredite; Master i Shkencave në mësuesi në “Matematikë – Fizikë” me 120 kredite ; Master i Shkencave në mësuesi “Informatikë” me 120 kredite dhe Master i Shkencave në mësuesi “Matematikë” 120 kredite. (Evidenca 1.9.18), (Evidenca 1.9.19), (Evidenca 1.9.20) Në Strategjitë e USH-së 2022-2026 janë përcaktuar prioritetet kryesore për këtë periudhë, duke përfshirë: mësimdhënien dhe studentët, kërkimin shkencor, ndërkombëtarizimin, ndikimin rajonal dhe qëndrueshmërinë. (Evidencë 1.9.2.).

Në këtë drejtim *Senati Akademik* ka miratuar Strategjitë Sektoriale, Strategjinë e ndërkombëtarizimit të Universitetit, Strategjinë sektoriale të kërkimit dhe inovacionit, Strategjinë e komunikimit dhe informimit publik, si dhe Strategjinë e studimit të tregut të punës, të cilat përcaktojnë qëllime dhe objektiva specifike, duke përfshirë edhe zhvillimin e aftësive të studentëve. (Evidencë 1.9.3), (Evidencë 1.9.4)

Në përputhje me Strategjinë e USH-së 2022-2026, fakultetet kanë hartuar strategjitë e tyre, të cilat janë miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 79, datë 25.03.2022. (Evidencë 1.9.5.). Fakultetet gjithashtu kanë hartuar strategjitë e zhvillimit për programet e studimit në Bachelor. Shembull i tillë vjen nga FSHE dhe departamenti i mësuesisë për arsimin parashkollor (Evidencë 1.9.4.2), arsimin fillor (Evidencë 1.9.6). Bashkëshoqëruar është Miratimi i Planit Strategjik për programin e studimit Bachelor në Psikologji (2022- 2026). (Evidencë 1.9.7).

Në vendimin e Senatit Akademik Nr. 93, datë 13.04.2022 është miratuar “Strategjia sektoriale e tregut të punës”, e cila përcakton qartë objektivat konkrete për përgatitjen e studentëve në përputhje me nevojat e tregut të punës. (Ref.1.9.5. [Link](#)), (Evidencë 1.9.8).

Në këtë drejtim, programet e studimit përmbajnë informacion të mjaftueshëm dhe koherent për studentët, duke përfshirë rubrikat përkatëse në përputhje me bazën ligjore. Ato përditësohen rregullisht me literaturë bashkëkohore, në funksion të zhvillimit dhe ecurisë së programeve.

NJSBC e FSHSH-së konsultohet çdo vit me të dhëna të ndryshme, duke siguruar kështu një përmirësim të vazhdueshëm të programeve të studimit për përshtatjen e tyre me kërkesat akademike dhe nevojat e studentëve si:

1. Studimi i ASCAP: (Ref.1.9.6. [Link](#)),
2. Të dhëna nga INSTAT për kulturën dhe arsimin: (Ref. 1.9.7.[Link](#)),
3. Të dhëna nga Bashkia Shkodër: (Ref.1.9.8. [Link](#)),
4. Të dhëna nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Para universitar (Lezhë) dhe DAR Shkodër: (Ref.1.9.10. [Link](#)), (Evidenca 1.9.10/11/12),
5. Të dhëna nga U Albania: (Ref. [Link](#), [Link](#)),
6. Të dhëna nga Alumni (Evidenca 1.9.13).

Fakultetet përpiqen të monitorojnë punësimin e të diplomuarve të tyre gjatë viteve, zakonisht një vit pas diplomimit, me mbështetjen e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe platformës ALUMNI.

Në kuadër të procesit të akreditimit të programeve të studimit, shumë departamente kanë realizuar studimin e tregut të punës, duke mundur përparësi në zhvillimin e programeve bazuar në nevojat reale të rajonit.

Të dhënat dhe gjetjet e nxjerra nga pyetësorët e diskutuar në departamente, shërbejnë si bazë për përmirësimin e programeve të studimit. (Evidenca 1.9. 14). Kështu p.sh., në FSHE, raporti i analizës së pyetësorëve të studentëve për çdo program studimi, analizohet në mbledhjet e caktuara në departamentet përkatëse, pastaj kalon për miratim në dekanat dhe më pas

protokollohet dhe i dërgohet zyrës së sigurimit të cilësisë. (Evidenca 1.9.15), (Evidencë 1.9.16).

Në FSHE janë miratuar dhe modulet për mikrokredencialin kombëtar “Si të zhvillojmë një kurs MOOC”, si dhe syllabuset po në kuadër të MC Institucional “Edukimi për gjithëpërfshirjen në klasë si themel i suksesit”. (Ref. [Link](#)), (Evidencë 1.9.17).

Standardi I.10 Institucioni përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Departamentet angazhohen periodikisht në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë në fakultete. Në çdo fakulteteve krijohen grupet e punës për hartimin e Raportit Vjetor të Brendshëm të Fakultetit (RVB) të përbëra nga pedagogë, studentë dhe ekspertë të fushës. Universiteti “Luigj Gurakuqi” bën përpjekje të vazhdueshme për të vlerësuar përvojat e fituara në këtë proces. Mbështetur në *Statutin e USH-së*, neni 18, pika 2/b., në fakultete janë ngritur dhe funksionojnë *Komisionet për garantimin e standardeve të cilësisë në USH dhe programeve të studimit*, (të cilat kryejnë vlerësimin e aspekteve të ndryshme të realizimit të programeve. (Evidenca 1.10.1).

Rezultatet e pyetësorëve diskutohen në departamente dhe përcillen në dekanat, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të punës, veçanërisht në problematikat e evidentuara nga studentët. (Evidenca.1.10.2.; 1.10. 3; 1.10. 4; 1.10. 5).

Bashkëngjitur janë disa vendime që fakultetet si njësi qendrore marrin, si:

Vendimi i Dekanatit Nr. datë 10.11.2025, nr. prot. 697, *Për ngritjen e Komisionit të Garantimit të Standardeve të Cilësisë në FD*, (Evidenca 1.10.6).

Vendimi i Dekanatit *Për ngritjen e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm* po në FD, datë 10.11.2025, Nr. prot. 696. (Evidenca 1.10.7).

Miratimi i GVB-së në Lëndët Klinike. (Evidenca 1.10.8).

Standardi I.11 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Politikat, proceset dhe veprimtaritë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë transparente dhe efektive, duke synuar krijimin e një kulture të brendshme të cilësisë në të gjitha programet e studimit. Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Universiteti ka përgatitur Programin e Transparencës. Ky program përcakton rregullat bazë të organizimit dhe funksionimit të universitetit, duke respektuar legjislacionin për arsimin e lartë. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka miratuar Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, miratuar në mbledhjen e datës 23.04.2025, në zbatim të Ligjit nr.80/2015, ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Statutit të universitetit dhe rekomandimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, (Evidenca 1.11.1.). Në këtë kuadër, procesi i hartimit të RVB-ve realizohet nëpërmjet një qasjeje të strukturuar dhe të dokumentuar, ku përfshihen të gjithë aktorët institucionalë. Hartimi i raportit të vlerësimit të brendshëm për çdo program studimi nis në nivel departamenti. Përgjegjësi i departamentit koordinon mbledhjen për marrjen e mendimeve dhe administron dokumentacionin përkatës, ndërsa të gjithë anëtarët e departamentit kontribuojnë në zbardhjen dhe përditësimin e të dhënave. Procesi pasurohet me vlerësimet e studentëve, të ekspertit të jashtëm dhe me evidencat e siguruar nga sekretaria mësimore dhe dekanati. (Evidenca 1.11.2.)

RVB-të e përgatitura i nënshtrohen fillimisht miratimit në departament dhe më pas në dekanat. Pas miratimit, raportet përcillen në Rektorat për procedurat e mëtejshme institucionale, duke siguruar kështu transparencë dhe zinxhir të qartë përgjegjshmërie.

Po kështu edhe raportet mbi programet e studimit mbështeten në të dhënat e pyetësorëve të studentëve. (Evidencë 1.11.3). Përmes këtij procesi nxirren konkluzione të rëndësishme, të cilat përdoren për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, në përputhje me parimet e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe me standardin përkatës.

Përfundimi dhe Vlerësimi

Universiteti “Luigj Gurakuqi” ushtron veprimtarinë e tij akademike dhe shkencore në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin e USH-së dhe aktet e tjera të miratuara nga organet dhe autoritetet qeverisëse të universitetit. Fakultetet dhe departamentet mbështeten gjithashtu në rregulloret përkatëse të miratuara me vendim të Senatit Akademik, duke garantuar kështu një bazë të qëndrueshme ligjore dhe institucionale për funksionimin e tyre.

Në nivel departamenti, vendimet merren në mbledhje të departamenteve ku secili anëtar ka mundësinë të shprehë mendimin e tij, duke siguruar një proces debati konstruktiv. E njëjta frymë diskutimi mbizotëron edhe në dekanate dhe në Rektorat.

Grupi i vetëvlerësimit përfshin studentë dhe ekspertë të jashtëm, të cilët kontribuojnë me sugjerime dhe ide për përmirësimin e cilësisë së programeve akademike.

Fakultetet veprojnë në përputhje me Statutin e Universitetit, duke miratuar aktet rregulluese për fakultetin, departamentet dhe programet e studimit. Fakultetet sigurojnë menaxhim efikas përmes koordinimit të stafit akademik dhe administrativ, dhe hartojnë strategjitë e zhvillimit në përputhje me strategjinë e USH-së. Ato respektojnë autonominë organizative, nxitin debatin konstruktiv dhe publikojnë veprimtarinë e organeve kolegjiale për transparencë.

Fakultetet zbatojnë politika dhe procedura korrekte për sigurimin e cilësisë, monitorojnë programet e studimit përmes instrumenteve të vlerësimit dhe përfshijnë njësitë akademike dhe studentët në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë (SBC). Megjithatë, identifikohet nevoja për përmirësim në informimin e palëve të interesuara dhe në rritjen e transparencës së politikave dhe aktiviteteve të cilësisë (Raporti Vjetor të Auditimit, Vendimi nr. 45, 06.02.2025). Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit përbën një qëllim kryesor për të gjitha departamentet.

Në Fakultete janë ngritur Komisionet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), ndërsa Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), hartojnë raportet për programet e studimit. Këto raporte diskutohen dhe miratohen fillimisht në nivel departamenti, më pas në dekanate dhe dërgohen në Rektorat për vlerësim të mëtejshëm.

Fakultetet monitorojnë programet e studimit përmes analizës vjetore të punës mësimore-shkencore dhe miratimit të syllabuseve të lëndëve në fillim të vitit akademik. Ndryshimet raportohen bashkë me arsyet përkatëse të cilat dokumentohen në mbledhjet e departamenteve. Për më tepër, fakultetet kanë krijuar traditë në marrjen e mendimit të studentëve që diplomohen, të cilët plotësojnë pyetësorë mbi cilësinë e programeve në ditën e diplomimit.

Përpjekjet e fakulteteve për hapjen e programeve të reja të studimit dhe riorganizimin e programeve ekzistuese vazhdojnë në mënyrë sistematike, duke kontribuar në zhvillimin akademik dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit të ofruar. Për shembull, FSHE ka hapur dy programe të reja Master profesional Mësues Muzike dhe Mësues i Artit Pamor dhe po vijon procedurat për akreditimin e programeve të tjera për periudhën 2025–2026. Aktualisht në këtë fakultet janë akredituar 4 programe Bachelor si: Arsimi Fillor, Arsimi Parashkollor, Edukimi Fizik e Sporte dhe Psikologji.

Vlerësimi i fushës: Standardet e sigurisë së brendshme të cilësisë dhe monitorimit të programeve përmbushen plotësisht.

FUSHA II – BURIMET DHE PARTNERITETI

Standardi II.1 Institucion ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekrutimit të burimeve njerëzore.

Universiteti ndjek një politikë të qartë dhe të strukturuar për rekrutimin e pedagogëve, sipas Rregullores së Punësimit të miratuar me Vendimin nr. 25, datë 24.01.2025, dhe në përputhje me Vendimin nr. 54, datë 21.02.2025, “Për miratimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik të angazhuar me ushtrimin e funksioneve në strukturat administrative të USH-së”. Organigrama e Universitetit “Luigj Gurakuqi” (USH) është e publikuar në faqen zyrtare të universitetit (www.unishk.edu.al). Në menaxhimin e burimeve njerëzore, USH zbaton një politikë rekrutimi, të bazuar në Rregulloren “Rregullorja e punësimit në USH”, e cila është përditësuar me vendimin nr. 25, datë 24.01.2025 të Senatit Akademik. (Evidencë 2.1.1.).

Kjo rregullore përcakton qartë kriteret, procedurat, afatet dhe përgjegjësitë institucionale në procesin e përzgjedhjes dhe punësimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. (Ref. 2.1.2.[Link](#), Ref.2.1.3.[Link](#)), (Evidencë 2.1.2).

Në fakultete, nevojat për pedagogë, qoftë të brendshëm apo të jashtëm, deklarohen nga përgjegjësit e departamenteve dhe miratohen nga Dekani para dërgimit tek Rektori. Publikimi bëhet në faqen zyrtare të USH-së dhe në Buletinin e APP-së. (Evidenca 2.1.6, 2.1.7), (Evidenca 2.1.8).

Vendet vakante shpallen në Buletinin e Njoftimeve Publike pranë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), (Evidenca 2.1.3) dhe në faqen zyrtare të USH-së, duke u mbështetur në Rregulloren e Punësimit. Konkretisht, njoftime të aplikimit online janë si më poshtë: (Ref. 2.1.5. [Link](#)), (Ref. 2.1.4. [Link](#)), (Evidencë 2.1.4). Çdo njoftim përmban informacion të detajuar mbi: pozicionin, përshkrimin e vendit të punës, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, dokumentet që kandidatët duhet të paraqesin, afatin e aplikimit, vendin e dorëzimit të dokumentacionit dhe mënyrën e konkurrimit. Pas shpalljes, institucioni ndjek procedurat e rekrutimit sipas kriterëve dhe afateve të përcaktuara. (Evidencë 2.1.5). Komisionet ad hoc, të ngritura me vendim të organeve kompetente, realizojnë vlerësimin e kandidatëve në kuadër të procedurës së konkursit, në përputhje me kriteret, hapat dhe afatet e përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit; rezultatet e vlerësimit dhe propozimet përkatëse i paraqiten për miratim më pas, Rektorit të institucionit, në përputhje me hierarkinë vendimmarrëse.

Kandidatët fitues nënshkruajnë kontratën e punës me Rektorin, në përputhje me legjislacionin për Arsimin e Lartë dhe Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Dokumentacioni dhe vendimet arkivohen dhe janë të disponueshme në zyrën e burimeve njerëzore të USH-së dhe në sekretarinë e dekanit të fakultetit.

Referencat e procedurave rekrutuese përfshijnë, njoftim me nr. prot. __, datë __, dhe vendimin me nr. __ prot., të komisionit Ad-hoc, që dokumentojnë zbatimin konkret të procedurave të rekrutimit. Ky proces siguron transparencë, qartësi dhe përputhshmëri me legjislacionin e arsimit të lartë dhe standardet e brendshme të cilësisë në USH.

Performanca e stafit akademik vlerësohet në mënyrë të rregullt përmes analizës së procesit mësimor dhe raportimeve vjetore shkencore, të cilat shërbejnë si mekanizëm për përmirësim profesional dhe si referencë në proceset e riemërimit ose ngritjes në detyrë. (Evidencë 2.1.8), (Evidencë 2.1.9), (Evidenca 2.1.10).

Standardi II.2 Institucion ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.

USH-ja ndjek një politikë integruese të menaxhimit të personelit, duke nxitur bashkëveprimin efektiv ndërmjet stafit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme, si brenda departamenteve ashtu edhe ndërmjet fakulteteve, me qëllim garantimin e cilësisë dhe vazhdimësisë së procesit mësimor (Evidenca 2.2.1). Ky bashkëpunim reflektohet në zhvillimin e lëndëve, organizimin e aktiviteteve akademike dhe përfshirjen e stafit në jetën institucionale.

Stafi akademik me kohë të pjesshme merr pjesë aktive në procesin mësimor, duke kontribuar në zbatimin e syllabuseve të miratuara, në përcaktimin dhe zbatimin e mënyrave të vlerësimit, zhvillimin e seminareve, përgatitjen e testeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, si dhe në procesin e vlerësimit të studentëve (Evidenca 2.2.2). Ky staf bashkëpunon ngushtësisht me stafin akademik me kohë të plotë përgjegjës për lëndën, veçanërisht në koordinimin e metodave të mësimdhënies, zhvillimin e seminareve, hartimin e instrumenteve të vlerësimit dhe garantimin e koherencës së procesit mësimor. Stafi akademik me kohë të pjesshme në përputhje me rregulloret në fuqi raporton periodikisht për veprimtarinë mësimore dhe shkencore të zhvilluar, duke kontribuar në sigurimin e cilësisë së procesit akademik. Për realizimin efikas të procesit mësimor, stafi akademik bashkëpunon ngushtë me sekretarinë mësimore në të gjitha aspektet administrative që lidhen me organizimin e mësimi, dokumentacionin akademik dhe menaxhimin e studentëve (Evidenca 2.2.3).

Nevojat për pedagogë në fakultete identifikohen dhe dokumentohen në mënyrë të rregullt, në përputhje me zhvillimet e programeve të studimit dhe ngarkesën mësimore, duke shërbyer si bazë për planifikimin e burimeve njerëzore dhe procedurat e rekrutimit (Evidenca 2.2.10). Në kuadër të projekteve ndërkombëtare universiteti operon me: Erasmus+ (Tempus), Erasmus Mundus dhe CEEPUS, duke promovuar pjesëmarrjen e stafit akademik dhe administrativ në mobilitete që sigurojnë përfitime në kualifikime dhe eksperiencë ndërkombëtare.

Po kështu, personeli administrativ ofron asistencë teknike dhe ndihmë praktike, përfshirë udhëzime për përdorimin e platformave elektronike si *SMAC* dhe *Teams*. Personeli administrativ është gjithmonë i gatshëm për të asistuar pranë stafit në përmbushjen e kërkesave të ndryshme, (Evidenca 2.2.4), për çdo problem teknik apo në pajisjen e stafit me guidë ndihmëse. (Evidenca 2.2.5).

Në disa programe studimi mësimdhënia realizohet nga pedagogë të fakulteteve të tjera, bazuar në nevojat e departamenteve. Çdo fillim viti akademik, përgjegjësit hartojnë shkresat përkatëse dhe i dërgojnë tek Dekani, i cili më pas ia përcjell fakultetit përkatës, duke iu siguruar studentëve mësimdhënie të specializuar dhe të duhur. (Evidenca 2.2.6), (Evidencë 2.2.7.), (Evidencë 2.2.8).

USH me politikat e tij nxit integrimin e personelit në veprimtari akademike, kërkimore-shkencore dhe administrative brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë:

- shkëmbime dhe bashkëpunime reciproke mes profesorëve, kërkuesve, studentëve dhe stafit administrativ;
- seminare dhe forma të tjera shkëmbimi njohurish.

Në FGJH një anëtar i personelit administrativ, konkretisht sekretarja mësimore është përfshirë në një mobilitet në kuadër të projektit MIC Erasmus+ me Universitetin Haute Alsace. Po në FGJH, drejtori i departamentit të romanistikës koordinon mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve. (Evidenca 2.2.9).

Këto modele bashkëpunimi sigurojnë në fakultetet mjedise akademike efektive dhe rrisin:

- a. cilësinë e procesit mësimor,
- b. zhvillimin profesional të stafit dh
- c. përmirësimin e eksperiencës së studentëve. Ref. 2.2.2.Link), (Evidenca 2.2.11).

Standardi II.3 Institucion ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij dhe fokusohet në zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Në Vendimin e Senatit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” (USH) Nr. 92, datë 13.04.2022, është miratuar “Manuali i cilësisë në USH”, i cili synon të sigurojë dhe monitorojë cilësinë në universitet dhe në programet e tij të studimit. Ky manual gjen zbatim në fusha të ndryshme, duke përfshirë edhe vlerësimin e performancës së stafit akademik përmes strukturave përgjegjëse dhe përmes studentëve.

Në vijim, USH ka miratuar po me Vendim Senati Nr. 270, datë 19.12.2022, edhe “Paketën e instrumenteve për matjen e cilësisë në USH”, e cila përfshin pyetësorë të ndryshëm që mundësojnë:

- a. vlerësimin e performancës së pedagogut;
- b. vetëvlerësimin e tij;
- c. identifikimin e nevojës për ndërhyrje në zhvillimin e aftësive profesionale të stafit akademik;
- d. për pedagogët me kontratë 1-vjeçare dhe për pedagogët me kohë të pjesshme përgjegjësi i departamentit harton një raport për performancën e tij. Ndërsa institucioni përmes *Formulari i vlerësimit të stafit akademik me kohë të plotë* merr të dhëna për performancën e stafit akademik.

(Evidencë 2.3.1), (Evidenca 2.3.2.), (Evidenca 2.3.3), (Evidenca 2.3.4), (Evidenca 2.3.5). (Evidenca 2.3.20).

Çdo fakultet në USH vlerëson aftësitë dhe performancën e personelit të tij nëpërmjet disa mekanizmave:

- a. Vlerësimi i programeve të studimit nga studentët që diplomohen; (Evidencë 2.3.6).
- b. Analiza e raporteve të vetëvlerësimit të programeve të studimit nga departamentet dhe më pas nga dekanatet; (Evidencë.2.3.7).
- c. Analiza e punës mësimore-shkencore në departamente dhe dekanate (Evidenca 2.3.8; 2.3.9, 2.3.10);
- d. Raporti mësimor-shkencor 2024-2025, (Evidenca 2.3.18).
- e. Diskutimi dhe miratimi i syllabuseve të lëndëve në mbledhjet e departamenteve (Evidenca 2.3.11), (Evidenca 2.3.19);
- f. Përgatitja e shkresave përkatëse nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe përcjellja e tyre tek studentët, (Evidenca 2.3.12).

USH-ja inkurajon zhvillimin profesional të personelit akademik përmes pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe i mbështet financiarisht ato. Vendimi i Senatit të USH, Nr. 143, datë 14.7.2022, për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca shkencore. (Evidenca 2.3.13).

Për të mbështetur dhe promovuar ngritjen profesionale të stafit akademik, USH ka miratuar disa vendime të rëndësishme:

- Me Vendimin e Senatit Nr. 67, datë 10.03.2022, është vendosur mbulimi i tarifës për ndjekjen e procedurës së fitimit të titullit “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” për stafin akademik me kohë të plotë;
- Me Vendimin e Bordit të Administrimit Nr. 75, datë 11.03.2022, janë miratuar tarifat për të njëjtën procedurë (Evidenca 2.3.15 / 2.3. 16).

Në kuadër të politikës institucionale për vlerësimin e aftësive dhe zhvillimin profesional të personelit akademik, Fakulteti Ekonomik (FE) mbështet dhe nxit pjesëmarrjen e stafit në aktivitete shkencore, trajnuese dhe bashkëpunime ndërkombëtare, të cilat shërbejnë si instrumente konkrete për përmirësimin e kompetencave akademike, kërkimore dhe pedagogjike, në përputhje me nevojat e identifikuar përmes mekanizmave të vlerësimit. Në këtë kuadër, personeli akademik i FE-së ka qenë aktivisht i përfshirë në organizimin dhe pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare, si Konferenca “Reshaping Eco-Social Paradigm towards Innovation and Sustainability” (RePTIS), Nëntor 2023, me 121 autorë dhe 66 punime shkencore nga vende të ndryshme të botës, si dhe konferencat CONF TOUR 2024 dhe

CONF TOUR 2025, me më shumë se 40 punime shkencore dhe pjesëmarrjen e doktorantëve të Shkollës së Doktoraturës në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”, të organizuara në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave (Evidenca 2.3.14). Krahas tyre, stafi akademik përfiton nga trajnime brenda dhe jashtë vendit, mobilitete akademike, mësimdhënie në universitete perëndimore dhe pjesëmarrje në projekte e iniciativa ndërkombëtare, të realizuara në bashkëpunim me institucione prestigjioze si Southern Illinois University at Carbondale (SIUC), Sandhills Community College (SCC), Universiteti i Bolonjës, Universiteti i Varshavës, Corvinus University (CEEPUS), Universiteti i Trentos dhe Universiteti i Eberswalde, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin e kualifikimeve profesionale dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Në mbështetje të politikës së vlerësimit të aftësive të personelit të USH-së, SSC, përcjell analizat e pyetësorëve të realizuar me studentët e programeve të studimit departamenteve përkatëse. (Evidenca 2.3.17.).

Ky sistem i strukturuar i vlerësimit dhe zhvillimit profesional siguron një mjedis akademik të koordinuar dhe transparent, i cili mbështet zhvillimin e aftësive të stafit akademik dhe rrit cilësinë e procesit mësimor dhe kërkimor në USH.

Standardi II.4 Institucion ndjek një politikë të zhvillimit social.

Të gjithë departamentet në fakultetet e USH-së i kushtojnë vëmendje zhvillimit të veprimtarive të ndryshme me studentët, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre në veprimtari ekstrakurrikulare dhe në aktivitete të përbashkëta me organizata të ndryshme. Përveç kësaj, vlen të theksohet pjesëmarrja e studentëve në veprimtari artistike dhe sportive, si dhe angazhimi vullnetar në iniciativa të ndryshme, si dhurimi i gjakut dhe aktivitete të tjera humanitare.

Universiteti organizon dhe mbështet veprimtari të ndryshme si: panaiere, forume, takime sensibilizuese, donacione, ekspozita, shfaqje, diskutime tematike, olimpiada, konkurse, takime dhe veprimtari promovuese. Qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve është fuqizimi i dialogut, promovimi i mendimit të lirë dhe kreativitetit të studentëve, si dhe ndërtimi i kompetencave emotive, shoqërizuese dhe edukative.

FSHSH, ka organizuar shkollën verore “Gjeografia e Ekosistemeve të Alpeve Shqiptare”. (Ref.2.4.1. [Link](#)), (Evidencë 2.4.1); konferencën shkencore “Poetika e veprës letrare të Ridvan Dibrës”. (Ref. 2.4.2. [Link](#)), (Evidencë 2.4.2); në fushën e gazetarisë ka organizuar përdorimin për herë të parë të IA-së; takim i studentëve me gazetarin Marin Mema; Ekspozitën e studentëve me titull “Vlerat europiane” dhe “VisitShkodër” (Evidenca online e aktiviteteve me studentët). (Evidencë 2.4.3).

FE, ka organizuar ekspozitën “30 Vjet Fakultet Ekonomik”, e cila prezantoi historinë, traditën dhe zhvillimin akademik e studentor të fakultetit përmes materialeve vizuale të mbledhura nga stafi dhe studentët; (Evidenca 2.4.4); (Evidenca 2.4.5).

Workshop-in “studimi efektiv – mësimi nuk është vetëm për notat, por për jetën!” (Ref. 2.4.3.[Link](#)), (Evidencë 2.4.6)

USH-ja, si çdo institucion publik, siguron pajisjen e stafit me librezë shëndetësore, duke garantuar kontrollin e përvitshëm shëndetësor të personelit. Universiteti vepron në përputhje me kuadrin ligjor për sigurimin shëndetësor dhe social dhe ofron mbështetje financiare në rastet e fatkeqësive familjare ose sëmundjeve të rënda.

Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit janë ndërmarrë iniciativa për mbështetjen e studentëve me aftësi të ndryshme, duke ofruar trajnime për stafin akademik mbi mësimdhënien e tyre, (Evidenca 2.4.7), si dhe përfshirjen aktive të studentëve në aktivitete vullnetare. (Evidenca 2.4.8).

Në FGJH, pedagogë dhe studentë organizojnë veprimtari shoqërore të evidentuara edhe në faqen e internetit të Universitetit. Studentët dhe pedagogët kanë dhuruar vullnetarisht gjak për

personat talasemikë, në seancat e dhurimit të organizuara nga Kryqi i Kuq Shqiptar, nisëm kjo e mbështetur nga Departamenti i Lëndëve Klinike dhe e realizuar në ambientet e këtij fakulteti. (Evidenca 2.4.9.), (Ref.2.4.4. [Link](#)).

Studentët e FSHN-së, nxiten të marrin pjesë në veprimtari ekstrakurrikulare, si dhe në veprimtari të përbashkëta të realizuara me organizata të ndryshme. (Ref. 2.4.5. [Link](#), Studentët e drejtësisë përfshihen vazhdimisht në aktivitetet e organizuara nga fakulteti, duke marrë pjesë në leksione të hapura, konferenca shkencore, (Evidenca 2. 4. 10./2.4.11), trajnime e seminare të certifikuara, të organizuara nga Klinika e Ligjit pranë FD-së ose nga organizata të shoqërisë civile, që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Këto aktivitete u mundësojnë studentëve të angazhohen në shërbim ndaj komunitetit përmes ndërgjegjësimit dhe këshillimit ligjor.

Ky angazhim i strukturuar i studentëve mbështetet nga stafi akademik dhe administrativ, duke promovuar zhvillimin akademik, social dhe personal të studentëve, si dhe duke krijuar mjedise edukative në USH.

Standardi II.5 Institucioni siguron qëndrueshmëri afatgjatë të personelit akademik gjatë periudhës midis dy akreditimeve.

Të gjithë departamentet kanë në përbërjen e tyre staf të kualifikuar me kohë të plotë, që realizon programet e studimit të ofruara prej tyre. Po kështu, edhe përzgjedhja e stafit akademik me kohë të pjesshme bëhet mbi bazën e rankimit të kandidatëve, bazuar në “Rregulloren e punësimit”. (Ref. 2.5.1. [Link](#)), (Evidenca 2.5.9

Zbatimin e vet kjo rregullore e gjen në praktika të ndryshme rekrutuese të zhvilluara nga fakultetet, p.sh., në FSHN, përzgjedhja e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme bëhet mbi bazën e rankimit të kandidatëve, bazuar në Rregulloren e punësimit e përditësuar, (Evidenca 2.5.7; Evidenca 2.5.8).

Institucioni siguron qëndrueshmëri afatgjatë të personelit akademik gjatë periudhës midis dy akreditimeve, për këtë është bërë kërkesa për akreditimin e 39 programeve studimi. Në USH 10 programe studimi e kanë përfunduar procesin e tyre të akreditimit, (Evidencë 2.5.1 /2.5.2.), (Evidenca 2.5.3), (Evidenca 2.5.4), (Evidenca 2.5.5), (Evidenca 2.5.6).

Standardi II.6 Institucioni vlerëson dhe mbështet personelin e vet në përmbushjen e detyrimeve vjetore-akademike e administrative.

USH në bashkëpunim me fakultetet ndjek një politikë të mbështetjes së vazhdueshme të stafit akademik dhe ndihmës akademik, në funksion të realizimit më së miri të objektivave individuale dhe institucionale. (Evidenca 2.6.1).

Pranë USH-së ekziston Zyra e Ekselencës e cila zhvillon trajnimin vjetor “Metodat kërkimore sasiore dhe cilësore”. (Ref. 2.6.1.[Link](#))

Aktiviteti: (Ref. 2.6.2. [Link](#)), Trajnim me Zotero, Trajnim me IA chatgtp. (Evidenca 2.6.2), (Ref. 2.6.3.[Link](#),2.6.4. [Link](#), 2.6.5.[Link](#)), Projekte (Evidenca 2.6.3), (Ref. 2.6.6.[Link](#), 2.6.7.[Link](#), 2.6.8.[Link](#), 2.6.9. [Link](#), 2.6.10. [Link](#), [Link](#), 2.6.11. [Link](#), 2.6.12. [Link](#), 2.6.13. [Link](#), 2.6.14.[Link](#), 2.6.15. [Link](#), 2.6.16.[Link](#), 2.6.17. [Link](#), 2.6.18. [Link](#), 2.6.19.[Link](#))

Fakultetet ndjekin një politikë të vazhdueshme mbështetëse ndaj stafit akademik dhe ndihmës akademik, me qëllim realizimin sa më të suksesshëm të objektivave individuale dhe kolektive. (Evidenca 2.6.4 / 2.6.5).

Universiteti siguron financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca shkencore, duke kontribuar kështu në zhvillimin profesional dhe ngritjen e cilësisë akademike. (Evidenca 2.6.6).

Fakultetet paraqesin çdo fillim viti kërkesa për financim për bazë didaktike dhe teknologjike. Kjo mbështetje ka për qëllim përmirësimin e procesit mësimor dhe atij kërkimor-shkencor, duke rritur cilësinë e performancës së pedagogut në auditor. Mbështetja konkretizohet me organizimin e trajnimeve, lehtësimin e lëvizjeve për aktivitete ndërkombëtare, menaxhimin e burimeve dhe infrastrukturës dhe promovimin e vlerave institucionale. (Evidenca 2.6.7), (Evidenca 2.6.8).

Universiteti gjithashtu ka kontribuar në trajtimin financiar të stafit akademi, duke u bazuar jo vetëm në përfitimet nga Buxheti i Shtetit (Evidenca 2.6.9), por edhe në mbështetjen për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore (Evidenca 2.6. 10/ 2.6. 11 – 2.6.12).

Këto politika të mbështetjes financiare dhe profesionale të stafit akademik dëshmojnë angazhimin e USH-së për zhvillimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe përf forcimin e performancës individuale dhe kolektive të pedagogëve.

USH-ja ndjek një politikë të vlerësimit dhe të zhvillimit të potencialit të tij akademik, kulturor dhe shkencor, përmes dhënies së titujve “Profesor Emeritus”, “Honoris Causa” nga Senati Akademik i USH-së. Në këtë kuadër, FSHSH-ja ka propozuar vlerësimin e dy profesorëve Francesco Altimari, Matteo Mandalá “Profesor Nderi”. (Evidenca 2.6.13), (Ref.2.6.20.

https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2024/Vendime/Senati/vendim_nr.281-date_19.12.2024.pdf,

Ref. 2.6.21. https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2024/Vendime/Senati/Vendim_nr.128_dt-13.05.2024.pdf

Ref. 2.6.22. https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2024/Vendime/Senati/Vendim_nr.127_dt-13.05.2024.pdf).

Standardi II.7 Institucioni disponon dhe menaxhon pasuritë e paluajtshme dhe fokusohet në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” disponon një sistem të formalizuar dhe transparent për evidentimin, administrimin dhe monitorimin e pasurive të paluajtshme, në përputhje me standardet shtetërore dhe legjislacionin në fuqi. Dokumentacioni zyrtar i pronësisë dhe regjistrimet përkatëse (Evidenca 2.7.1), në AMS përmbajnë të gjitha elementet ligjore të kërkuara për garantimin e integritetit, gjurmueshmërisë dhe përdorimit efektiv të këtyre pasurive.

Institucioni ka hartuar dhe zbaton një plan afatmesëm për rehabilitimin, zgjerimin dhe ristrukturimin e infrastrukturës universitare, duke synuar të sigurojë kushte optimale për zhvillimin e procesit mësimor, kërkimor dhe administrativ. Dokumentacioni përmban elementet e domosdoshme sipas standardeve shtetërore në fuqi. USH-ja ka një plan afatmesëm për rehabilitimin, zgjerimin dhe ristrukturimin e pasurive të paluajtshme të tij. Është bërë një investim për të bërë përshtatjen e të gjitha godinave me kushtet e mbrojtjes kundër zjarrit, sipas legjislacionit në fuqi. Një nga investimet më madhore të dekadës së fundit është ndërtimi i godinës së re të fakultetit ekonomik, me një vlerë totale prej rreth 365 milionë lekësh, financuar nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (FZHR) në bashkëfinancim me burimet e vetë universitetit. Kjo godinë moderne, në përdorim që prej shtatorit 2019, përfaqëson standardet më të avancuara të infrastrukturës së arsimit të lartë në Shqipëri. (Evidencë 2.7.2). (Evidencë 2.7.9)

Në Fakultetin e Shkencave Shoqërore (FSHSH) janë realizuar ndërhyrje infrastrukturore në funksion të mirëmbajtjes së godinës dhe menaxhimit më efikas të hapësirave akademike, duke përmirësuar kushtet për zhvillimin e procesit mësimor (Evidenca 2.7.3). Në vijim të investimeve të realizuara, është bërë i mundur riparimi i mjediseve ekzistuese dhe rikonstruksioni i hapësirës jashtë godinës kryesore të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (FGJH),

ku janë krijuar hapësira të reja funksionale që mbështesin si mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies ashtu edhe zhvillimin e veprimtarive ekstrakurrikulare. Ndërhyrje të ngjashme janë kryer edhe në Fakultetin e Shkencave të Edukimit (FSHE), duke u fokusuar në përmirësimin e kushteve fizike të mjediseve mësimore dhe funksionalitetin e hapësirave në shërbim të studentëve dhe stafit akademik, në përputhje me nevojat institucionale dhe standardet e cilësisë.

Standardi II.8 Institucioni siguron infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore.

USH-ja ka në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor 8 godina, të ndërtuara në periudha të ndryshme, në përputhje me normativat teknike dhe legjislacionin në fuqi të kohës së ndërtimit të tyre. Këto godina përdoren për zhvillimin e veprimtarive akademike dhe administrative dhe mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme nga ana e USH-së, në funksion të mbështetjes së procesit mësimor dhe të shërbimeve universitare.

Fakultetet disponojnë mjedise dhe infrastrukturën e duhur për veprimtarinë akademike-shkencore. (Evidenca 2.8.5).

Pranë çdo fakulteti ka laboratorë mësimorë dhe kërkimorë. Në këto laboratorë pedagogët dhe studentët, sidomos ato të ciklit të dytë dhe të tretë, punojnë së bashku për projekte kërkimore-shkencore, të financuara nga USH-ja ose institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Laboratorët kanë luajtur rol të rëndësishëm në projektet shkencore dhe në aktivitetet me studentët. Për shembull, në FE ka 2 laboratorë informatike me kapacitet 30 persona secili në FE. (Evidenca 2.8.1), Një element i ri i infrastrukturës është Salla 103, e cila funksionon njëkohësisht si Qendër SMART e Inovacionit – SMART Business Hub. Kjo qendër shërben si hapësirë multifunksionale për nxitjen e sipërmarrjes, kreativitetit dhe inovacionit, duke mbështetur studentët, ALUMNIT dhe start-up-et e rinj. Ajo ofron një mjedis modern për punë në grup, sesione mentorimi, workshop-e dhe veprimtari të tjera që synojnë zhvillimin e kapaciteteve inovative dhe kompetencave bashkëkohore. Në tërësi, infrastruktura moderne mësimore dhe laboratorike e Fakultetit Ekonomik garanton kushte optimale për mësimdhënie cilësore, përvojë të integruar praktike dhe përgatitje të studentëve sipas standardeve bashkëkohore të arsimit të lartë. (Evidenca 2.8.2.). Dy laboratorë të informatikës shërbejnë për aplikimin e metodave kërkimore, analizave statistikore dhe programeve profesionale të kontabilitetit. Ata janë të pajisur me softwarë bashkëkohorë si SPSS, GRETl dhe ALFA, duke krijuar mundësi që studentët të zhvillojnë kompetenca praktike të domosdoshme për tregun e punës dhe kërkimin shkencor (Evidenca 2.8.3).

Falë bashkëpunimit të dy pedagogeve të gjuhës angleze në FGJH, në kuadër të programit READ, dhe implementimit të projektit “Communicative and Brain-Based Learning through Literature: Pre-Service Teacher-Training” është investuar në njërën nga sallat e fakultetit, me mjete didaktike, teknologji dhe mobilim, për studentët e Masterit për të realizuar veprimtarinë mësimore. (Evidence 2.8.4).

Në mjediset e FSHE-së vijojnë ndërhyrjet për përmirësimin dhe krijimin e kushteve optimale për stafin dhe studentët. Në lidhje me pajisjen me laboratorë të gjuhëve të huaja të përshtatshme për një mësimdhënie bashkëkohore pritet më shumë nga Institucioni.

Në FSHN, laboratorët u shërbejnë jo vetëm studentëve për procesin mësimor dhe për zhvillimin e projekteve, por edhe komunitetit. Laboratori i mikrobiologjisë (Qendra e Diagnostikimit Mirobiologjik “Wolf Dieter Sixl”), i cili siguron praktikat mësimore dhe laboratorike për studentët, shërben gjithashtu edhe për përgatitjen e diplomave të Bachelorit dhe Masterit si dhe ofron shërbim për të tretët. (Evidenca 2.9.2).

Laboratori i fizioterapisë tek Godina e FSHE-së si dhe salla e muzeut të shkencave tek FSHN. Përveç laboratorëve mësimorë, studentët kanë mundësi të realizojnë punë kërkimore në kuadër

të projekteve si dhe punime diplomash në laboratorët kërkimore- shkencore të FSHN-së. (Evidenca 2.9.3), (Evidence 2.9.4), (Evidenca 2.9.5)

Standardi II.9 Institucioni siguron mjedise komode pune - mësimore - laboratorike të përshtatshme për personelin akademik dhe studentët dhe personat me aftësi të kufizuara.

USH-ja siguron që mjediset dhe infrastruktura ekzistuese të ofrojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor në mënyrë të pavarur dhe pa ndërprerje. Institucioni harton dhe zbaton strategji për rritjen e cilësisë së këtyre pasurive në funksion të studentëve. Çdo vit realizohen investime për riparimin dhe përmirësimin e mjediseve, me synimin për t'u krijuar studentëve kushte më të favorshme në përdorimin e tyre. Institucioni siguron kushte të përshtatshme infrastrukturore për studentët, duke garantuar funksionimin e sistemeve të ngrohjes në mjediset mësimore gjatë periudhave me temperatura të ulëta. Në disa fakultete janë ndërmarrë hapa për të mbështetur studentët me aftësi të kufizuara, si vendosja e rampave në FSHE.

Standardi II.10 Për programet e studimit të fushave mjekësore, inxhinierike institucioni siguron laboratorë të standardeve të larta profesionale e shkencore.

Në FSHE ka laboratorë cilësorë, të tillë si: Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar, (Evidencë 2.10.1) (krijuar me vendim të Senatit Akademik të USH nr. 264, datë 15.07.2019), laboratori në kuadër të projektit T@ask.

USH-ja siguron shërbime për palë të treta në përputhje me nevojat e tregut. Ekzistojnë laboratorë brenda njësive akademike në të cilat ato ofrojnë shërbime për njësitë institucionale të jashtme, si dhe shërbime të drejtpërdrejta për popullatën, siç është laboratori mikrobiologjik dhe fizioterapia në FSHN. Laboratori i Fizioterapisë me standarde të larta mundëson jo vetëm praktikën profesionale të studentëve, por ofron shërbime edhe për të tretët.

USH-ja ka një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij, salla leksionesh, seminaresh, biblioteka, laboratorë, sekretari, zyra për pedagogët etj. USH-ja bën përpjekje, në përputhje me mundësitë financiare, për sigurimin e mjediseve në dispozicion të veprimtarisë së personelit akademik.

Po ashtu, në fakultete janë dhe labore digjitale ku zhvillohet mësim, prezantohen detyrat e kursit dhe punimet e diplomave të studentëve. (Evidenca 2.10.2)

Pranë FSHN-së funksionojnë: Laboratori i Analizave të Ushqimeve. (Ref.2.10.1. [Link](#)), (Evidencë 2.10.3), Klinika e Fizioterapisë, Qendra e Diagnostikimit Mikrobiologjik. Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar, (krijuar me vendim të Senatit Akademik të USH nr. 264, datë 15.07.2019), laboratori në kuadër të projektit T@ask (Evidenca 2.10.1).

Klinika e Ligjit pranë FD-së ka nevojë për pajisje kompjuterike dhe laborator, i cili do të shërbente edhe për dhënien e këshillimit ligjor përmes videove dhe formateve të reja që kërkojnë edhe pajisje teknologjike të kohës.

Standardi II.11 Institucioni siguron mjedise të përshtatshme pushimi, sportive dhe argëtimi për personelin akademik dhe studentët e vet.

USH-ja ka në dispozicion të stafit dhe të studentëve sallën e madhe të aktiviteteve dhe promovimeve, po ashtu mjediset e përbashkëta në çdo kat të fakulteteve dhe oborre. USH-ja ndjek një politikë të kujdesshme për menaxhimin e mjediseve të tij. Ai kujdeset që mjediset ekzistuese të sigurojnë kushte të përshtatshme për të vijuar procesin e mësimdhënies në mënyrë të pavarur dhe pa ndërprerje. USH-ja zhvillon gjithashtu strategji për rritjen e cilësisë së mjeteve në dispozicion për studentët. Çdo vit realizohen investime me qëllim përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve, në funksion të krijimit të lehtësirave për shfrytëzimin e tyre

nga studentët. Studentëve u garantohet ofrimi i kushteve cilësore të akomodimit, duke siguruar mjedise të ngrohta dhe të përshtatshme për qëndrim. Në kuadër të modernizimit të mëtejshëm të infrastrukturës akademike, *Fakulteti Ekonomik* ka paraqitur një projekt në lidhje me Fablab, i cili synon ekonominë qarkulluese dhe metodat digjitale në aplikim, projekt i miratuar dhe me financim nga AKKSHI.

Standardi II.12 Institucioni monitoron në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e infrastrukturës fizike dhe angazhohet në përmirësimin e saj.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ushtron një politikë të qëndrueshme dhe të mirëstrukturuar për monitorimin, administrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës fizike, duke garantuar funksionimin e sigurt dhe efikas të të gjitha mjediseve universitare. USH-ja ka ndërmarrë investime të rëndësishme në përpunje me legjislacionin dhe standardet kombëtare, veçanërisht ato që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen e jetës së komunitetit akademik. Në nivel institucional, USH-ja ka realizuar një investim prej rreth 16 milionë lekësh për përshtatjen e të gjitha godinave të tij me standardet e mbrojtjes kundër zjarrit, duke përmbyshur kërkesat ligjore dhe teknike të parashikuara në kuadrin ligjor të sigurisë. Ky investim përbën një masë të rëndësishme parandaluese, duke garantuar funksionimin e sigurt të mjediseve akademike dhe administrative. Mbikëqyrja profesionale e projekteve të ndërtimit, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes kryhet nga Dega e Investimeve në bashkëpunim me supërvizorë të jashtëm të licencuar, duke respektuar të gjitha kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. (Evidencë 2.12.1) Kjo qasje garanton transparencë, profesionalizëm dhe siguri të lartë në administrimin e infrastrukturës universitare. Në përgjithësi, mjediset janë të pastra, me ngrohje, i kushtohet kujdes i madh pastrimit, ajrosjes dhe dezinfektimit të tyre. Gjatë periudhës së verës bëhen rregullime rutinë për përgatitjen e hapjes së vitit të ri akademik. Ndërhyrje të tilla të rëndësishme janë kryer gjatë vitit akademik '24-'25. (Evidenca 2.12.2), (Evidenca 2.12.3). Vitet e fundit në FSHE është realizuar një rampë për PAK e cila është vendosur në katin e parë të godinës dhe sallat janë pajisur me video-projektor. Në FSHN, laboratorit është në funksion dhe për palët e treta. (Evidenca 2.12.4).

Standardi II.13 Institucioni disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike.

Në nivel institucional, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka të ngritur një sistem të konsoliduar për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit, i cili funksionon në përpunje me kërkesat ligjore dhe standardet administrative në fuqi. Ky sistem siguron mbështetje të drejtpërdrejtë për procesin mësimor, duke mundësuar qasje të shpejtë dhe të saktë tek të dhënat mbi përmbyshjen e objektivave të mësimdhënies, cilësinë e detyrave dhe aktiviteteve studentore, pjesëmarrjen dhe angazhimin e studentëve, si dhe realizimin e projekteve kërkimore. Ruajtja në format fizik realizohet përmes Sektorit të Protokoll–Arkivës dhe sekretarive mësimore të fakulteteve, struktura funksionale të cilat garantojnë integritetin, gjurmueshmërinë dhe mundësinë e qasjes së dokumenteve institucionale, akademike dhe studentore. Institucioni është aktualisht i orientuar drejt digjitalizimit të plotë të dokumentacionit. Ky proces mbështetet nga Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë, e cila është përgjegjëse për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe integrimin e sistemeve elektronike të ruajtjes dhe menaxhimit të informacionit. Sistemi SMAK <https://smak.unishk.edu.al/home>, i cili është një program aplikimi akademik, ku rezultojnë të regjistruara aktivitetet akademike të çdo pedagogu dhe administrohet nga përgjegjësi i departamentit.

USH-ja ka të strukturuar funksionalisht një njësi të mbledhjes së statistikave, e cila përgatit dhe dorëzon periodikisht raportime për Ministrinë e Arsimit dhe INSTAT-in. Përmes Drejtorisë së IT-së, institucioni mban baza të dhënash elektronike të përditësuara për:

regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimeve, (SMIAL), <https://smial.arsimi.gov.al/auth/login>, të dhënat akademike dhe administrative sipas kërkesave nënligjore, të cilat arkivohen pranë njësive bazë dhe Degës së Kurrikulave, Standardeve dhe Kërkimit Shkencor. (Evidencat 2.13.1/ 2.13.2 / 2.13.3 / 2.13.4; 2.13.5; 2.13.6; 2.13.7).

Universiteti disponon, gjithashtu, Regjistrin Bazë të Studentëve, i cili ruhet si në format të shkruar ashtu edhe në format elektronik pranë sekretarive mësimore të fakulteteve. Ky regjistër përmban:

1. vlerësimet e marra nga studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve;
2. të dhënat e diplomimit;
3. informacionin mbi diplomën dhe suplementin e diplomës;
4. të dhënat akademike të nevojshme për gjurmueshmërinë e karrierës studentore.

Institucioni disponon të dhëna të përgjithshme për programin, formën, planin e tij mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve, të depozituara pranë njësive bazë dhe në Degën e kurrikulave, standardeve dhe kërkimit shkencor.

Fakultetet disponojnë dokumentacion të plotë. Ruajtja e dokumentacionit është në nivel departamenti, në nivel dekanati dhe në sekretarinë mësimore. Në nivel departamenti ruhen dhe protokollohet të gjitha shkresat e ardhura dhe ato të dërguara, relacionet e mbledhjeve dhe procesverbalet e tyre, vendimet që merren etj.

Pranë sekretarisë së dekanit ruhen dhe protokollohen të gjitha shkresat e ardhura nga Rektorati, nga departamente, nga studentët si dhe shkresat e dërguara.

Pranë sekretarisë mësimore ruhen regjistrat bazë të studentëve me të dhënat e tyre. Ky regjistër, në formë të shkruar dhe elektronike, pasqyron vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna për diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj.

Standardi II.14 Institucioni ve në përdorim sisteme të informimit dhe të menaxhimit në nivel institucional.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” garanton një infrastrukturë të avancuar për administrimin e të dhënave studentore dhe institucionale, duke ofruar sisteme funksionale të menaxhimit të informacionit që sigurojnë efikasitet, transparencë dhe qasje të rregullt për të gjithë përdoruesit. Një ndër shërbimet kryesore është Sistemi i Menaxhimit të të Dhënave të Studentëve, përmes të cilit studentët kanë mundësi të konsultojnë orarin e studimeve, rezultatet e provimeve, informacionet organizative dhe çdo të dhënë tjetër të lidhur me ecurinë e tyre akademike. Pas fitimit të statusit të studentit, kandidati regjistrohet në sekretarinë mësimore të fakultetit duke dorëzuar dokumentacionin përkatës dhe duke respektuar afatet e përcaktuara nga MAS. Sekretaria mësimore krijon për çdo student një llogari individuale elektronike me *username* dhe *password me domenin e unishk*, e cila mundëson akses të personalizuar në shërbimet institucionale. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, dokumentacioni themelor i studentëve administrohet përmes tre regjistrave bazë:

1. Regjistri themeltar i studentit, që vërteton regjistrimin dhe pajisjen me numër matrikullimi, i vlefshëm deri në përfundim të studimeve;
2. Regjistri i arritjeve akademike, ku pasqyrohen të gjitha vlerësimet dhe rezultatet gjatë gjithë ciklit të studimeve;
3. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave, i cili dokumenton emetimin e diplomave dhe suplementeve përkatës. (Evidencë 2.14.1).

U-Albania, University Albania” <https://ualbania.al> është një portal që përfshin të gjitha informacionet dhe shërbimet në lidhje me universitetet në Shqipëri. Sistemi i informacionit institucional menaxhohet përmes Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), i cili i ofron Universitetit një hapësirë të dhënash për mësimdhënie, mësim, hulumtim, menaxhimin e burimeve njerëzore, financiare dhe administrative (PITAGORA),

<https://ushk.pitagora.rash.al/login>).

SMAK <https://smak.unishk.edu.al/home> është një program aplikimi akademik për rezultatet e nevojshme për menaxhimin akademik. Programi mësimor i programeve të studimit mund të gjendet, gjithashtu, në këtë portal. (Evidencë 2.14.2); (Evidencë 2.14.3).

USH-ja ka një webpage www.unishk.edu.al ku publikohen të dhëna periodike për programet e studimit, veprimtaritë e Universitetit dhe njësive akademike, përkatësisht departamenteve të tyre, dokumente të USH-së, si: Statuti i Universitetit, rregulloret funksionale dhe të tjera. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë kujdeset për të pasqyruar veprimet e njësive akademike dhe departamenteve të tyre me orare mësimore, orare të provimeve, njoftime për aktivitete akademike dhe vendime të ndryshme të Universitetit. (Evidencë 2.14.4), (Ref. [Link](#), [Link](#), [Link](#), [Link](#)).

Procesi i digjitalizimit është në proces të vazhdueshëm, deri në digjitalizimin e plotë të fondit arkiv. Biblioteka ka pësuar një ndryshim në organizimin e saj. Ajo operon sot me dy sektorë: 1. Sektori i klasifikatorë- restauratorëve (përgjegjësi +dy klasifikatorë +një restauratorë); 2. Sektori i bibliotekarë-arkivistëve (përgjegjësi + gjashtë bibliotekarë). Kjo risi organizimi ka dhënë ndikim pozitiv në përmbushjen me sukses të detyrave nga stafi, sepse secili përshtatet me kualifikimin përkatës të pozicionit që mban. (Evidencë 2.14.5).

<https://bush.unishk.edu.al/>

<https://bush.unishk.edu.al/arkivat-digjital/>

Standardi II.15 Institucioni bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” është i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në informatizimin e proceseve institucionale, duke siguruar që çdo hallkë e marrëdhënies student – sekretari mësimor – staf akademik të funksionojë në mënyrë efikase, transparente dhe të integruar. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë luan një rol kyç në këtë proces, duke koordinuar të gjitha veprimtaritë që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe duke garantuar funksionimin e sistemeve digjitale që mbështesin menaxhimin akademik dhe administrativ. Nëpërmjet platformave dhe sistemeve elektronike të administruara nga kjo drejtori, pasqyrohen në mënyrë të rregullt:

1. oraret e procesit mësimor;
2. datat e provimeve dhe afatet akademike;
3. struktura organizative dhe organigrama institucionale;
4. detyrimet dhe përgjegjësitë e studentëve;
5. tarifat e studimeve dhe informacion financiar shoqërues;
6. rezultatet dhe vlerësimet akademike të studentëve;
7. veprimtaritë akademike, kulturore dhe sociale të USH-së.
8. veprimtarinë akademike dhe sociale të USH-së.

www.unishk.edu.al.

www.unishk.edu.al

<https://adsh.unishk.edu.al/>

<https://bush.unishk.edu.al/>

<https://ulibrary.rash.al/> (Evidencë 2.15.1).

Standardi II.16 Institucioni harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe transparente.

Shpërndarja dhe përdorimi i burimeve financiare në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” realizohen në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor, që rregullon programimin buxhetor dhe menaxhimin financiar publik. Proceset financiare mbështeten në dispozitat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në

Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Procesi i programimit dhe shpërndarjes së burimeve financiare realizohet në përputhje me Strategjinë afatmesme buxhetore të institucioneve publike, ndërsa udhëzimet për hartimin e buxhetit miratohen nga titullari i institucionit (Evidenca 2.16.1).

Universiteti, në hartimin e buxhetit, bazohet në kërkesat e sjella nga fakultetet. Dekanatet i bazojnë kërkesat e tyre në nevojat e departamenteve, të cilat specifikohen në një mbledhje të veçantë. (Evidenca 2.16.4). Më pas bëhet miratimi në Senatin Akademik.

Shpërndarja e burimeve financiare bëhet në përputhje me strategjinë afatmesme të buxhetit të përgjithshëm. (Evidenca 2.16.2), (Ref.2.16.1.

https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2024/Vendime/Senati/3105_senat_24.pdf

Urdhri Prot. 1359, dt.19.04.2021 është për miratimin e programit të transparencës: (Evidenca 2.16.3), (Ref. 2.16.3.[Link](#)).

E pasqyruar edhe në rubrikën për buxhetin:

(Ref.2.16.4.

https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2025/Vendime/Bordi/Vendimi_nr_41_dt_04.02.2025_bursa.pdf.

Në Bordin e Administrimit dhe rubrikën Vendimet: (Evidenca 2.16.5), (Ref.2.16.5. [Link](#)).

Në vendimet e Senatis: (Ref. 2.16.6.[Link](#)), (Evidenca 2.16. 6). Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, buxheti i propozuar i universitetit i nënshtrohet diskutimit dhe miratimit nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit (Evidenca 2.16.7).

Standardi II.17 Institucioni siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka të ngritur një strukturë të specializuar për menaxhimin strategjik dhe financiar, të themeluar me Urdhrin nr. 244, datë 11.08.2017, e cila funksionon në përputhje me ndryshimet e mëvonshme dhe me kuadrin ligjor në fuqi. Grupi i Menaxhimit Strategjik (i ndryshuar), përbëhet nga strukturat drejtuese më të larta të universitetit, përfshirë Administratorin dhe Drejtorin Ekonomik, duke garantuar koordinimin e plotë të vendimmarrjes financiare me objektivat strategjike institucionale. Ky grup luan një rol thelbësor në zbatimin e politikës financiare të universitetit, duke u udhëhequr nga parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Brenda Rektoratit, Drejtoria e financave ka përgjegjësi administrative për çështjet financiare. Në vijim të kësaj politike, financimi i veprimtarive akademike, kërkimore dhe administrative mbështetet në dy burime kryesore:

1. Granti i Buxhetit të Shtetit, i cili siguron bazën financiare të funksionimit institucional;
2. Të ardhurat e vetëgjeneruara, të realizuara përmes shërbimeve ndaj të tretëve, projekteve akademike dhe kërkimore, donacioneve dhe sponsorizimeve.

USH-ja zbaton mekanizma të rregullt të monitorimit financiar, përmes të cilëve analizon në mënyrë periodike treguesit kryesorë që lidhen me realizimin dhe zbatimin e politikës financiare. Këto analiza kryhen në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 dhe shërbejnë si bazë (i ndryshuar). (Evidenca 2.17.1), (Ref. 2.17.1. [Link](#))

për:

1. vlerësimin e performancës financiare;
2. identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim;
3. planifikimin financiar afatmesëm dhe afatgjatë;
4. garantimin e përdorimit efektiv dhe të qëndrueshëm të burimeve financiare. (Ref.2.17.2. [Link](#)), (Evidenca 2.17.2).

Standardi II.18 Institucioni ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, si institucion publik i arsimit të lartë, operon në përputhje të plotë me kuadrin ligjor financiar dhe standardet e administrimit publik. Menaxhimi buxhetor i USH-së rregullohet nga Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nga Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, të cilët përcaktojnë rregullat e menaxhimit të përgjegjshëm, kontrollit të brendshëm dhe llogaridhënies institucionale. USH-ja i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm, duke siguruar transparencë dhe kontroll të vazhdueshëm mbi përdorimin e burimeve financiare. Rezultatet e auditimeve raportohen dhe shqyrtohen nga organet kolegjiale, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Raporti vjetor i veprimtarisë financiare të universitetit hartohet nga Rektorati dhe miratohet fillimisht në këtë nivel, përpara se të paraqitet për shqyrtim dhe miratim përfundimtar në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit. (Evidenca 2.18.1), (Ref. 2.18.1. [Link](#)).

Raporti i veprimtarisë financiare të USH-së miratohet në Rektorat dhe pastaj nga dy organet kolegjiale, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Gjithashtu, mendimi i studentëve merret edhe nga përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik dhe përfaqësuesi i tyre në Bordin e Administrimit. (Evidenca 2.18.2), (Ref.2.18.2. [Link](#)).

Raportet e KLSH-së, e auditit të MAS-it dhe e auditit të vetë institucionit, për IAL-të publike, janë shqyrtuar në Bordin e Administrimit në mbështetje të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”.

Standardi II.19 Institucioni ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka të përcaktuar qartë, në Strategjinë e tij të Zhvillimit, politikën institucionale të bashkëpunimit, e cila synon fuqizimin e kapaciteteve akademike, kërkimore dhe ndërkombëtare të institucionit (Evidenca 2.19.1). USH-ja ka një sërë lidhjesh me Universitete të huaja të shprehura në marrëveshje bashkëpunimi. Disa nga këto marrëveshje kanë rezultuar shumë të rëndësishme për USH-në duke ndihmuar stafin e ri të universitetit në kualifikimin shkencor si dhe duke ndihmuar në ngritjen e disa laboratorëve mësimorë dhe shkencorë.

Institucioni merr parasysh nevojat e ekonomisë vendase dhe të tregut të punës në hapjen e programeve të reja ose hartimin e projekteve kërkimore shkencore. Çdo program i ri studimi që hapet në USH, hapet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë ku parashikohet kryerja e studimit të tregut të punës.

Një ndër prioritetet e Universitetit është ndërkombëtarizimi i Universitetit të Shkodrës. Në këtë drejtim është punuar si në aspektin e nënshkrimit të marrëveshjeve të ndryshme mes Universitetit të Shkodrës dhe Universiteteve të tjera të rajonit, Evropës apo dhe Amerikës, ashtu si në zbatimin e projekteve të përbashkëta me karakter akademik. USH-ja ka punuar intensivisht për t’u përfshirë në projekte ndërkombëtarë dhe për t’iu përgjigjur ofertave evropiane duke u përfshirë në partneritete në kuadrin e projekteve evropiane si CEEPUS, ERASMUS Mundus, Interreg (FOST INNO), IPA (HELIX), TEMPUS (EUREQA, CHTMBAL, MARED), Erasmus + (MARDS, FINAC, USIA). Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjeve me Universitetet Perëndimore Evropiane dhe me universitete në SHBA janë realizuar mobilitete të stafeve dhe studentëve si dhe janë siguruar bashkëpunime me strukturat kërkimore brenda këtyre universiteteve, duke realizuar aktivitete të përbashkëta si publikime, konferenca, aplikim i kurrikulave më mbështetje të stafeve cilësore dhe sigurim i infrastrukturës në shërbim të procesit mësimor (libra dhe pajisje). (Evidenca 2.19.2), (Evidenca 2.19.3), (Evidenca 2.19.4). Lista e marrëveshjeve të USH-së nëpërmjet përcjelljes

së ftesave në të gjithë stafin e pedagogëve. (Evidenca 2.19.5), (Evidenca 2.19.6), (Evidenca 2.19.7), (Evidenca 2.19.8), (Evidenca 2.19.9), (Evidenca 2.19.10), (Evidenca 2.19.11) Në funksion të zhvillimit të bashkëpunimit akademik dhe kërkimor-shkencor në nivel fakulteti, në dhjetor 2022 u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet FSHE-së dhe Fakultetit të Filozofisë të Universitetit të Malit Të Zi. (Evidenca 2.19. 12).

Në bashkëpunimi me Fondacionin për Shoqëri të Hapur dhe me mbështetjen e LëvizAlbania, është ngritur pranë FD-së Klinika e Ligjit, ku gjatë vitit akademik, përveçse ofron ndihmë juridike falas, u krijon mundësi një numri të konsiderueshëm studentësh të kryejnë praktikë profesionale pranë saj (Evidenca 2.19.13). Fakulteti i Drejtësisë ka marrëveshje të shumta bashkëpunimi me institucione brenda vendit të tilla si: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Bashkia Shkodër, Prokuroria e rrethit gjyqësor Shkodër, Dhoma e Avokatisë Shkodër (Evidenca 2.19.14 / 2.19.15).

Standardi II.20 Institucioni bashkëpunon me institucionet të tjera në mbështetje të veprimtarisë së tij akademike, administrative, kërkimore-shkencore/artistike dhe praktikave profesionale.

USH-ja bashkëpunon me instanca të tjera për ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve, në kuadrin e praktikave profesionale (me DAR Shkodër, Gjykata e rrethit Gjyqësor Shkodër, Prokuroria e Rrethit Shkodër, Spitali Rajonal Shkodër, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Shkodër, NGO etj.), ofrimin e akomodimit të studentëve (me SHA “Studenti”) etj. (Evidenca 2.20.1).

USH-ja bashkëpunon me partnerë të tjerë për plotësimin e nevojave të veta në funksion të realizimit të programeve të studimeve si p.sh.: Junus Emre Center; mbështetje nga ambasadat për të ndihmuar procesin e mësimdhënies së gjuhës së huaj në departamentet e gjuhëve të huaja; për lehtësimin e veprimtarive kulturore e sportive me Bashkinë Shkodër. Të gjithë fakultetet e çmojnë shumë bashkëpunimin me institucionet e tjera. Ka një sërë marrëveshjesh të natyrave të ndryshme, si: bashkëpunim si partner në projekte të ndryshme, bashkëpunim për realizimin e praktikave mësimore, etj., si p.sh., me DAR Lezhë, ZVA Shkodër. Fakulteti i Drejtësisë ka nënshkruar marrëveshje me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Prokurorinë e Rrethit Shkodër, Qendra e Shërbimit të ndihmës Juridike parësore Shkodër, Dhoma e Avokatisë Shkodër (Evidenca 2.20.2 dhe 2.20.3). Fakulteti Ekonomik ka siguruar bashkëpunime me disa Institucione Publike si Bashkia Shkodër, Prefektura Shkodër, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Zyra e Punës Shkodër, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë kulturore Shkodër dhe të bizneseve të Rajonit të Shkodrës në kuadrin e punës kërkimore dhe aktiviteteve të ndryshme që realizon si panaire biznesi, evente të promocionit të ofertave turistike etj.

FSHSH-ja ndjek një strategji të hapur bashkëpunimi dhe partneriteti në nivel vendor me institucionet vendore, si Bashkia Shkodër, Drejtoria rajonale e Arsimit, Zyra Vendore e Arsimit, Institucione kulturore. Në nivel kombëtar me institucionet homologe në Tiranë e rrethe, me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë; në nivel ndërkombëtar me Universitete të Rajonit dhe me gjerë, po ashtu është pjesë e programeve evropiane, si: Erasmus Plus dhe CEEPUS. (Evidenca 2.20.4). (Evidenca 2.20.5).

Bashkëpunimi ndërinstitucional me Zyrën Vendore Arsimore Shkodër vazhdon me qëllim që studentët e FGJH-së të ciklit të dytë Master profesional në Mësuesi për të katër gjuhët e huaja (anglisht, gjermanisht, frëngjisht dhe italisht) të kryejnë praktikën profesionale në shkollat e mesme dhe 9-vjeçare në lëndën gjuhë e huaj (anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht). (Evidenca 2.20.6.)

Gjithashtu, FGJH bashkëpunon me FGJH-në e UT-së për organizime seminaresh apo konferencash, me Universitetin e Mesinës në Itali, me Universitetin Haute-Alsace, Francë, Universitetin e Vechta-s, dhe Agjencia Universitare e Frankofonisë, në nivel ndërkombëtar

me Universitete të Rajonit dhe me gjerë, po ashtu është pjesë e programeve evropiane, si: Erasmus Plus dhe CEEPUS. (Evidenca 2.20.6).

Departamentet e FSHN-së e vlerësojnë shumë bashkëpunimin me institucionet e tjera. Ka një sërë marrëveshjesh: bashkëpunim si partner në projekte të ndryshme, bashkëpunim për realizimin e praktikave mësimore me Spitalin Rajonal të Shkodrës, Drejtorinë e Shëndetit Publik, Kryqin e Kuq, Malteser, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura etj.; (Evidenca 2.20.7). Marrëveshje bashkëpunimi me AKZM-në, (Evidenca 2.20.8).

Standardi II.21 institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar.

Stafi akademik i USH-së merr pjesë në aktivitete ndërkombëtare sa herë që është i ftuar dhe ka prezantuar kumtesa në konferenca, kongrese kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe vetë USH-ja organizon aktivitete ndërkombëtare, si p.sh., konferenca shkencore, simpoziume, etj. Universiteti ka lidhur një sërë marrëveshjesh formale, që iu ofrojnë stafit dhe studentëve mundësinë për të marrë pjesë në veprimtari ndërkombëtare. Pjesëmarrja e stafit dhe e studentëve në veprimtari ndërkombëtare është një element kyç, i cili ka dhe një peshë të madhe në strategjinë e zhvillimit të USH-së. Zyra e marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve. Lidhur me këtë fakt janë rritur ndjeshëm aplikimet për secilën thirrje.

Në kuadër të projektit Erasmus +MIC Albanie, disa studentë francezë nga Fakulteti i Gjuhëve dhe Shkencave Humane të Universite de Haute-Alsace ndoqën leksione në Programin e studimit Bachelor “Gjuhë Frënge” (Ref.2.21.1. [Link](#)), (Evidenca 2.21.1), (Evidencë 2.21.2). Mobiliteti i Studentëve të programit të studimit “Gjuhë Angleze” në Vechta, Gjermani. (Evidencë 2.21.3). Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Haute-Alsace, Francë. (Evidenca 2.21.4). Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Caen-Normandie, (Evidencë 2.21.16), (Evidenca 2.21.5), (Evidenca 2.21.6). Mobiliteti i stafit në FSHN realizohet përmes pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme shkencore, si: konferenca, mësimdhënie, pjesëmarrje në projekte të ndryshme, etj. (Evidenca 2.21.7), (Evidenca 2.21.8).

Standardi II.22 Institucioni kryen studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.

Institucioni informohet në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin ekonomik rajonal nëpërmjet burimeve të ndryshme të informacionit, po ashtu dhe ndërmjet bashkëpunimeve me institucione të tjera apo dhe nga pjesëmarrja në konferenca të cilat trajtojnë çështje të zhvillimeve rajonale.

USH-ja aplikon një mekanizëm sistematik për monitorimin e punësimit të të diplomuarve, i cili kryhet në nivel departamenti brenda një periudhe njëvjeçare pas përfundimit të studimeve. Për këtë qëllim, gjatë dy viteve të fundit është ngritur një bazë e dhënash e ALUMNI-t, e cila administrohet dhe përditësohet çdo vit nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, (Evidenca 2.22.1), (Ref. 2.22.1. [Link](#)), duke siguruar informacion të vlefshëm për vendimmarrjen akademike dhe për planifikimin e programeve të studimit.

Për konkretizim, FE zbaton një praktikë të konsoliduar të studimeve të tregut lokal të punës, të cilat realizohen:

1. përpara hapjes së programeve të reja të studimit,
2. pas diplomimit të studentëve,
3. periodikisht, për të ndjekur dinamikën e sektorit ekonomik në rritje.

Këto studime bazohen në:

1. komunikimin zyrtar me punëdhënësit e fushës;
2. identifikimin e kërkesave dhe nevojave të tyre aktuale e afatmesme;

3. analizën e mundësive të punësimit për studentët e programeve specifike;

4. të dhënat mbi punësimin real të të diplomuarve;

(Evidenca 2.22.2 dhe 2.22.3.).

Në Fakultetin Ekonomik realizohen studimet e tregut të punës në kuadrin e aplikimit në MAS për hapjen e programeve të reja të studimit në nivel Bachelor, Master apo Doktoraturë por me mbështetje financiare të dedikuar këto studime duhet të bëhen periodike për të kuptuar ndryshimet në nevojat e tregut dhe për t'iu përshtatur me ofertën akademike të përditësuar në kohë.

Janë bërë studime për tregun e punës nga fakultetet, si dhe monitorime për gjurmimin e studentëve të punësuar pas diplomimit. (Evidenca 2.22.4), (Evidenca 2.22.6), (Evidenca 2.22.6), (Evidenca 2.22.7).

Departamentet realizojnë studimin e tregut të punës duke realizuar monitorimin e punësimit të të diplomuarve ndër vite. (Evidenca 2.22.8).

Përfundimet dhe Vlerësimi

Politikat e rekrutimit dhe transparencë institucionale

Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër zbaton një politikë të konsoliduar dhe transparente të rekrutimit të personelit akademik dhe administrativ, të formalizuar në "Rregulloren e Punësimit". Procesi i rekrutimit karakterizohet nga publikimi i të gjitha njoftimeve të konkurseve në faqen zyrtare të USH-së: <https://unishk.edu.al> dhe Buletinën e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP)

Kjo praktikë siguron hapjen e procesit dhe pjesëmarrjen e barabartë të kandidatëve. Përzgjedhja e stafit me kohë të pjesshme realizohet në bazë të kriterëve të rankimit të përcaktuara në rregullore, çka garanton meritokraci dhe profesionalizëm. Evidencat administrative dokumentohen sipas procedurave standarde, ndër të cilat përfshihet

USH-ja zbaton një qasje integruese të personelit, duke siguruar bashkëveprim të koordinuar midis stafit me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme, por edhe ndërmjet departamenteve dhe fakulteteve. Personeli ndihmës, i specializuar në përdorimin e platformave digjitale, ofron mbështetje të vazhdueshme për stafin akademik, veçanërisht në përdorimin e Teams, SMAK: (<https://smak.unishk.edu.al/home>) SMIAL, U-Albania (<https://ualbania.al>)

Ky bashkëveprim institucional siguron cilësi në proceset mësimore dhe administrimin akademik.

Koordinimi ndërfakultet dhe funksionimi akademik

USH-ja paraqet një nivel të qëndrueshëm koordinimi ndërmjet njësive akademike. Dekanatet e fakulteteve bashkërendojnë në mënyrë të rregullt kërkesat për personel, duke u bazuar në nevojat e departamenteve për fillimin e çdo viti akademik. Procedura përfshin: përgatitjen e kërkesave nga përgjegjësit e departamenteve, dërgimin e kërkesave në dekanat, transferimin e kërkesave te fakultetet përkatëse, përzgjedhjen e pedagogëve specialistë për mësimdhënie mes fakulteteve.

Kjo skemë funksionale siguron mbulimin e duhur të lëndëve, harmonizimin e ngarkesës akademike dhe realizimin e programeve të studimit sipas standardeve të miratuara.

Vlerësimi i performancës së stafit dhe kultura institucionale e cilësisë

USH zbaton një sistem të konsoliduar vlerësimi për performancën e personelit akademik, i cili përfshin vlerësimin e programeve nga studentët që diplomohen, analizën e raporteve të vetëvlerësimit në departamente dhe dekanate, analizën vjetore të punës mësimore-shkencore në departamente, dekanate dhe Senat, diskutimin dhe miratimin e syllabuseve në mbledhjet e departamenteve. (Ref. [Link](#))

Gjithashtu, universiteti mbështet zhvillimin profesional të pedagogëve nëpërmjet vendimeve të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, të cilët miratojnë mbështetje financiare për kandidatët në proces doktorate dhe për marrjen e titujve akademikë. Ky angazhim institucional për zhvillimin profesional përbën një praktikë të qëndrueshme që ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit.

Aktivitetet studentore, pjesëmarrja dhe roli komunitar

Departamentet dhe fakultetet nxisin përfshirjen e studentëve në aktivitete të ndryshme kulturore, shkencore, sportive dhe sociale. Studentët marrin pjesë në veprimtari ekstrakurrikulare, ekspozita, aktivitete artistike dhe projekte me organizata të shoqërisë civile. Veçanërisht theksohet përfshirja e tyre në nisma vullnetare, si: aktivitete sensibilizuese, dhurim gjaku, angazhim në projekte komunitare.

Këto iniciativa kontribuojnë në formimin social dhe qytetar të studentëve dhe në lidhjen e universitetit me komunitetin.

Kualifikimi i stafit, akreditimi dhe zhvillimi akademik

Departamentet përbëhen nga staf i kualifikuar me kohë të plotë, ndërsa përzgjedhja e stafit me kohë të pjesshme realizohet sipas rregullores së punësimit dhe kriterëve të rankimit. Aktualisht janë akredituar në USH 10 programe studimit si dhe janë në proces akreditimi programet e tjera.

Evidencat për akreditim, dokumentet mbështetëse dhe procedurat e aplikimit janë të dokumentuara sipas standardeve (Evidenca 2.17).

Institucioni mbështet zhvillimin profesional përmes politikave të promovimit akademik dhe përfshirjes në projekte të kërkimit dhe veprimtari shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Infrastruktura dhe mjediset akademike

Fakultetet e USH-së administrojnë mjedise funksionale për veprimtarinë akademike-shkencore, megjithëse mbetet vend për përmirësim të mëtejshëm. Institucioni kujdeset në mënyrë të vazhdueshme për mirëmbajtjen e ambienteve, pastrimin, dezinfektimin dhe ajrosjen, sigurimin e ngrohjes, krijimin e kushteve të përshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara.

Ndërtesa e FSHN-së ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm, megjithëse janë realizuar ndërhyrje të pjesshme, të dokumentuara në shkresat e komunikimit institucional.

Sistemet e informacionit, dokumentacioni dhe informatizimi

USH-ja ruan një dokumentacion të plotë dhe të organizuar në departamente, dekanate, sekretarinë mësimore, Zyrën e Protokoll–Arkivës.

Institucioni përdor sisteme digjitale për menaxhimin e informacionit akademik dhe administrativ:

U-Albania (<https://ualbania.al>)

Portali kombëtar që integron shërbimet universitare, regjistrimet dhe informacionet zyrtare.

RASH – Rrjeti Akademik Shqiptar – <https://rash.al>

Ofron hapësira të dhënash për mësimdhënie, kërkim, menaxhim burimesh dhe funksione administrative.

SMAK – Sistemi i Menaxhimit Akademik (<https://smak.unishk.edu.al/home>)

Përdoret për regjistrimin e notave, strukturat mësimore, rezultatet dhe proceset tërësore akademike.

Faqja zyrtare e USH-së (<https://unishk.edu.al>) publikon rregulloret, dokumentet institucionale (Statuti, rregulloret funksionale), programet e studimit, veprimtaritë, oraret, njoftimet dhe vendimet.

Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë administron procesin e informatizimit dhe siguron integrimin e të gjitha shërbimeve digjitale për studentët dhe stafin.

Menaxhimi financiar dhe auditimi

USH harton buxhetin institucional bazuar në kërkesat që dekanatet paraqesin në përputhje me nevojat e departamenteve. Procesi i miratimit realizohet në Senatin Akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, veçanërisht Ligjin nr. 80/2015.

Institucioni i nënshtrohet auditit të brendshëm dhe auditit të jashtëm, dhe raportet pasqyrohen në organet kolegjiale për verifikim dhe masat përkatëse.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mobilitetet

USH-ja ka të përfshirë në strategjinë e zhvillimit një politikë të hapur bashkëpunimi vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar. Marrëveshjet e bashkëpunimit përfshijnë mobilitetet akademike, pjesëmarrjen në projekte shkencore, realizimin e praktikave profesionale, konferenca dhe aktivitete të përbashkëta.

Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë përditëson rregullisht faqen e USH-së (<https://unishk.edu.al>) me njoftime për mobilitete të stafit dhe studentëve, projekte ndërkombëtare dhe aktivitete akademike.

Punësimi i të diplomuarve dhe studimi i tregut të punës

USH-ja ka ndërmarrë nisma për monitorimin e punësimit të të diplomuarve dhe për analizimin e tregut të punës. Megjithëse ekzistojnë përpjekje të dokumentuara, institucionit i nevojitet krijimi i një mekanizmi më sistematik dhe të qëndrueshëm monitorimi, me qëllim ndjekjen e karrierës së të diplomuarve, përshtatjen e programeve me kërkesat e tregut, planifikimin e politikave akademike dhe profesionale.

Vlerësimi i fushës: Standardet përmbushen plotësisht.

FUSHA III – PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI

Standardi III.1 Institucioni ofron programe në përputhje me misionin, strategjinë e tij të zhvillimit dhe kërkesat e tregut.

USH-ja ofron programe studimi në tre ciklet e studimit. Programet e studimit janë të njohura për publikun dhe, gjithashtu, të mundshme për t'u konsultuar në faqen e internetit të Universitetit të Shkodrës. (Ref.3.1.1. [Link](#)).

USH-ja organizon aktivitete të rëndësishme nën moton “Ditët e Hapura”, në shkollat e mesme të qytetit dhe më gjerë, si dhe vendos kontakte të drejtpërdrejta me drejtorët e shkollave të mesme. (Evidenca 3.1.1).

IAL-ja ofron një gamë të gjerë programesh studimi Bachelor, programe që u mundësojnë studentëve akses të menjëhershëm në tregun e punës ose mundësi për të vazhduar studimet në nivelin Master.

Në FSHN janë bërë kërkesa për aktivizimin e programeve profesionale në funksion të kërkesave të tregut: Vendim nr. 227 Për miratimin e aktivizimit të programeve të studimit të ciklit të I-rë dhe programeve me karakter profesional 2024-2025. (Evidenca 3.1.8).

FSHSH-ja është pjesë aktive e “Ditëve të Informimit të Maturantëve” duke mundësuar ndjekjen dhe mbajtjen e kontakteve me të diplomuarit e vet edhe kur ata kanë hyrë në tregun e punës. (Evidenca 3.1.2), (Evidenca 3.1.3), (Evidenca 3.1.4).

Programet e studimit në USH janë të harmonizuara me misionin dhe vizionin e institucionit, si dhe me qëllimet e tij strategjike në fushën e arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe shërbimit ndaj komunitetit. (Evidenca 3.1.5), (Evidenca 3.1.6), (Evidenca 3.1.7).

Standardi III.2 Programet e studimeve ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Programet e studimit në USH janë në përputhje me bazën ligjore dhe objektivat kombëtarë e ndërkombëtarë. Programet e studimit janë të përafuara edhe me programe të ngjashme, të ofruara nga IAL të tjera, sipas Ligjit nr.80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, përmbajtja e programeve është hartuar duke marrë parasysh edhe kurrikulat e programeve të ngjashme të universiteteve të huaja. Në këtë mënyrë, studentët tanë kanë mundësi studimi të mëtejshëm në universitete të tjera brenda vendit apo jashtë tij. Ata, gjithashtu, kanë mundësi punësimi edhe në rajon e më gjerë.

Institucioni ndjek në strategjinë e tij politikën e bashkëpunimit. USH-ja ka një sërë lidhjesh me Universitete të huaja, të shprehura në marrëveshje bashkëpunimi. Disa nga këto marrëveshje kanë rezultuar shumë të rëndësishme për USH-në, pasi kanë ndihmuar stafin e ri akademik në kualifikimin e vazhdueshëm shkencor, si dhe në ngritjen e disa laboratorëve mësimorë dhe shkencorë.

Në hapjen e programeve të reja apo hartimin e projekteve kërkimore shkencore, Institucioni merr parasysh gjithmonë nevojat e ekonomisë vendase dhe të tregut të punës. Çdo program i ri studimi në USH hapet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë, ku parashikohet edhe kryerja e studimit të tregut të punës.

Një ndër prioritetet e Universitetit është ndërkombëtarizimi. Në këtë drejtim është punuar si në aspektin e nënshkrimit të marrëveshjeve të ndryshme mes Universitetit të Shkodrës dhe Universiteteve të tjera të rajonit, Evropës apo dhe SHBA-së, ashtu dhe në zbatimin e projekteve të përbashkëta me karakter akademik.

USH-ja bën përpjekje për të siguruar koherencë me programe të ngjashme studimi të universiteteve të tjera në vend e më gjerë në rajon. Multikulturaliteti, gjithashtu, zë vend, përveçse në module të veçanta, edhe në lëndët që zhvillohen si module për gjuhët e huaja. Përmendim këtu përfshirjen e kulturës angleze dhe amerikane, italiane, frënge, gjermane, malazeze etj. Në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të FE-së, projekti FINAC është finalizuar me hapjen e Masterit në “Menaxhim Financiar, Kontabilitet

dhe Kontroll në Administratën Publike”. Po kështu edhe projekti MARDS, në bashkëpunim me universitete prestigjioze evropiane është finalizuar me hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm”. (Evidencë 3.2.1).

Në kuadër të programit Erasmus+ janë ofruar çdo vit bursa për studentët e Departamentit të Gjeografisë për të ndjekur një semestër pranë Universitetit të Vechta-s në Gjermani. (Ref.3.2.1. [Link](#)).

Në FSHE mbahet evidencë punësimi për studentët jashtë vendit. (Evidenca 3.2.2).

Standardi III.3 Programet kanë objektiva të përcaktuar qartë dhe rezultatet e tyre të të nxënësve përputhen me nivelin dhe profilin e kualifikimit që ofrojnë.

Të gjitha programet kanë objektiva rezultatet e të nxënësve të qarta, sipas profilit të kualifikimit, duke u bazuar në syllabuset e përditësuara dhe rekomandimet e akreditimit. Në Fakultetin e Ekonomisë, progresi i studentëve në projekte kërkimore evidentohet përmes përfshirjes së tyre aktive në kërkime të drejtuara nga stafi akademik, realizimit të punimeve kërkimore të vlerësuara në kuadër të lëndëve përkatëse dhe publikimit të rezultateve në botime institucionale, si Buletini Shkencor Nr. 18, duke reflektuar zhvillimin gradual të kompetencave kërkimore dhe akademike (Evidenca 3.3.1). Bazuar në elementet përbërëse të programeve të studimit, informacioni që jepet në këto programe është i plotë, që përfshin emërtimin, kohëzgjatjen, pikëkreditet, vendimet e hapjes, objektivat formues, karakteristikat, mundësitë për punësim, struktura akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, plani mësimor, etj. (Evidenca 3.3.2), (Evidenca 3.3.3.), (Evidenca 3.3.8).

Programet e studimit u bëhen të njohura studentëve në çdo fillim të vitit akademik, ku marrin informacion për elemente bazë të tij. Gjithashtu, studentët marrin informacion edhe për Kodin e Etikës të USH-së për pjesën që u përket studentëve. Në rast transferimi të studimeve, studentët pajisen me të gjitha të dhënat nga Drejtoria e Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve.

Hapja e programeve të reja të studimit bazohet në VKM-të, Udhëzimet e MAS-it dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi në lidhje me kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për hapjen dhe riorganizimin e programeve të studimit. MAS-i ka miratuar hapjen e programit të ri të studimit në ciklin e dytë Master i shkencave në “Marketing Inovativ”, datë 20.08.2025, nr. 5172/1 (Evidenca 3.3.4).

Programet e studimit hartohen me objektiva të qarta, të cilat përfshijnë marrjen e dijeve, të njohurive dhe aftësive që duhet të përvetësojë një student në një programi të caktuar. Lëndët dhe ngarkesat e orëve në auditor përputhen me objektivat e programit duke synuar përgatitjen e specialistëve të aftë.

Oferta akademike e programeve të studimit të USH-së është në përputhje me të gjithë komponentët e strategjisë për zhvillimin e institucionit. Bazuar në elementet përbërëse të programeve të studimit mund të themi se ato janë lehtësisht të kuptueshme. Informacioni që jepet në to është i plotë, informacion që ngërthen në mënyrë të detajuar emërtimin, kohëzgjatjen, pikëkreditet, planin mësimor, objektivat formues, literaturën për çdo lëndë, vendimet e hapjes, mundësitë për punësim, struktura akademike përgjegjëse, strukturat bashkëpunuese, etj.

Programet respektojnë Vendimin Nr. 879, dt. 18.12.2019 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. (Evidenca 3.3.7).

Standardi III.4 Institucioni përcakton qartë dhe ndjek procedurat për miratimin e programeve të reja.

Rritja e nevojave të vendit për specialistë të ndryshëm ka qenë një shtysë e veçantë për hapjen e programeve të reja në USH. USH-ja ka bërë përpjekje të vazhdueshme për ofrimin e programeve të tjera të studimit, në fusha të tilla, si: turizëm, redaktori, territor, trashëgimi kulturore, shkenca të natyrës, shkenca të edukimit etj., në përputhje me zhvillimin e vendit dhe kërkesat e tregut.

USH-ja ndjek procedura të mirëpërcaktuara për hartimin dhe miratimin e programeve të studimit në përputhje me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Programet e reja i nënshtrohen një procedure të posaçme që përfshin hartimin e dokumentacionit përkatës, analizën e nevojës dhe qëndrueshmërisë akademike, financiare dhe organizative, vlerësimin

nga strukturat përgjegjëse dhe miratimin nga organet vendimmarrëse të institucionit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Këto procedura bazohen në dokumentacionin dhe aktet rregullatore për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, njërive kryesore dhe programeve të studimit, duke garantuar transparencë, cilësi dhe koherencë institucionale në procesin e zhvillimit akademik. Aplikimi për programet e reja nis në departament, i cili e propozon dhe punon për hartimin e tij, duke vijuar me miratimin në njësinë kryesore, në Senat, Bordin e Administrimit dhe më pas vazhdon procedura e aplikimit në U-ALBANIA. Hapja e programeve të reja të studimit bazohet në VKM-të, Udhëzimet e MAS-it dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi në lidhje me kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për hapjen dhe riorganizimin e programeve të studimit. MAS-i ka miratuar hapjen e programit të ri të studimit në ciklin e dytë, Master i shkencave në “Marketing Inovativ”, datë 20.08.2025, nr. 5172/1 (Evidence 3.4.12).

Rritja e nevojave të vendit për specialistë të ndryshëm ka qenë një shtysë e veçantë për hapjen e programeve të reja nga FSHSH. FSHSH-ja ka bërë përpjekje të vazhdueshme për ofrimin e programeve të tjera të studimit, në fusha të tilla, si: turizëm, redaktori, territori, trashëgimi kulturore, në përputhje me zhvillimin e vendit dhe kërkesat e tregut, në përputhje të plotë me Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë. (Ref.3.4.1. [Link](#)).

Në FSHSH janë hapur tashmë programet e reja (në vitin akademik 2023-2024): “Histori dhe trashëgimi kulturore” dhe “Gjeografi dhe zhvillim territori” (Evidence 3.4.1; Evidence 3.4.2; Evidence 3.4.3; Evidence 3.4.4; Evidence 3.4.5; Evidence 3.4.6; Evidence 3.4.7).

Stafi akademik i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ndërmerr përpjekje të vazhdueshme për nisjen, hartimin dhe hapjen e programeve të reja të studimit, në përputhje me misionin e institucionit, nevojat e tregut të punës dhe kuadrin ligjor në fuqi. Në vitin akademik 2024-2025 u hapen këto programe studimi: Master i Shkencave në “Infermieri Klinike” me 120 kredite; Master i shkencave në Mësuesi në “Biologji- Kimi” me 120 kredite; Master i Shkencave në “Sigurimi i cilësisë së ushqimit dhe të ushqyerit” me 120 kredite; Master i Shkencave në Mësuesi në “Matematikë – Fizikë” me 120 kredite; Master i Shkencave në Mësuesi “Informatikë” me 120 kredite dhe Master i Shkencave në Mësuesi “Matematikë” 120 kredite. (Evidence 3.4.8).

Standardi III.5 Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit.

Programet e studimit në USH janë në përputhje me kapacitetet e fakulteteve, si ato akademike, ashtu edhe kapacitetet infrastrukturore. Stafi akademik mbulon mbi 70% të ngarkesës mësimore, duke shfrytëzuar infrastrukturën ekzistuese të institucionit, ku përfshihen mjediset mësimore, laboratorët dhe biblioteka. Departamentet, në fillim të çdo viti akademik, diskutojnë dhe miratojnë ngarkesën mësimore vjetore (1536 orë), ngarkesën mësimore të normuar, si dhe kohën vjetore të punës, në përputhje me Udhëzimin Nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë” (për vitin akademik 2017–2018), si dhe me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar dhe i plotësuar me Udhëzimin Nr. 36, datë 23.11.2018 dhe Udhëzimin Nr. 37, datë 04.12.2018, (Evidence 3.5.1), (Ref. 3.5.1. [Link](#)). (Ref.3.5.1. [Link](#)).

Veprimtaritë që kryen personeli akademik në IAL janë: a) mësimdhënie; b) kërkimi shkencor; c) kontribut institucional; d) kontribut profesional. (Shih kontratat e plotësuara on-line: (Ref.3.5.2 [Link](#)).

Në njësitë kryesore ka pasur vazhdimisht rekrutime të stafit akademik me kohë të plotë, me qëllimin mbulimit të lëndëve nga pedagogë me kohë të plotë. Është i angazhuar, gjithashtu, edhe staf akademik me kohë të pjesshme, në varësi të specialiteteve që mbulojnë, me qëllimin për t’iu ofruar studentëve cilësi sa më të mirë në mësimdhënie. Edhe kapacitetet infrastrukturore mundësojnë zhvillimin e programeve të studimit në USH (Evidence 3.5.2). (Evidence 3.5.3).

Standardi III.6 Programet e studimit janë të organizuar në cikle studimi.

Programet e ciklit të parë të studimit Bachelor u japin mundësi studentëve që të vazhdojnë studimet në programet Master. Studimet Master ofrojnë dije themelore duke zgjeruar dhe thelluar fushat e studimit në mënyrë më të avancuar dhe të specializuar. Pas përfundimit të studimeve Bachelor, studentët kanë mundësinë të hyjnë në tregun e punës. Universiteti ka krijuar gjithashtu ALUMNI-n që mundëson informacion të saktë për studentët e punësuar pas diplomimit.

Fushatat paraprake të IAL-ve me maurantët e shkollave të mesme janë të dobishme për orientimin e tyre. Janë përgatitur udhëzues të posaçëm (Guida studentore) për orientimin e studentëve. Gjithashtu, maurantët mund të orientohen e të marrin informacion të saktë edhe në web-in faqja e Universitetit.

Programet e studimit të ciklit të dytë (Master) janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe në vazhdimësi logjike me programet e ciklit të parë (Bachelor), duke garantuar koherencë akademike dhe progresion të të nxënësve. Për realizimin e këtyre programeve, USH-ja bashkëpunon me aktorë jashtë institucionit, veçanërisht për zhvillimin e praktikave profesionale në nivel Bachelor dhe Master.

Të gjitha programet e studimit që ofron USH-ja janë të strukturuar dhe të klasifikuara në përputhje me nivelet përkatëse të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (Evidencë 3.6.1).

Gjithashtu, USH-ja ofron dy programe studimi të ciklit të tretë (Doktoratë), përkatësisht në FSHSH dhe FE, të cilat synojnë nxitjen e kërkimit shkencor të avancuar në fusha dhe nënfisha të caktuara studimi. Këto programe janë të orientuara drejt krijimit, thellimit, rikonceptimit dhe riintegritimit të njohurive shkencore, me qëllim gjenerimin e risive dhe kontributeve origjinale në mendimin shkencor (Evidencë 3.6.2).

Standardi III.7 Programet e studimeve nga cikli në cikël hartohen me qëllim mirë orientimin dhe përfundimin gradual të njohurive nga studentët.

Programet Bachelor u japin mundësi studentëve që të ndjekin studimet në programet e cikleve pasardhëse. USH-ja krijon të gjitha lehtësitat infrastrukture për ndjekjen dhe përfundimin me sukses të studimeve si dhe vazhdimin e studimeve në një cikël më të lartë. Programet saktësojnë të gjitha llojet e veprimtarive: veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm, veprimtari në disiplina të formimit karakterizues, veprimtari në disiplina të ngjashme ose dhe integruese, disiplina me zgjedhje, njohuritë tjera formuese dhe teza e diplomës, ku secila prej tyre përfshin module apo lëndë me përmbajtje bashkëkohore (Evidenca 3.7.1); kurrikul e ngjashme me të universiteteve të huaja. Syllabuset janë, gjithashtu, të bazuara në literatura të huaja dhe të viteve të fundit. (Evidencë 3.7.2.), (Evidenca 3.7.8). Programet e studimit janë të hartuara në mënyrë të atillë që lejojnë mundësinë e transferimit në programe të tjera homologe, bazuar në kreditet e fituara. Burimi i informacionit merret përmes rregullores përkatëse të studimeve.

Në FSHSH, Programet e studimeve "Master i Shkencave" hartohen në mbështetje të politikave kërkimore të Universitetit dhe në përputhje me strategjitë e këtij institucioni, të cilat janë sanksionuar si tek Statuti i USH-së 2018, ashtu dhe tek Strategjia e USH-së. (Evidenca 3.7.3; Evidenca 3.7.4, Evidenca 3.7.5; Evidenca 3.7.6, Evidenca 3.7.7).

Studentët mbikëqyren për mbarëvajtjen e tyre në procesin mësimor, këshillohen për kërkimin shkencor dhe shkrimin e eseve, këshillohen për vështirësitë që ata ndeshin, si dhe për përgatitjen e temës së diplomës, me qëllim përfundimin me sukses të vitit të ardhshëm të studimit apo të diplomimit për studentët e vitit të fundit. Pedagogët dhe studentët përdorin, gjithashtu, platformën online TEAMS, për një komunikim të shpejtë e plotësues. Në disa module apo lëndë janë parashikuar edhe minikërkime shkencore apo projekte kursi me natyrë kërkimore, të organizuar nga vetë studentët dhe të mbikëqyrura nga pedagogu i lëndës.

Standardet III.8 Institucioni ofron programe të të nxënësve gjatë gjithë jetës.

Qendra e Ekselencës në AMS (Evidenca 3.8.1) e miratuar me Vendim Senati nr.103, datë 18.03.2015, nr. 1160 prot., me iniciativën e Fakultetit Ekonomik dhe të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, ndër të

tjera ka si funksion edhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies përmes trajnimeve të pedagogëve të rinj mbi metodat e mësimdhënies dhe të pedagogëve me eksperiencë mbi të rejat në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Me vendim Nr.249 të Senatit Akademik të datës 17.07.2019, në mbështetje të Ligjit nr.80, dt.22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutit të USH-së, emri i kësaj njësie ndryshon nga “Qendra e Ekselencës” në “Zyrë e Ekselencës”. Gjithashtu, në kuadër të aktiviteteve të kësaj zyre, zhvillohen trajnime të ndryshme mbi “Metodat kërkimore sasiore dhe cilësore”. Ajo funksion edhe për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies përmes trajnimeve të pedagogëve të rinj mbi metodat në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar është pjesë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit të USH-së, i krijuar në kuadër të Projektit “Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve në Shqipëri”.

Pedagogët e FSHSH-së organizojnë aktivitete me mësuesit e shkollave të arsimit të mesëm të lartë në rajon me qëllimin e përmirësimit të punës së tyre. (Evidenca 3.8.2). Workshop me mësuesit e gjeografisë në rajon “Disiplina e gjeografisë dhe kurrikula e arsimit të mesëm të lartë”.

USH-ja e vlerëson të nxënit gjatë gjithë jetës jo vetëm si parim të programeve të studimeve universitare apo përmes krijimit të Qendrave të Edukimit të Vazhduar brenda juridiksionit të Universitetit, por edhe si pjesë integrale të filozofisë së mësimdhënies, duke e konceptuar atë si një dimension të shtrirë dhe të vazhdueshëm të procesit të të nxënit. Pedagogët e FSHSH-së përpiqen t’i aktivizojnë studentët jo vetëm brenda mjediseve të Fakultetit, por edhe në veprimtari shkencore e kulturore të qytetit e më gjerë, nëpërmjet botimeve të ndryshme, si veprimtarë apo ndjekës.

Standardi III.9 Programet e studimeve mbështeten në profilin kërkimor dhe profesional të njësive dhe realizohen në bashkëpunimi me aktorë të fushës.

Programet e studimeve synojnë përgatitjen e profesionistëve të zotë, duke gërshetuar formimin teorik me praktikën. Programet e studimit të ciklit të parë Bachelor synojnë një formim bazë të studentit në një fushë studimore të caktuar, duke lejuar kalimin progresiv nga cikli i parë i studimeve në ciklin e dytë, pa përsëritje të përmbajtjeve të lëndëve. Programet e nivelit Master janë hartuar bazuar në nevojat e tregut të punës si dhe në vazhdimësi të studimeve të nivelit Bachelor. Për realizimin e programeve të studimit USH-ja bashkëpunon edhe me aktorë jashtë institucionit, sidomos për realizimin e praktikave të studentëve. Çdo departament i USH-së ofron programe studimi në përputhje me profilin e tij dhe kapacitetet akademike që departamentet kanë.

Programet e studimit janë të hartuara në mënyrë të atillë që lejojnë mundësinë e transferimit në programe të tjera të ngjashme ose të përafërta, bazuar në kreditet e fituara. Çdo informacion merret përmes rregullores përkatëse të studimeve dhe rregullores së programit të studimit.

Programet e studimit harmonizojnë kompetencat e përgjithshme me ato profesionale. Aktivitetet e parashikuara në secilën disiplinë shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e këtyre kompetencave. Çdo program garanton realizimin e formimit praktik e profesional të studentëve në mjediset e USH-së dhe në bashkëpunim me institucione të tjera lokale, publike dhe private si: Bashkia Shkodër, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, DAR, Spitali rajonal Shkodër, organizata të shoqërisë civile jofitimprurëse, institucione të nivelit lokal, institucione financiare, zyra finance dhe kontabiliteti etj. FD-ja, në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, bashkëpunon me institucione të ndryshme, kryesisht në fushën e drejtësisë si: Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër, Dhoma e Avokatisë Shkodër, si dhe me njësitë e pushtetit vendor, ku në rastin konkret ka marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Shkodër, (Evidenca 3.9.1 dhe 3.9.2). Ky bashkëpunim mundëson riorganizimin e programeve, duke i përshtatur këto të fundit me tregun e punës. Model diplome dhe suplementi. (Evidenca 3.9.3). USH-ja ka marrëveshje për zhvillimin e praktikave me Bashkinë Shkodër, DAR, Zyrën Vendore Arsimore Shkodër, Muzeun Historik Shkodër, Organizatën Go2, Drejtorinë

Rajonale të Monumenteve të Kulturës, si dhe me institucione të tjera të sektorit privat dhe shtetëror që operojnë në zonën e Veriut. (Evidencë: 3.9.5; Evidencë: 3.9.6.).

Praktikat profesionale mbikëqyren nga pedagogët e departamenteve, të cilët raportojnë për ecurinë e zhvillimit të saj pranë njësisë bazë. Përpara fillimit të praktikës studentët pajisen me një dokument të lëshuar nga Fakulteti që u drejtohet institucioneve ku do të zhvillohet praktika, duke u kërkuar atyre gatishmërinë për pranimin e studentëve dhe angazhimin e tyre si praktikantë. Mbas përfundimit të praktikës, studentët pajisen nga institucioni ku kanë zhvilluar praktikën me një dokument, që vërteton angazhimin e tyre pranë këtij institucioni. Praktika profesionale vlerësohet me notën, e cila bazohet në rezultatet e mbikëqyrjes nga ana e pedagogut si dhe në prezantimin final.

Në disa raste, marrëveshjet e bashkëpunimit parashikojnë edhe kurse trajnimi për integrim më të shpejtë me tregun e punës. Evidencë për përafrimin e kurrikulës me programe të ngjashme studimi brenda vendit dhe jashtë tij FSHE (Evidenca 3.9.4).

Standardi III.10 Programet e studimeve monitorohen në mënyrë periodike.

Në përbërje të Drejtorisë së Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve funksionon Zyra për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, e ngritur bazuar në Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ajo vlerëson efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore të institucionit bazuar në Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në bazë të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM-në Nr. 531, datë 11.09.2018. Për të mbështetur Sektorin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe procesin e vlerësimit të brendshëm, janë krijuar edhe NJSBC-të në nivel njësie kryesore ose KSGC-të. Programet e studimeve monitorohen vazhdimisht si nga vetë departamentet ashtu edhe zyrat përkatëse të Rektoratit.

Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë të çdo programi të studimeve nëpërmjet analizës që realizohet çdo vit. USH-ja ka një paketë me instrumente për sigurimin e cilësisë që përbëhet nga: raporte, CV, pyetësorë. Çdo vit hartohen Raportet e Vlerësimit të Brendshëm që i shërbejnë monitorimit periodik. (Ref.3.10.1. [Link](#)), (Evidenca 3.10.1), (Evidenca 3.10.2), (Evidenca 3.10.3); (Evidenca 3.10.4) (Evidenca 3.10.5).

Standardi III.11 Programet e studimeve janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të rritjes së cilësisë.

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt. 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, programet e studimeve mund të përmirësohen, duke bërë ndryshime në emërtimin e lëndëve, në numrin e pikëkrediteve, me qëllim që studentëve t’u ofrohet një kurrikul bashkëkohore. Për çdo program bëhen edhe konsultime me programe të ngjashme studimi kombëtare dhe ndërkombëtare, për të lehtësuar lëvizjen e studentëve drejt universiteteve të tjera jashtë vendit. (Evidencë 3.11.1). (Evidencë 3.11.7).

Departamentet e USH-së organizojnë çdo vit akademik mbledhje të veçanta me tematikë “Analiza e punës mësimore”, “Analiza e punës shkencore”, “Rezultatet e vlerësimit të procesit mësimor nga studentët” etj. Gjatë këtyre mbledhjeve analizohet aktiviteti mësimdhënës i pedagogëve sipas programeve të studimit dhe puna shkencore e secilit prej tyre. Evidentohen arritjet, problematikat dhe vështirësitë të cilat bëhen objekt diskutimesh me qëllim përmirësimin e tyre dhe përcaktohen objektivat për vitin pasardhës. (Evidenca 3.11.2) dhe puna shkencore e secilit pedagog. (Evidenca 3.11.3.), (Evidenca 3.11.4).

Studentët e USH-së përfshihen në vlerësimin e pedagogëve dhe të programeve të studimeve. Realizohen pyetësorë anonimë me studentët për të vlerësuar aspekte të ndryshme të punës mësimore. Kështu, dy herë në vit, në përfundim të semestrit të parë dhe të dytë realizohen pyetësorë me studentë, për vlerësimin e procesit mësimor dhe punës së pedagogut për lëndët/modulet përkatëse. (Evidenca 3.11.5).

Studentët e USH-së, përmes vlerësimit për procesin mësimor, bazuar në plotësimin e pyetësorëve në fund të çdo semestri, kontribuojnë në përmirësimin dhe realizimin me sukses të programeve të studimit.

Rezultatet e pyetësorëve dhe sugjerimet e studentëve bëhen objekt diskutimi në mbledhjet e njëjësive bazë. Këto rezultate, gjithashtu, janë pjesë e integruar e vlerësimit të brendshëm dhe ndihmojnë në realizimin e analizës SWOT, që i bëhet çdo programi studimi në përfundim të tij. Për studentët e FD-së, teknikat e mësimdhënies në fushën e drejtësisë përfshijnë edhe metodat interaktive të nxitjes së debatit pedagog-student. Përveç trajtimeve teorike dhe doktrinare, një vend të veçantë zë analiza e case-law, e cila ndihmon në kuptimin dhe angazhimin më të plotë të studentëve (Evidenca 3.11.6).

Cilësia e programeve të studimeve vlerësohet edhe nga statistikat e punësimit të të diplomuarve në këtë program studimi. Institucioni monitoron punësimin e të diplomuarve, nga vetë departamenti në një periudhë 1-vjeçare nga përfundimi i studimeve. Një rol të rëndësishëm luan edhe hartimi dhe përditësimi i “Strategjisë së studimit të tregut të punës”.

Për të gjitha programet e studimit, diskutimi dhe miratimi i planeve mësimore për vitin akademik pasardhës bëhet fillimisht në departament. Në këtë fazë diskutohet plani mësimor dhe pedagogët titullarë të lëndëve paraqesin propozimet përkatëse për ndryshim të ngarkesës lëndore. Pas marrjes së propozimeve, përgjegjësi i departamentit harton planin e ri me ndryshimet përkatëse të cilat paraqiten më pas në dekanat e prej aty në Senat për miratimin përfundimtar. (Evidenca 3.11.7), (Evidenca 3.11.8).

Standardi III.12 Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

Në nenet 23 dhe 24 të Statutit të USH-së përshkruhen strukturat dhe detyrat përkatëse për sigurimin e cilësisë institucionale. Aktualisht në USH është ngritur Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Cilësisë, me vendim të Senatit Akademik nr.181 dt.31.5.2021. (Evidenca 3.12.1). Ky komision ka hartuar Manualin e Cilësisë në nivel institucional për zhvillimin e përdorimin e metodave të ndryshme e inovative të mësimdhënies. (Evidencë 3.12.2),

(Ref.3.12.1.https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2024/Vendime/Senati/vendim_nr.19_dt.23.01.2024.pdf).

Për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie, çdo vit në mbledhjet me tematikë “Miratimi i syllabuseve”, secili pedagog pasqyron ndryshimet në syllabuset e lëndëve, krahasuar me vitin akademik paraardhës, duke dhënë argumente të qenësishme për ndryshimet e propozuara. (Evidenca 3.12.3.), (Evidenca 3.12.8).

Çdo vit realizohet raporti i vlerësimit për secilin program studimi (Evidencën 3.12.4): merren parasysh edhe mendimet dhe sugjerimet e studentëve që diplomohen. (Evidenca 3.12.5), (Evidenca 3.12.6), (Evidenca 3.12.7), (Evidenca 3.12.9).

Standardi III.13 Programet e studimeve të shpallura zbatohen sipas strukturave të miratuara në nivel institucional dhe kombëtar.

USH-ja ofron programe studimi të strukturuar sipas cikleve të arsimit të lartë, në përputhje me Kartën e Bolonjës dhe legjisllacionin shqiptar për arsimin e lartë. Programet e studimit përmbajnë objektiva të qarta dhe përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programeve të studimit. Në përmbajtjen e tyre përfshihet informacion i detajuar lidhur me disiplinat, lëndët apo modulet, kompetencat, kriteret e pranimi, disiplina me zgjedhje të studentit, me njohuri formuese dhe temë diplome, të gjitha këto në përputhje të plotë me legjisllacionin në fuqi. Vendosja e krediteve përbën një hap të rëndësishëm për të arritur standardet evropiane të arsimit të lartë. Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe përmban informacion të detajuar.

Stafet akademike të njëjësive kryesore përafrojnë deri në masën 70% përmbajtjen e programeve të tyre me programe të ngjashme në nivel kombëtar, në përputhje edhe me Ligjin nr.80/2015, datë 22.7.2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 86 pika 2. Studentët, gjithashtu, informohen edhe për mundësinë e studimit në vende të huaja.

Programet dhe planet mësimore janë objekt diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme dhe u janë nënshtruar rishikimeve, në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik, studentët apo institucionet me të cilat bashkëpunohet. Hartimi i programeve është realizuar edhe në bazë të konsultimeve me programe të ngjashme studimi kombëtare dhe ndërkombëtare, duke bërë të mundur lëvizjen e studentëve drejt universitete të tjera në arenën ndërkombëtare.

Programet e ciklit të dytë Master që ofrojnë formimin e mësuesve të historisë, gjeografisë dhe gjuhë-letërsisë kanë të përshtatur kurrikulën e tyre në funksion të profesionit të rregulluar të mësuesit sipas Ligjit të profesioneve të rregulluar në fuqi dhe akteve nënligjore nën fuqi. (Evidencë.3.13.1).

Mësimi i gjuhëve të huaja është në përputhje me politikën e internacionalizimit të studimeve. Studentët që përfundojnë një program studimi të nivelit Bachelor zhvillojnë dy gjuhë të huaja, përkatësisht: në vitin e parë të studimeve zhvillojnë gjuhën angleze, në vitin e dytë të studimeve zhvillojnë njërin nga gjuhët e huaja: frëngjisht, italisht, gjermanisht, turqisht, gjuhë malazeze, si lëndë me zgjedhje. Studentët e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë kanë kriter pranimi edhe njohjen e dokumentuar të një nga pesë gjuhët e huaja: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, bazuar në Udhëzim Nr. 52, datë 3.12.2015 *azhurnuar me Udhëzimin nr. 5, datë 16.02.2017, Udhëzimin nr. 11, datë 10.04.2017, Udhëzimin nr. 20, datë 22.09.2017* "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë". (Evidencë.3.13.2).

Standardi III.14. Programet e studimeve mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike.

Stafi bën përpjekje për integrimin e elementëve praktikë në realizimin e syllabuseve të lëndëve. Lëndët dhe modulet e programeve të studimit, në përgjithësi, realizohen nëpërmjet orëve të leksioneve dhe seminareve. Në disiplina të veçanta janë të parashikuara edhe orë laborator. Diskutimet dhe projektet e kursit ndihmojnë studentët që të ruajnë dijen e fituar edhe pas mbarimit të kursit. Stafi bën përpjekje për integrimin e elementëve praktikë në realizimin e syllabuseve të lëndëve edhe përmes bashkëpunimit me institucione vendore dhe OJF-ve, duke krijuar mundësinë që ekspertë të fushave përkatëse të sjellin praktikën dhe ekspertizën e tyre tek studentët. Disa programe studimi zhvillojnë praktika dhe ekspedita në terren.

Departamentet vazhdimisht organizojnë dhe nxisin pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete extra kurrikulare.

Bazuar në Udhëzimin Nr. 15, datë 04.04.2008 "Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë", si dhe në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", një nga format e veprimtarisë akademike të parashikuara në kuadër të programeve të studimit është përgatitja dhe mbrojtja e tezës së diplomës.

Programet e studimit që ofron FSHSH e përfshijnë këtë komponent si pjesë përbërëse të strukturës akademike të tyre, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi, duke garantuar realizimin e rezultateve të të nxënit dhe përmbushjen e kriterëve të Standardit 3.IV (Evidencë 3.14.5), (Ref. 3.14.4. Link). Fakultetet kanë përgatitur udhëzues më të detajuar për studentët për përgatitjen e punimeve të diplomave për llojet e programeve të studimit që ofrojnë. (Evidenca 3.14.2), (Evidenca 3.14.3), (Evidenca 3.14.4).

Çdo departament, në mbledhjet e veçanta në semestrin e parë, cakton pedagogët udhëheqës për studentët duke u bazuar në: preferencat e studentëve, disiplinat e studimit dhe përshtatjen e tyre me profilin dhe kualifikimin e pedagogut udhëheqës. Pas miratimit të temave/fushës së studimit dhe pedagogëve udhëheqës, listat depozitohen pranë dekanatit. Pedagogët udhëheqës organizojnë punën me studentët sipas një grafiku të përcaktuar në bashkëpunim me studentët dhe përmes komunikimit online.

USH-ja ndërmerr përpjekje të vazhdueshme për përfshirjen aktive dhe mbështetjen e studentëve në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve dhe projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare me karakter social, kulturor dhe sportiv, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre në jetën akademike dhe institucionale.

Gjithashtu, studentët e USH-së kanë kontribuar në mbështetjen e njësive bazë për organizimin dhe mbarëvajtjen e konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvilluara në kuadër të institucionit. Në këtë kontekst, i referohemi axhendës së Konferencës Studentore të organizuar nga FD në prill 2025, si dhe axhendë së konferencës shkencore të organizuar nga FD në bashkëpunim me Universitetin e Firences në dhjetor 2024, ku një panel diskutimi iu dedikua posaçërisht studentëve. Stafi i USH-së, gjithashtu, ndjek politika mbështetëse për pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete kulturore dhe edukative, të organizuara nga fakultetet të cilat ndihmojnë në formimin profesional të tyre. Janë organizuar disa aktivitete të kësaj natyre si konferenca ndërkombëtare, *Panairi i punësimit* etj. Disa programe studimi zhvillojnë praktika dhe ekspedita në terren (Evidenca 3.14.6).

Në kërkesat buxhetore të vitit 2024 - 2025, Departamenti i Gjuhës angleze kërkoi financim për projektin "Eksplorim Gjuhësor në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut mbi 'Përdorimin e gjuhës angleze në kontekstin Shqiptar' - Hulumtimi dhe dokumentimi i përdorimit të gjuhës angleze në kontekste të ndryshme në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut. Projekti u zbatua dhe u realizua në periudhën 14-16 maj 2025 nga studentët e vitit të 3-të Bachelor në Gjuhën Angleze. Qëllimi i projektit ishte eksplorimi i përdorimit të gjuhës angleze në kontekstin shqiptar, duke u fokusuar veçanërisht në anglicizma, fjalë të urta, shprehje dhe përkthime të gjetura në pikat kulturore dhe turistike kryesore në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut. Ky eksplorim do të ndihmonte në thellimin e kuptimit për mënyrën se si gjuha angleze është integruar në kulturën dhe shoqërinë shqiptare, si dhe në mënyrën se si përdoret dhe përshtatet nga vendasit. (Evidenca 3.14.7). Fakulteti ka përgatitur udhëzues më të detajuar për studentët për përgatitjen e punimeve të diplomave për tre llojet e programeve të studimit që ofron (Evidenca 3.14.9).

Standardi III.15 Programet zhvillohen me qëllim përfshirjen aktive të studentëve në përfundimin e kompetencave.

Programet e studimit kanë në përmbajtjen e tyre informacion të mjaftueshëm dhe koherent për studentët. Në programet e studimeve janë të paraqitura rubrikat përkatëse në përputhje me bazën ligjore. Rregullore e Studimeve e datës 25.05.2019. (Evidencë.3.15.1). Programet e lëndëve përditësohen me prurjet më të reja të literaturës bashkëkohore. Pedagogët kanë të parashikuara në syllabuset e tyre edhe projekte kursi për vlerësimin e studentëve, zhvillimi i të cilave mundëson përvetësimin më të mirë të lëndës dhe zhvillimin e shprehive të punës së pavarur. Programet e studimit, në përgjithësi, kanë të parashikuara edhe praktika profesionale. Praktikën profesionale realizohen në kuadër të marrëveshjeve institucionale me institucione vendore publike si dhe përmes bashkëpunimit me sektorin privat si: Bashkia Shkodër, DAR, Shërbimi i Provës, Zyra vendore Shkodër, Spitali Rajonal Shkodër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Drejtoria Rajonale e SH.S.SH-së Shkodër, OJF "THE DOOR", Fototeka "Marubi", Muzeu Historik Shkodër, organizata të shoqërisë civile, jofitimprurëse dhe me institucione të tjera të sektorit privat dhe shtetëror që operojnë në zonën e Veriut.

Programet e studimeve synojnë që studentët në përfundim të studimeve të zotërojnë kompetencat të cilat janë të pasqyruara në Rregulloren e Studimeve e datës 25.05.2019. Në aspektin e kompetencave, programi formon dhe zhvillon kompetenca të përgjithshme, specifike dhe të transferueshme, të cilat mundësojnë menaxhim dhe transformim të konteksteve të punës, qëndrim të pavarur, performancë të efektshme. (Evidenca 3.15.2). Disa programe studimi zhvillojnë praktika dhe ekspedita në terren. Stafi i FE-së, gjithashtu, ndjek politika mbështetëse për pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete kulturore dhe edukative, të organizuara nga fakulteti të cilat ndihmojnë në formimin profesional të tyre. Janë organizuar disa aktivitete të kësaj natyre si konferenca ndërkombëtare, aktivitetet për 25 vjetorin dhe 30 vjetorin e FE-së, Panairi i punësimit, Workshopi i Studentëve 'Sfidat e Zhvillimit rajonal', Workshop-i i studentëve të turizmit 'Ruajtja dhe përmirësimi i atraktivitetit turistik në rajonin verior të Shqipërisë në kushtet e krizes aktuale ekonomike', trajnimet në fushën e fiskaliteteve dhe trajnimi për Export Manager, trajnimi në sektorin e mikëpritjes, ku studentët janë angazhuar si mbështetës apo edhe përfitues të këtyre trajnimeve. Workshop mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit në Rajonin e Veriut. (Evidencë 3.15.3), (Ref.3.15.2. [Link](#)).

Standardi III.16 Programet e studimeve synojnë përgatitjen e studentëve për punësim.

Të gjitha programet janë të organizuara sipas llojeve të veprimtarive të përcaktuar tek Udhëzimi nr.15, datë 04.04.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe tek Vendim Nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Duke iu referuar përmbajtjes së programeve të studimit në USH konstatohet se lëndët e modulet e përfshira në këto programe formojnë profesionistë në fushat përkatëse.

Në përgjithësi, programet e studimit përmbajnë praktika mësimore, të cilat mundësohen në bashkëpunim me institucione publike e private me të cilat USH-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi (Evidenca 3.16.1), (Evidenca 3.16.2). Kurrikula e programeve të ofruara nga FSHSH përmban edhe lëndë specifike të cilat synojnë formimin profesional të studentëve në funksion të punësimit.

Standardi III.17 Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve shqiptarë dhe të huaj.

Programet e studimit në USH mbulohen nga stafi akademik në masën jo më pak se 70%, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 86, pika 2. Studentët informohen gjithashtu për mundësitë e mobilitetit akademik dhe studimit në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit. USH-ja ofron programe studimi në përputhje me Kornizën e Bolonjës, të cilat përmbajnë objektiva të qarta dhe informacion të detajuar mbi strukturën e programit, disiplinat/lëndët/modulet, kompetencat, kriteret e pranimit, disiplinat me zgjedhje dhe komponentët përfundimtarë (p.sh. tezë diplome), në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Diplomati që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës. Në FSHN, suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe përmban informacion të detajuar. (Evidenca 3.17.4).

Studentët e të gjithë fakulteteve të USH-së kanë mundësi mobilitetesh pranë universiteteve të huaja, kjo falë programeve Erasmus apo edhe marrëveshjeve të drejtpërdrejta me institucione ndërkombëtare. Falë programeve që studentët ndjekin në USH, u jepet mundësia e lëvizjes dhe transferimit të krediteve në programe të ngjashme apo të përafërta në universitete të tjera brenda vendit e jashtë. Përfshirja e 2 gjuhëve të huaja në kurrikul rrit ndjeshëm nivelin e studentëve për ta pasur më të lehtë ndjekjen e studimeve edhe jashtë Shqipërisë. Për shembull, FE ka intensifikuar mobilitetet e studentëve dhe stafit përmes programeve Erasmus+ dhe CEEPUS, si dhe bashkëpunimeve me universitete prestigjioze si Vienna University, Prague University of Economics and Business dhe Saxion Netherlands. (Evidenca 3.17.21; 3.17.2), (Evidencë 3.17.3).

Standarde III.18 Institucionet pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.

Pasi kanë shlyer të gjitha detyrimet, studentët fitojnë të drejtën për provimin përfundimtar apo punimin e temë së diplomës, sipas Rregullores së studimeve. Nëpërmjet sistemit Pitagora, studentët kanë akses në rezultatet personale të provimeve duke respektuar plotësisht parimin e konfidencialitetit.

Pas marrjes së vlerësimit pozitiv, studentët pajisen me diplomën përkatëse, e shoqëruar me suplementin. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe ka informacion të hollësishëm rreth programit të studimit dhe vlerësimit të studentit.

Rregullat dhe kërkesat e provimit të diplomës, janë të miratuara nga strukturat universitare përgjegjëse dhe janë të njohura për të gjithë përmes “Rregullores së studimeve”, të shpallur publikisht në website-n e USH-së si dhe në mjediset e Fakulteteve.

USH bën të njohura kriteret dhe procedurat e diplomimit duke i shpallur në stendat e fakultetit përkatës brenda afateve të përcaktuara në mbledhjet e departamenteve. Sistemi i vlerësimit në USH bazohet në rregulloret e studimit të lartpërmendur, në një kohë që regjistrimi i studentëve për mbrojtjen e diplomës bëhet paraprakisht online në sistemin Pitagora.

Bazuar në nenin 30 të Rregullores së Studimeve të USH-së dhe në Rregulloren e USH-së anonimiteti është i respektuar gjatë korrigjimit të provimeve nëpërmjet sistemit të sekretimit të materialeve të

provimit. Pas vlerësimit me pikë të tezës së provimit, bëhet çsekretimi në prani të komisionit, i cili i jep përgjigjen secilit prej studentëve sipas afateve të përcaktuara po në këto rregullore.

Studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të pamerituar. Ankesa bëhet me shkrim sipas procedurës së përcaktuar në rregulloret e sipërpërmendura. Nëpërmjet sistemit "Pitagora" studentët në USH kanë akses në rezultatet personale të provimeve duke respektuar plotësisht parimin e konfidencialitetit. <https://ushk.pitagora.rash.al/login> (Evidenca 3.18.1), (Evidenca 3.18.2), (Evidenca 3.18.3).

Standardi III.19 Institucioni siguron laboratorë të dedikuar në mbështetje të programeve të studimit dhe kërkimi shkencor/artistik.

USH-ja ka një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij; me salla leksionesh, seminaresh, biblioteka, laboratorë, sekretari, zyra për pedagogët etj. USH-ja bën përpjekje, në përputhje me mundësitë financiare për sigurimin e mjediseve në dispozicion të veprimtarisë së personelit akademik.

(Evidenca 3.19.1). Investime në laboratorë të USH-së. Në FSHE ka laboratorë cilësorë, të tillë si: Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar, (krijuar me vendim të Senatit Akademik të USH nr. 264, datë 15.07.2019), laboratori në kuadër të projektit T@ask (Evidenca 3.19.2), (Evidenca 3.19.3). Në FSHN ka laboratorë në shërbim të programeve të studimit (Evidenca 3.19.4).

Standardi III.20 Institucioni siguron pajisje laboratorike, infrastrukturë dhe shërbime në mbështetje të programeve të studimit.

USH-ja pajis vazhdimisht kërkuesit me mjete dhe materiale që ndihmojnë në punën e tyre kërkimore shkencore. Në godinën e Fakultetit Ekonomik ka laboratorë për zhvillimin praktik të mësimdhënies. Aktualisht ka 2 laboratorë informatike. Këto laboratorë përdoren në aplikimin praktik të metodave kërkimore dhe programeve informative të kontabilitetit. Në këto laboratorë janë të instaluar programet SPSS dhe ALFA, në mënyrë që studentët t'i aplikojnë direkt njohuritë teorike të marra në auditor. Salla 103 funksionon njëkohësisht edhe si Qendër SMART e Inovacionit – SMART Business Hub dhe shërben si qendër për të nxitur dhe motivuar inovacionin, për të mbështetur studentët, ALUMNI, Start Up etj. (Evidencë 3.20.1).

Janë bërë investime në laboratorë, është përmirësuar infrastruktura, sidomos në katin e fundit për FSHE-në (Evidenca 3.20.2). Në kuadrin e Projektit SUCCESS (Sustainable University - Enterprise Cooperation for Improving Graduate Employability), është instaluar salla interaktive me kompjuterë të teknologjisë të fundit, pajisje për telekonferenca dhe Smart Board.

Standardi III.21 Biblioteka, infrastruktura dhe shërbimet e saj sigurojnë akses në literaturë bashkëkohore të lidhur me fushat e studimit dhe kërkimit në programe.

Biblioteka e USH-së ofron literaturë të pasur në shkencat psiko-sociale. Në bibliotekë ka botime periodike dhe elektronike. (Ref. 3.21.1. [Link](#), 3.21.2. [Link](#)).

Biblioteka arkivon dhe mirëmban pasurinë kulturore dhe shkencore të institucionit. Ajo funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 8576, datë 03.02.2000, Neni 30 "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë". Ajo kryen digjitalizimin e skedarëve dhe ka në fondin e saj rreth 111.000 libra në gjuhë shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Godina e bibliotekës ka në përbërjen e saj edhe sallën e konferencave "Walter Hoeflechner", me kapacitet 120 vende, e cila mundëson zhvillimin e një sërë aktiviteteve të karakterit akademik, mësimdhënës apo promovues.

Burim mjaft i rëndësishëm për shfrytëzimin e literaturës së huaj është edhe biblioteka digjitale, U-library. Në bashkëpunim me RASH-in, Drejtoria e IT-së e Universitetit të Shkodrës ka mundësuar aksesin në këtë librari digjitale për të gjithë pedagogët dhe studentët e Universitetit.

Revista "Buletini Shkencor", shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët. Ai mund të gjendet në bibliotekën e Universitetit, ashtu sikurse edhe online në faqen zyrtare të universitetit, me akses të hapur për të gjithë. (Evidenca 3.21.1), (Evidenca 3.21.2).

Biblioteka e USH-së ofron literaturë për të gjithë studentët me një fond të pasur në shërbim të studentëve. Pasurimi i bibliotekës nga Akademia e Shkencave, Instituti Albanologjik i Prishtinës.(Evidenca 3.21.3), (Ref.3.21.4. [Link](#)).

Programet e lëndëve kanë të përcaktuar literaturën bazë dhe atë ndihmëse Literatura bazë për mbulimin e lëndëve në programet e studimit sigurohet nga pedagogët përkatës përmes librave në gjuhë shqipe apo cikleve të leksioneve. Pedagogët orientojnë dhe ndihmojnë studentët në sigurimin e literaturës bazë dhe ndihmëse që është në gjuhë shqipe si dhe gjuhë të huaj. (Ref.3.21.5. [Link](#)).

Për FE, tekstet gjenden në kopje të konsiderueshme në dispozicion të studentëve me literatura ndihmëse. Departamenti i Administrim-Biznesit, nëpërmjet bashkëpunimeve ndërkombëtare, të tillë si atë me Sandhills Community College, realizon sjelljen e librave të viteve të fundit në fushën e menaxhimit, ekonomiksit, marketingut, etj.(Evidenca 3.21.4.).

Përfundimet dhe Vlerësimi

Programet e studimit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër (USH) ofrohen në tre ciklet e formimit universitar dhe pasqyrojnë përputhje të plotë me misionin institucional të njëjësive akademike dhe me standardet kombëtare e ndërkombëtare të arsimit të lartë. Në hartimin dhe zbatimin e tyre zbatohet në mënyrë rigorozë kuadri ligjor, në veçanti Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe parimet e Procesit të Bolonjës, duke garantuar krahasueshmërinë e kualifikimeve, mobilitetin akademik dhe transparencën institucionale.

Përputhshmëria ligjore dhe koherenca akademike

Programet e studimit janë të strukturuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke respektuar parimet e organizimit të tri cikleve të studimit dhe kërkesat formale për kurrikulat. Struktura dhe përmbajtja e tyre shfaqin ngjashmëri me programet homologe kombëtare dhe ndërkombëtare, çka dëshmon për një harmonizim të mirëfilltë akademik dhe për respektimin e standardeve të cilësisë. Kurrikulat hartohen duke u mbështetur në analiza krahasuese me universitete të brendshme dhe të huaja, me qëllim që studentëve të u krijohet mundësia të vazhdojnë studimet në ciklet pasardhëse brenda USH-së ose në institucione të tjera universitare brenda dhe jashtë vendit. Kjo qasje i jep programit fleksibilitet, transparencë dhe lehtësi në transferimin e krediteve.

Struktura kurrikulare dhe transparenca ndaj studentëve

Programet paraqesin informacion të plotë dhe të standardizuar, duke përfshirë: emërtimin e programit, kohëzgjatjen dhe numrin e krediteve, vendimet e hapjes, objektivat formues, profilin profesional dhe akademik, mundësitë e punësimit, strukturën përgjegjëse akademike, planin mësimor dhe komponentët përkatës. Rubrikat janë të hartuara sipas kërkesave të kuadrit ligjor dhe lehtësojnë interpretimin e programit nga studentët, stafi pedagogjik dhe aktorët e jashtëm.

Kapacitetet akademike dhe infrastrukture

USH garanton kapacitete të mjaftueshme akademike dhe infrastrukture për zbatimin e programeve të studimit. Ngarkesa vjetore e pedagogut është në përputhje me kërkesat ligjore dhe universiteti ndjek një politikë të qartë rekrutimi për sigurimin e stafit me kohë të plotë. Veprimtaritë e personelit akademik përfshijnë mësimdhënien, kërkimin shkencor, kontributin institucional dhe atë profesional.

Universiteti siguron gjithashtu një infrastrukturë të përshtatshme për mësimdhënie, laboratorë të specializuar, mjete didaktike, si dhe akses në literaturë bashkëkohore, duke krijuar kushte të favorshme për realizimin e procesit të të nxënies. Biblioteka e USH-së ofron literaturë të pasur në të gjitha fushat e studimit në USH. Burim mjaft i rëndësishëm për shfrytëzimin e literaturës së huaj është edhe biblioteka digjitale, U-library. JSTORE. COBISS. (Ref.1 [Link](#))

Revista "Buletini Shkencor", shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët. Ai mund të gjendet në bibliotekën e Universitetit, ashtu sikurse edhe online në faqen zyrtare të universitetit, me akses të hapur për të gjithë. (Ref.2 [Link](#))

Organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit

Programet e ciklit të parë dhe të dytë janë të strukturuar në mënyrë që të sigurojnë: formim të përgjithshëm akademik, formim të specializuar të profilit, komponentë integruar, lëndë me zgjedhje, projekte kursi dhe angazhime të punës së pavarur, praktikë profesionale dhe punimin e diplomës. Syllabuset e lëndëve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke reflektuar prurjet më të reja shkencore dhe profesionale. Ato mbështeten në literaturë bashkëkohore dhe referenca ndërkombëtare të viteve të fundit, duke garantuar nivel të lartë akademik.

Programet janë të krijuara për të mundësuar transferimin horizontal dhe vertikal të krediteve, bazuar në rregulloret institucionale përkatëse.

Praktikat profesionale dhe lidhja me tregun e punës

Në shumicën e programeve parashikohen praktika profesionale, të cilat realizohen përmes bashkëpunimeve institucionale me entitete shtetërore dhe private. Institucionet partnere përfshijnë: Bashkinë Shkodër, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Spitalin Rajonal Shkodër, Drejtorinë Arsimore Rajonale, Gjykatat e juridiksionit vendor, OJF si "The Door", Fototekën "Marubi", Muzeun Historik të Shkodrës dhe organizata të tjera të shoqërisë civile.

Këto marrëveshje sigurojnë aplikimin praktik të njohurive dhe nxisin integrimin e studentëve në tregun e punës.

Mekanizmat e sigurimit të brendshëm të cilësisë

USH ka të konsoliduar mekanizma funksionalë të sigurimit të cilësisë, si:

- Grupet e Vlerësimit të Brendshëm,
- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë,
- mbledhjet e departamenteve për diskutimin e programeve,
- analizat vjetore të performancës akademike dhe shkencore,
- miratimet e rregullta të syllabuseve dhe RVB-ve.

Studentët përfshihen në procesin e vlerësimit të programeve përmes mekanizmave institucionale të feedback-ut, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Zhvillimi profesional i stafit akademik

Zyra e Ekselencës organizon trajnime periodike për pedagogët e rinj dhe ata me përvojë, me fokus në metodat bashkëkohore të mësimdhënies, strategjitë e kërkimit shkencor dhe risitë në fushën e edukimit. Ky dimension siguron zhvillim të qëndrueshëm profesional dhe ndikon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

Diplomimi dhe transparenca e kualifikimeve

Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës në gjuhën shqipe dhe angleze, i cili përmban informacion të detajuar mbi: planin mësimor, rezultatin akademik, kompetencat e përfituara, dhe ecurinë e përgjithshme të studimeve.

Ky dokument shërben si instrument transparence dhe lehtëson procesin e njohjes së diplomave në nivel ndërkombëtar.

Në përmbledhje, programet e studimit të USH-së paraqiten të strukturuar, koherente dhe të përputhshme me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Ato përmbushin kërkesat ligjore, akademike dhe profesionale, duke garantuar një nivel të lartë të formimit teorik dhe praktik. Përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, bashkëpunimeve institucionale dhe trajnimeve të vazhdueshme të

stafit akademik, universiteti siguron ofrimin e një arsimit cilësor dhe të qëndrueshëm. Programet kontribuojnë në formimin e profesionistëve të aftë, me kompetenca të qarta akademike dhe profesionale, të gatshëm të kontribuojnë në tregun e punës dhe në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

Vlerësimi i fushës: Standardet përmbushen plotësisht.

FUSHA IV- AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK DHE INOVACIONI

Standardi IV.1 Institucioni përcakton fushat parësore të aktiviteteve kërkimore, shkencore / artistike.

Hulumtimi dhe kërkimi shkencor bazohen në strategjitë e kërkimit në arsimin e lartë. Në përputhje me misionin e tij, institucioni organizon vazhdimisht aktivitete që promovojnë debatin shkencor në fushat parësore të kërkimit shkencor, përmes organizimit të ligjëratave të hapura ose workshop-eve të ndryshme. Aktivitetet e realizuara në frymën e këtij bashkëpunimi, synojnë të përfshijnë sa më shumë edhe kontributin e studentëve. Stafit akademik angazhohet dhe kontribuon në ideimin, organizimin, drejtimin e këtyre aktiviteteve. Fushat parësore të aktiviteteve kërkimore shkencore janë përcaktuar nga MAS (Ref.4.1.1 [Link](#)), dhe Senati i Universitetit të Shkodrës në vendimin nr. 97, datë 29.03.2022, “Për miratimin e fushave prioritare kërkimore në Universitetin e Shkodrës”, ku përcaktohen si parësore fushat, si: Albanologjia, Biodiversiteti dhe ndotja e mjedisit, Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm, Integrimi evropian, Reforma në drejtësi, Shkencat sociale dhe pedagogjike dhe studimet territoriale. (Evidenca 4.1.1) Në varësi të fushave dhe karakteristikave të secilit departament, USH-ja i përmbahet këtyre pikave në zhvillimin e aktivitetit kërkimor. (Evidenca 4.1.2) (Evidenca 4.1.3).

Fakultetet kanë miratuar planin strategjik 2022-2026 (Evidenca 4.1.4), duke vënë në qendër një misioni i cili ndjek të njëjtën linjë me misionin e USH-së, duke synuar krijimin, zhvillimin, mbrojtjen dhe transmetimin e dijeve me anën e mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore, gjithashtu formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkencëtarëve të rinj në fushat përkatëse. Edhe programet e studimit në FSHE, FSHN dhe FE po bëjnë përpjekje për hartimin e planeve të tyre strategjike (Evidenca 4.1.5). Kjo punë kodifikohet me anë të rregulloreve, ndaj dhe secili program studimi ka rregulloren e vet (Evidenca 4.1.6/a/b/c/d).

Secili fakultet në USH punon për realizimin e objektivave me qëllim që të sigurojë një mësimdhënie të cilësore, të krijojë kushte për mësim dhe kërkim shkencor si dhe të përgatisë specialistë të aftë në të gjitha disiplinat që mbulon USH-ja (Evidenca 4.1.7). Në këtë kuadër, fakultetet organizojnë vazhdimisht aktivitete që nxisin debatin shkencor në fushat parësore të kërkimit shkencor, si konferenca, seminare, workshop-e, konferenca studentore, leksione të hapura etj., ku stafi akademik angazhohet duke dhënë kontributin e tij. Në këtë kuadër departamentet e FE-së organizojnë vazhdimisht leksione të hapura me ekspertë të jashtëm në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe zgjerimit të lidhjeve të kërkimit shkencor në fakultet me ekspertët dhe profesionistët përkatës në profilet e studimit të këtij fakulteti (Evidenca 4.1.8/a/b/c).

FSHSH-ja zbaton prioritetet e kërkimit shkencor përmes organizimit të konferencave shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, realizimit të mobilitetit të stafit akademik dhe botimit periodik të “Buletinit Shkencor”, duke u fokusuar në disiplinat shkencore, në të cilat është i specializuar stafi i FSHSH-së (Evidenca 4.1.9).

Gjithashtu FGJH-ja ka organizuar një sërë aktiviteteve. Kështu, në mjediset e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, me datë 10.10.2024, u mbajt tryeza e rrumbullakët me temë “Promovim i territorit: Shkodra dhe zonat përreth saj; modele dhe përvoja pozitive” në kuadër të projektit PLACOD. (Ref.4.1.2 [Link](#), 4.1.3.[Link](#), 4.1.4.[Link](#), 4.1.5.[Link](#), 4.1.6.[Link](#), 4.1.7.[Link](#)).

Standardi IV.2 Institucioni zbaton prioritetet e aktivitetit kërkimor shkencor.

Çdo vit secili departament zhvillon analizën e punës mësimore shkencore, ku, krahas rezultateve të arritura, përcaktohen dhe prioritetet për vitin pasardhës. (Evidenca 4.2.1, 4.2.2).

USH-ja vazhdimisht pajis kërkuesit me mjete dhe materiale që i ndihmojnë ata në punën e tyre, si p.sh. janë krijuar laboratorëve kërkimorë – shkencorë, i ndihmon me bazë materiale etj. USH-ja zbaton prioritetet e kërkimit shkencor përmes organizimit të konferencave shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, realizimit të mobilitetit të stafit akademik dhe botimit periodik të revistës “Buletin Shkencor”. (Evidenca 4.2.4/a/b).

Stafi i USH-së duke u fokusuar në disiplinat shkencore, në të cilat është i specializuar, mbështet personelin që është në procesin e doktoratës, për të përfunduar studimet brenda dhe jashtë vendit duke i krijuar hapësirat e nevojshme për organizimin e ngarkesës vjetore në mënyrë fleksibël.

USH-ja është e angazhuar të ndërmarë kërkime në nivel rajonal dhe global në bashkëpunim me institucione të tjera (Evidenca 4.2.5). Objektivi i rëndësishëm i Universitetit të Shkodrës, si dhe i gjithë studentëve që studiojnë në universitetin tonë është njohja në shkallë ndërkombëtare e diplomës që studenti merr gjatë studimit në universitet. Arritja e këtij objektivi është e lidhur dhe me cilësinë e mësimdhënies, nivelin e stafit akademik, nivelin e studentëve, me kushtet e studimit dhe të kërkimit shkencor. Zbatimi i projekteve ndërkombëtare ka ndihmuar në gjetjen e partnerëve strategjikë në kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit. USH-ja ka krijuar një traditë me pjesëmarrje në projektet TEMPUS (sot Erasmus +), ku ka qenë partner. Në vitet në vazhdim synohet të punohet për të hartuar projekte shkencore ku USH-ja të ketë rol drejtues. (Evidenca 4.2.6), (Evidenca 4.2.7/a/b). Në këtë kontekst, stafi akademik i FD-së ka qenë i përfshirë edhe gjatë vitit akademik 2024-2025 në projektet e Klinikës së ligjit (Evidenca 4.2.8). (Ref. [Link](#), [Link](#)).

Një ndër prioritetet kryesore të USH-së dhe të gjithë fakulteteve të saj është rekrutimi i personelit akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor, në funksion të strategjisë së zhvillimit institucional. USH-ja synon të rekrutojë staf të specializuar në kërkim shkencor, veçanërisht individë që kanë përfunduar studimet në universitete të huaja. Në përputhje me këto prioritete edhe FE-ja mbështet edhe kualifikimin e mëtejshëm të stafit aktual në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit. Një pjesë e konsiderueshme e stafit akademik ka përfunduar të paktën një cikël studimesh në universitete evropiane ose në SHBA. Gjithashtu, të gjithë anëtarët e stafit marrin pjesë në procesin e mësimdhënies në universitete partnere me të cilat FE-ja ka marrëveshje bashkëpunimi. (Evidenca 4.2.9).

Standardi IV.3 Institucioni inkurajon zhvillimin, dinamizmin e veprimtarive kërkimore / artistike dhe shkencore.

USH-ja ka tashmë një politikë të konsoliduar në kuadër të mbështetjes së punës kërkimore shkencore të personelit akademik, e cila realizohet më së miri nëpërmjet publikimeve të kërkimeve shkencore të stafit akademik në revista shkencore në fusha të ndryshme sipas fakulteteve. Shumica e botimeve të stafit akademik të USH- së gjenden në revistën “Buletini shkencor” të Universitetit “Luigj Gurakuqi” (rivlerësuar si e tillë edhe me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës nr. 98, datë 28.3.2000, mbështetur në vendimin nr. 4, datë 17.3.2000 të Komisionit të Rikonsiderimit të Periodikëve Shkencorë) (Evidenca 4.3.1). Institucioni promovon punën shkencore të personelit akademik duke e mbështetur financiarisht në pjesëmarrjen në konferenca dhe botime artikujsh, gjë që e rrit motivimin për punë shkencore. Ai inkurajon kërkimin shkencor në nivel departamenti dhe fakulteti, kryesisht nëpërmjet promovimit të arritjeve të pedagogëve, bashkëpunimit për organizimin e konferencave, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione të ndryshme apo përmes pjesëmarrjes në projekte (Evidenca 4.3.2/a/b/c/). Bordi i Administrimit ka miratuar fondin financiar për të mbështetur personelin akademik në kuadrin e punës kërkimore–shkencore (Evidenca 4.3.3)

Në USH organizohen promovime të punimeve shkencore të personelit akademik apo edhe leksione të hapura, konferenca në të cilat prezantohen dhe diskutohen punime të ndryshme shkencore të personelit akademik të USH-së dhe stafeve akademike nga Universitete të tjera brenda apo jashtë vendit si dhe me pjesëmarrje të studentëve (Evidenca 4.3.4/a/b) Organizimi i konferencave dhe i botimeve zhvillohet duke ndarë përgjegjësitë shkencore me secilin departament. (Evidenca 4.3.5).

Në këtë drejtim mund të përmendim Konferencën shkencore ndërkombëtare “*The process of harmonization of Albanian law with the EU and the experiences of other countries. Theoretical and practical issues*” e zhvilluar në 5 dhjetor 2024, të organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë së bashku me Departamentin e Shkencave Juridike dhe Shkollën Juridike të Universitetit të Firences. (Ref. [Link](#))

Në departamentin e Gjuhës Angleze janë organizuar aktivitete letrare dhe mësimore me studentët e programit Bachelor (Evidenca 4.3.6).

Në departamentin e Romanistikës, në bashkëpunim me Aleancën Franceze, është zhvilluar një diskutim me studentët mbi mendimin filozofik të Albert Kamysë. (Evidenca 4.3.7).

Stafi akademik aplikon për bashkëpunime dhe projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Në kuadër të bashkëpunimeve, janë nënshkruar disa marrëveshje me institucione homologe jashtë vendi, siç është bashkëpunimi dhe marrëveshja me UHA-së (Universiteti i Haut-Alsace, Francë); anëtarësimi i USH-së në AUF (Agjensia Universitare Frankofone), marrëveshje me Caen-Normandie.

Edhe FE-ja inkurajon kërkimin shkencor të stafit edhe të studentëve nëpërmjet organizimit të përvitshëm të Workshopit “Sfidat e zhvillimit rajonal”.

Standardi IV. 4. Institucioni dhe njësitë përgjegjëse për kërkimin shkencor/ artistik dhe inovacionin vlerësojnë përmbushjen e tyre në nivel fakulteti.

USH-ja informohet dhe bën vlerësimin e veprimtarisë kërkimore, shkencore dhe artistike të stafit të tij akademik, përmes analizës së punës kërkimore-shkencore, që hartohet dhe diskutohet çdo vit, me qëllim mbështetjen e hulumtimit shkencor dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik në nivel institucional. Senati Akademik realizon analizën e punës mësimore e shkencore dhe miraton raportin e vlerësimit të brendshëm (Ref. [Link](#)), ndërsa departamentet, të cilat përfshijnë fusha kërkimi të përafërta dhe grupojnë disiplinat respektive, janë njësitë bazë të zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore të fakultetit, përgjegjëse edhe për vlerësimin e performancës së stafit akademik si në drejtim të mësimdhënies ashtu edhe të kërkimit shkencor (Evidenca 4.4.2)

Me vendimin e Rektorit nr. 320, të datës 02.12.2025, është ngritur njësi institucionale e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe të programeve të studimit (Evidenca 4.4.1), njësi përkatese për vlerësimin e cilësisë në kuadër të mësimdhënies, por edhe të punës për ngritjen shkencore të personelit.

Standardi IV.5 Institucioni garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato me qëllim zhvillimin ekonomik dhe financiar të tij.

USH-ja ndjek një politikë të qartë për garantimin e pronësisë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato me qëllim zhvillimin ekonomik dhe financiar të tij. Pronësia intelektuale garantohet nga Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të tjera të drejta të lidhura me to”. USH-ja siguron zbatimin e këtij ligji përmes formimit të redaksive shkencore, të cilat marrin vendime mbi botimin e artikujve shkencorë, kumtesave në konferenca etj. Këto Këshilla Shkencore kontrollojnë zbatimin e parimeve të pronësisë intelektuale, marrjen e masave kundër plagjiaturës etj. (Ref. [Link](#)).

FSHE-ja dhe FSHN-ja kanë shumë resurse të cilat duhet të përdoren për rritjen financiare të institucionit. Mund të përmendim ngritjen e Klinikës së shërbimit psikologjik dhe social, Qendrën e Diagnostikimit Mirobiologjik “Wolf Dieter Sixl” e cila prej 18 vitesh ofron shërbim për të tretët, laboratorin e fizioterapisë që përbëjnë dhe një nga objektivat e strategjisë së zhvillimit të USH-së. (Evidenca 4.5.2/a). Me mjaft interes është dhe zhvillimi i trajnimeve në fushën e mësuesisë, në fushën e shkencave mjekësore teknike apo zhvillimi i veprimtarive sportive e artistike. FE-ja ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private brenda vendit. Një pjesë e konsiderueshme e praktikave profesionale të studentëve realizohet pranë bizneseve të ndryshme që operojnë në rajonin e Veriut, si: Dhoma e Tregtisë, banka të nivelit të dytë, kompani të sektorëve të ndryshëm, zyra që ofrojnë shërbime të licencuara kontabiliteti finance etj. Këto bashkëpunime krijojnë mundësi për aplikimin e njohurive shkencore në mjedise reale pune dhe kontribuojnë në rritjen e impaktit ekonomik të institucionit. (Evidenca 4.5.2).

FD-ja jep kontributin e vet në edukimin dhe pajisjen e studentëve me njohuritë bazë dhe specifike në fushën e pronësisë intelektuale, edhe përmes syllabuseve të ndryshme. Në këtë fakultet zhvillohet lënda e “Mbrotjes së Pronësisë Intelektuale”, e cila ofrohet në programet e studimit të këtij fakulteti (Evidenca 4.5.3). Stafit akademik, mbi bazën e disiplinës përkatëse të studimit, orienton dhe asiston gjatë gjithë periudhës së studimit studentët, sidomos në rastet kur ata kryejnë punë kërkimore shkencore, duke i orientuar drejt praktikave më të mira kërkimore shkencore në mbrojtje të plotë të pronësisë intelektuale.

Standardi IV.6 Në zbatim të prioriteteve të kërkimit shkencor/artistik, institucioni kanalizon veprimtaritë e kërkimit në nivel departamenti.

Në departamentet përkatëse të USH-së zhvillohet çdo vit analiza e kërkimit shkencor dhe diskutimeve në kontekstin e aktiviteteve të përqendruara në kërkime dhe përpilohen raporte, ato përmbledhen në raportet vjetore të punës kërkimore të hartuar nga departamentet dhe më pas i referohen Dekanatit për diskutim dhe miratim. Dekanati, pas shqyrtimit, përgatit përmbledhjen përfundimtare dhe ia përcjell Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, në përputhje me procedurat institucionale. (Evidenca 4.6.1).

USH-ja mbron pronësinë intelektuale, duke u dhënë studiuesve të drejta ekskluzive në promovimin e veprimtarisë kërkimore botuese. Në zbatim të Statutit të USH-së (neni 9, pika 2.1) secili departament planifikon punën e vet shkencore për vitin në vijim si dhe ka bashkëpunime ndërmjet tyre për organizime konferencash apo veprimtarish të tjera, duke respektuar lirinë akademike të stafit dhe fushën e veçantë të studimit në njësitë bazë. Në FD kjo evidentohet edhe në rastet e përcaktimit të temave të diplomave për Masterin Shkencor, të cilat përcaktohen kryesisht në përputhje me prioritetet që strategjia e USH-ja ka përcaktuar në fushën e drejtësisë, si dhe në tematika të ndjeshme për komunitetin rajonal dhe zhvillimet e përgjithshme në shoqëri. Edhe në analizën e punës shkencore në FSHN-ja, pasqyrohet informacioni i dhënë nga çdo pedagog, që përfshin prioritetet për të ardhmen, (Evidenca 4.6.2/a/b). Gjithashtu në FSHE dhe FE departamentet nxisin, bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies me veprimtaritë kërkimore, artistike e sportive. (Evidenca

4.6.3) Bashkëpunime ka edhe ndërmjet pedagogëve dhe studentëve, si në përfshirjen e studentëve në kërkime shkencore, ashtu dhe në veprimtari të ndryshme. (Evidenca 4.6.4/a/b/c/d)

Në këtë kuadër, një sërë projektesh të rëndësishme ndërkombëtare dhe kombëtare kanë kontribuar drejtpërdrejtë në zhvillimin akademik dhe kurrikular të FE-së, si projektet MARDS FINAC, USIA, dhe U2SID. Falë mbështetjes së këtyre projekteve, janë hartuar dhe po zbatohen programe studimi të reja, përfshirë programin e ciklit të tretë Doktoratë në “Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm” dhe programin e ciklit të dytë Master FINAC, Gjithashtu, “Workshop-i mbi Metodatat e Kërkimit Sasior dhe Cilësor”, i iniciuar nga Departamenti i Biznesit, realizohet në bashkëpunim të plotë edhe me dy departamentet e tjera, duke krijuar një platformë të përbashkët për zhvillim të kapaciteteve kërkimore dhe shkëmbim praktikash të mira. (Evidenca 4.6.5) (Ref. [Link](#), [Link](#), [Link](#), [Link](#)).

Standardi IV.7 Institucioni miraton objektiva të qarta për njësitë, grupet kërkimore / artistike dhe personelin akademik.

USH-ja ka objektiva të qarta të punës kërkimore, të mishëruara në strategjitë sektoriale dhe në Strategjinë e përgjithshme të Universitetit, e cila ka përcaktuar prioritetet e zhvillimit shkencor në disa fusha, ku përfshihen ndër të tjera albanologjia, shkencat sociale, turizmi, pedagogjia, integrimi evropian.

Janë përcaktuar edhe strategjitë për zbatimin e këtyre prioritetëve, (Evidenca 4.7.1) por dhe fakultetet kanë përcaktuar objektiva të qarta, si p.sh. në FSHE, FE (Evidenca 4.7.2).

Nëpërmjet programeve e projekteve Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Qendra e Studimit të Ujërave për Rajonin e Shkodrës kanë parashtruar një politikë të përgjithshme shkencore në vite.

Departamentet në përputhje me prioritetet dhe objektivat e përcaktuara nga Universiteti i Shkodrës në fushën e kërkimit shkencor, miratojnë objektivat e qarta në lidhje me kërkimin shkencor. Kjo evidentohet më së miri në raportet vjetore në lidhje me punën kërkimore shkencore të stafit akademik e cila përgatitet në nivel departamenti. Në këto raporte evidentohen si arrijtet ashtu edhe objektivat për vitin pasardhës në fushën kërkimore shkencore, njëkohësisht, evidentohen pikat e forta dhe pikat e dobëta të kërkimit shkencor. (Evidenca 4.7.3)

Në rang departamenti, duke u mbështetur te Statuti i USH- së, duhet të përcaktohen grupet kërkimore, të cilat, mund të përfshijnë stafin akademik, ndihmës akademik dhe studentë mbi bazën e fushave të veçanta të studimit (Evidenca 4.7.4). Në raste të tjera ka pasur bashkëpunim midis departamenteve të ndryshme të fakultetit, veçanërisht kur projektet kërkimore shkencore kërkojnë përfshirjen e stafit akademik me njohuri në disiplina të ndryshme juridike (Evidenca 4.7.5).

Standardi IV.8 Institucioni synon rritjen e vazhdueshme të veprimtarive kërkimore/artistike e shkencore dhe garanton gjithëpërfshirjen e personelit akademik dhe studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë.

Në USH janë zhvilluar një sërë veprimtarish që kanë si synim rritjen e vazhdueshme të veprimtarive kërkimore shkencore të stafit të vet akademik, duke inkurajuar dhe përfshirë edhe studentët e ciklit të dytë gjatë periudhës së studimit, duke promovuar punimet e tyre në fusha të ndryshme, nëpërmjet përfshirjes në projekte dhe punime në fusha të veçanta studimi. Kjo i jep mundësi si stafit akademik ashtu edhe studentëve të kryejnë studime dhe kërkime në fusha të ndryshme, duke i aftësuar ata dhe duke përfutur njohuri në fusha specifike. Kështu FSHE-ja ka vendosur si një nga objektivat e punës në vitet në vazhdim, rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor. (Evidenca 4.6.4/a/b/c) (Evidenca 4.8.1).

Në kuadër të Ditës së Drejtësisë, në Fakultetin e Drejtësisë u zhvillua Konferenca shkencore studentore: “Çështje të së drejtës dhe të jurisprudencës”. (Ref. [Link](#)), ndërsa në Klinikën e Ligjit pranë USH-së, edhe këtë vit, studentët e programeve të ndryshme të Fakultetit të Drejtësisë kanë marrë pjesë në trajnime dhe janë pajisur me certifikata” (Evidenca 4.8.2). Në FSHSH kemi pasur organizime të tilla në fushat. si gazetari, histori, albanologji, letërsi, shqipe, gjuhësi, gjeografi të terrenit, rajone etj. (Evidenca 4.8.3) Departamenti i Gjuhës Angleze me mbështetjen e Ambasadës Amerikane dhe Institutit Shqiptar të Medias, ka zhvilluar projektin “VideoChallenge në Anglisht: Edukimi për Median

dhe Informacionin” (Evidenca 4.8.4). Në këtë kuadër edhe FE-ja ka angazhuar studentët e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve në konferenca shkencore të organizuara nga FE-ja dhe USH-ja, duke krijuar mundësi për zhvillim akademik, shkëmbim profesional dhe afirmim të punës kërkimore të tyre. (Evidenca 4.8.5). FSHN, gjithashtu, ka vendosur si një nga objektivat e punës në vitet në vazhdim rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor të pasqyruara te puna mësimore- shkencore e fakultetit.

Standardi IV.9 Institucioni bën të njohura rezultatet në fushën e kërkimit shkencor/artistik.

Çdo përfundim të vitit akademik departamentet dhe fakultetet raportojnë dhe bëjnë të njohura rezultatet e arritura në fushën e kërkimit shkencor. Të tilla janë: pjesëmarrjet në konferenca; botimet në revista shkencore me faktor impakti, veçanërisht ato me faktor impakti scopus; pjesëmarrje në projekte, të gjitha këto kombëtare dhe ndërkombëtare, apo edhe botime të monografive shkencore dhe cikleve të leksioneve. Në këto aktivitete shkencore aktivizohet stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme (Evidenca 4.9.1/a). Ky informacion në vazhdim i përcillet Rektoratit Universitetit të Shkodrës dhe diskutohet çdo vit në Senatën Akademik të USH- së me qëllimin kryesor mbështetjen e hulumtimit shkencor. (Evidenca 4.9.2/a/b/c). Sa i përket punimeve të studentëve, ndër të tjera, në bibliotekën e USH-së dorëzohet një kopje e çdo punimi mikroteze nga studentët në ciklin e dytë të studimeve.

Në qendër të vëmendjes janë edhe buletinet, si p.sh.: “Buletini i Shkencave Shoqërore”, “Buletini i Shkencave Didaktike”, sikurse dhe periodiku i Qendrës së Albanologjisë me titull “Studime Shqiptare”. (Evidenca 4.9.3) (Ref. [Link](#)).

“Buletini i Shkencave Ekonomike” të USH-së ka arritur një përhapje të gjerë gjeografike, duke botuar artikuj jo vetëm nga stafi i universitetit, por edhe nga universitete të tjera shqiptare dhe institucione akademike të rajonit, si: Universiteti i Podgoricës, Prishtinës, Tetovës, Sarajevës, Zagrebit etj. Ky proces i ndërkombëtarizimit është konsideruar një faktor i rëndësishëm për rritjen e cilësisë së artikujve të botuar, si dhe për promovimin e punës kërkimore të stafit akademik të USH- së. (Evidenca 4.9.4) (Ref. [Link](#), [Link](#)) Për më tepër, me hartimin e paketës me instrumentet matës të performancës së stafit akademik, në nivel USH-je, tashmë ka një instrument konkret për matjen e progresit në veprimtarinë shkencore të këtij stafi. (Evidenca 4.9.5).

Standardi IV.10 Institucioni është përgjegjës për garantimin e cilësisë së punimeve shkencore/artistike dhe integritetin e tyre në nivel institucional.

Cilësia e punimeve shkencore përcaktohet nga Këshillat Shkencore dhe Komisionet shkencore të formuara nga secili departament nëpërmjet analizës së kërkimit shkencor dhe diskutimeve në lidhje me aktivitetet kërkimore dhe projektet e ndryshme. Në këtë drejtim përpilohen raporte të punës shkencore si dhe bëhen planifikime të punës së ardhshme shkencore. (Evidenca 4.10.1) Njësitë akademike të ngarkuara për cilësinë e kërkimit shkencor janë njësitë kryesore dhe ato bazë (Evidenca 4.10.3).

Revistat shkencore për përzgjedhjen e punimeve realizojnë një procedurë të vlerësimit të tyre me anë të recensimit të fshehtë. Artikujt e ardhur në përgjigje të thirrjes, vlerësohen nga dy recensues njëkohësisht, në mënyrë të pavarur. Nëse artikulli vlerësohet që ka nevojë për rishikim, së bashku me sugjerimet përkatëse të recensuesit, i përcillet sërish autorit/ëve, i cili e rikthen të ndryshuar sipas sugjerimeve më lart. Mbasi rishikohet edhe njëherë artikulli i kthyer dhe rezulton sipas standardeve të kërkuara, ai dërgohet për botim. Çdo punim shoqërohet me formatin e punimit të buletinit dhe formatin e recensës për vlerësim. Rezultatet i dërgohen autorit/autorëve (Evidenca 4.10.4).

USH- ja ka organizuar konferenca shkencore ndërkombëtare në bashkëpunim me partnerë vendas dhe të huaj. Në këto konferenca Bordi shkencor ka monitoruar cilësinë e punimeve të prezantuara dhe të monitoruara, por tashmë është e domosdoshme që institucioni të ketë sistemin antiplagjiaturë.

Standardi IV.11 Institucioni i llojit universitet/akademi përcakton qartë detyrimet për personelin akademik në kuadër të pjesëmarrjes në veprimtari kërkimore, studime, publikime e botime dhe i mbështet për përmbushjen e tyre.

Institucioni ka të përcaktuar qartë detyrimet e personelit akademik në lidhje me pjesëmarrjen e tij në veprimtari kërkimore shkencore, studime, publikime apo botime.

Për çdo konferencë apo revistë shkencore, USH-ja përcakton dhe informon qartë pedagogët, përmes faqes zyrtare të institucionit dhe përmes email-it zyrtar mbi kriteret dhe kushtet për pranimin dhe botimin e artikujve dhe kumtesave shkencore (Evidenca 4.11.1).

USH-ja, me qëllimin kryesor mbështetjen dhe promovimin e personelit akademik në kuadër të ngritjes profesionale të stafit, ka vendosur të mbështesë stafin akademik me kohë të plotë duke financuar projektet kërkimore për pedagogët që janë pranë marrjes së titujve akademikë apo financim të projekteve kërkimore për pedagogët që janë të angazhuar në kërkim shkencor (Evidenca 4.11.2; 4.11.3; 4.11.4). Sa u përket artikujve dhe konferencave të pedagogëve, gjithashtu USH-ja është e gatshme të mbështesë stafin akademik me pagesën e tarifave të shkollave doktorale, për asistent lektorët dhe me pagesën për shqyrtimin e dosjeve për kategorinë "Profesor".

Standardi IV.12 Institucioni që ka përcaktuar në strategjinë e vet si prioritet kryesor kërkimin shkencor, fokusohet në ndërkombëtarizimin e kërkimit dhe veprimtarive që lidhen me të.

Në strategjinë e USH-së thelbi i kërkimit shkencor është ndikimi pozitivisht në komunitetin lokal dhe njerëzit brenda rajonit e më gjerë. Në mënyrë të detajuar për këtë është hartuar dhe "*Strategjia për kërkimin shkencor*" e cila është miratuar së bashku me "*Strategjinë e komunikimit dhe informimit publik*," "*Strategjinë për mësimdhënien dhe Strategjinë e ndërkombëtarizimit të USH-së*", të miratuara me vendimin e Senatit të USh-së nr. 79 të datës 25.3.2022, "*Për miratimin e strategjive sektoriale në USh*", nr. Prot.1138, datë 25.3.2022.

Institucioni është angazhuar për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. Këtu vlejnë për t'u përmendur trajnimet e vazhdueshme që janë mbajtur në rang universiteti në kuadër të projektit TEAVET të hapura ndaj të gjithë personelit të interesuar të USH-së. Një tjetër zë interesant është trajnimi ndaj qasjes së platformave dhe metodave të reja inovative e dobishme për binomin interaktiv kyç, personel akademik- student, i cili ka rezultuar të jetë efikas dhe i domosdoshëm për periudhën e dy viteve të fundit. Stafi akademik, për të qenë sa më afër risive të teknologjisë dhe metodave të reja të mësimdhënies, ka përfituar dhe shfrytëzuar në dobi të zhvillimit profesional dhe individual të vetë pedagogut, duke marrë pjesë në webinar-e dhe workshop-e, të sugjeruara nga kalendari i aktiviteteve të parashikuara gjatë vitit akademik 2024- 2025. (Ref. [Link](#), [Link](#)). Në FSHSH e FSHN disa herë në vit organizohen konferenca shkencore ndërkombëtare me pjesëmarrjen e personelit akademik nga vende të tjera. Stafi akademik, gjithashtu, merr pjesë aktive në konferenca shkencore të organizuara jashtë vendit dhe si botues në revista shkencore, por ka edhe përmirësim të angazhimit të studentëve në punë kërkimore-shkencore. (Evidenca 4.12.1/a) (Evidenca 4.12.2).

Prioriteti i kërkimit shkencor nuk mund të shihet i veçuar nga procesi i ndërkombëtarizimit të Universitetit të Shkodrës. Në këtë drejtim USH-ja ka si synim nxitjen dhe mbështetjen e shkëmbimit të eksperiencave dhe të mobilitetit të pedagogëve e studentëve për të përafruar dhe njëzuar programet e ndryshme të studimit, por edhe me qëllime të kërkimit shkencor (Evidenca 4.12.3).

Në bazë të strategjisë së IAL-së, bashkëpunimi ndërkombëtar është një përparësi, së bashku me lëvizshmërinë e pedagogëve dhe studentëve në programe të ndryshme studimi. Në këtë drejtim USH-ja ka nënshkruar vazhdimisht marrëveshje bashkëpunimi me universitete të huaja, si me Universitetin e Bergamos, Messinës, në kuadër të Programit Erasmus Catania, Firences, Universitetin "La Sapienza" të Romës, Universitetin "Luigi Vanvitelli" të Napolit në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy Universiteteve, Universitetin e Malit të Zi, Universiteti i Selanikut. Gjithashtu janë nënshkruar marrëveshje me Fakultetet e Ekonomisë si në IAL-të brenda vendit, por edhe marrëveshjen bilaterale me universitete në SHBA, Bashkimin Evropian apo dhe rajonin (Evidenca 4.12.4/a/b), të cilat kanë në fokus mobilitetin e studentëve, stafit akademik, miratimin e diplomave të dyfishta, si dhe kërkimin shkencor. Të gjitha këto në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit të

Universitetit të Shkodrës dhe me qëllimin kryesor kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të stafit akademik (Evidenca 4.12.5).

FE-ja, po ashtu, ndjek një politikë të qartë të integritetit dhe ndërkombëtarizimit, duke ftuar rregullisht kërkues të huaj në konferencat shkencore, workshop-et dhe leksionet e hapura që organizon institucioni. Këto iniciativa synojnë jo vetëm rritjen e profilit ndërkombëtar të universitetit, por edhe shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira në fusha të ndryshme akademike. (Evidenca 4.12.6).

Standardi IV.13 Institucioni ka prioritet përfshirjen në veprimtaritë mësimore e shkencore/artistike të personelit të huaj akademik dhe diasporës.

Institucioni ka ndërtuar një praktikë shumë të mirë në aspektin e bashkëpunimit dhe komunikimit të ndërsjellë profesional me stafet akademike si brenda vendit ashtu edhe në rajon apo në nivel ndërkombëtar. Kryesore janë bashkëpunimet e vetë fakulteteve ose të departamenteve me personel akademik të huaj në organizimin e konferencave shkencore, ekspozitave me karakter artistiko-shkencor, revistave shkencore etj.

Në FSHSH përfshirja e stafit akademik të huaj në veprimtaritë mësimore realizohet kryesisht duke përfshirë si pjesë të stafit pedagogë nga vendet e rajonit apo diaspora arbëreshe me status “të jashtëm” ose “të ftuar”, të cilët janë nderuar edhe me çmime. (Evidenca 4.13.1). FSHN po punon në këtë drejtim sidomos me projektin Research Expertise th Academic Diaspora (READ) në mënyrë që të afrojmë personelin akademik nga diaspora. (Ref. [Link](#))

Në Fakultetin e Drejtësisë Prof. Jean-Michel De Waele, Profesor në Fakultetin e Shkencave politike në Université Libre de Bruxelles ka qenë i angazhuar në mësimdhënie pranë Departamentit të së Drejtës Publike dhe Penale (Evidenca 4.13.2). Pranë departamentit të Gjermanistikës është e atashuar një pedagoge austriake, e cila nëpërmjet eksperiencës së saj ndikon në tejçimin e kulturës austriake dhe nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme kulturore, të cilat mbështeten dhe nga ambasada austriake. Pranë Departamentit të Gjuhës angleze, për vitin akademik 2024-2025, kemi një lektore amerikane që vjen si *Follow* nga Ambasada Amerikane në vazhdimësi të bashkëpunimit që ka departamenti me këtë ambasadë (Evidenca 4.13.3). Në muajin prill, në kuadër të lëndës Praktikë e Gjuhës Angleze ku integrohen katër aftësitë gjuhësore, u ftua vullnetarja e Korpusit të Paqes, znj. Selina Riley, për të mbajtur një ligjëratë informuese mbi Black History. (Evidenca 4.13.4)

Pjesëmarrja e FE-së në programe dhe projekte ndërkombëtare shkëmbimi si ERASMUS+, CEEPUS, READ, etj., ka mundësuar mobilitet të ndërsjellë, mbajtje të leksioneve të hapura, workshop-eve dhe trajnimeve nga ekspertë ndërkombëtarë, po ashtu, bashkëpunimet janë lehtësuar edhe nga rrjetet profesionale që stafi akademik i FE-së ka ndërtuar ndër vite me kolegë në universitete të huaja. (Evidenca 4.13.5), (Evidenca 4.13.6).

Një kontribut të veçantë në ndërkombëtarizimin e veprimtarisë akademike të fakultetit e japin edhe dy ish-pedagoge të FE-së, të cilat sot zhvillojnë karrierën e tyre akademike në SHBA dhe Itali. Ato vazhdojnë të ofrojnë në mënyrë vullnetare leksione dhe trajnime për studentët e FE-së, duke sjellë përvojë ndërkombëtare dhe praktika bashkëkohore në procesin mësimor.

Standardi IV.14 Institucioni ka prioritet mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve dhe siguron mekanizmat për përfshirjen sa më shumë të tyre.

Në USH i jepet përparësi mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare, duke ndjekur një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj vendas dhe të huaj në projekte kërkimore, kjo realizohet me studentët që vijnë në kuadër të programit ERASMUS. Ndiquen politika bashkëpunimi me organizma shkencorë kombëtarë me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe të mobilitetit të stafit akademik e të studentëve (Evidenca 4.14.1/a/b/c) Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë realizuar takime të vazhdueshme me drejtues të IAL- ve publike dhe private dhe prej kohësh institucioni është pjesë e projekteve të ndryshme kërkimore me qëllim ngritjen shkencore të personelit akademik. Vlejnë për t'u përmendur mobilitetet në kuadër të pjesëmarrjes në

projekte me donator BE apo edhe në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe me universitete të rajonit apo më gjerë. (Ref. [Link](#)).

Stafi akademik dhe studentët kanë qenë të përfshirë gjerësisht në lëvizje drejt IAL-ve perëndimore. Të tilla kanë qenë pjesëmarrja e pedagogëve të angazhuar me programin Erasmus+ me Universitetin e Bergamos, me fokus mësimdhënien për periudha një javore. (Evidenca 4.14.2) Shumë profesorë kanë vizituar për periudha të shkurtra institucione të ndryshme ndërkombëtare, ku kanë dhënë mësim në universitete, vlen të përmendet bashkëpunimi me Universitetin e Vechta-s, Mesinës etj, gjithashtu pedagogë nga FSHSH japin mësim pranë Universiteteve në vendet fqinje.

Sa i përket studentëve të ciklit të parë, p.sh., studentët e FGJH-së, kanë pasur mundësinë të marrin bursa semestrale për të vazhduar një pjesë të studimeve pranë Universitetit në Vechta në Gjermani dhe në Haute -Alsace në Francë. (Evidenca 4.14.3)

Në faqen zyrtare të USH-së gjenden të publikuara nga Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë të gjitha informacionet e vlefshme për stafin dhe studentët për t'u njohur me mundësitë e bashkëpunimit dhe mobilitetet e dyanshme, si dhe zbatimin transparent të procedurave përkatëse (Evidenca 4.14.4) (Ref. [Link](#).)

Standardi IV.15 Institucioni siguron vazhdimësi dhe rritje të impaktit të tij në fushën e kërkimit shkencor/artistik.

Institucioni ka vazhdimësi në fushën e kërkimit shkencor/artistik, falë kapaciteteve të duhura që secili departament ka. Stafi merr pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, organizon veprimtari artistike dhe sportive me studentët, merr pjesë në projekte të ndryshme, në borde të ndryshme editoriale, etj. (Evidenca 4.15.1) (Evidenca 4.15.2) (Evidenca 4.15.3).

Pedagogë të USH-së janë pjesë e bordeve editoriale të revistës “Buletinit Shkencor” (Seria e Shkencave Shoqërore, Seria e Shkencave Didaktike etj.), si dhe në shumë projekte si: “Mësimdhënia e gjuhës angleze në epokën digjitale: edukimi për median dhe informacionin”, “Videochallenge in English: Media Literacy”. Pre-service Teachers in Northern Albania” është një projekt në kuadër të programit READ, Fellowship Program, mbështetur nga Albanian-American Development Foundation (AADF) (Ref. [Link](#)), (Evidenca 4.15.4/a).

Institucioni ndjek një politikë integruese duke dërguar ftesa kërkuesve të huaj kur organizon konferenca shkencore apo leksione të hapura. Këto ftesa bëhen në kuadër të ndërkombëtarizimit të universitetit si dhe të bashkëndarjes së njohurive në fusha të caktuara me institucione kombëtare private dhe publike bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit.

USH-ja publikon punimet shkencore të stafit akademik në “Buletin i shkencave” (i njohur nga të gjitha IAL-të në Shqipëri, pajisur me numër ISSN-je) dhe në botime të veçanta të pajisura nga Biblioteka Kombëtare me numër ISBN-je. Kërkimi shkencor pasqyrohet më së miri në monografitë dhe periodikët që boton çdo vit personeli akademik i USH-së. Rritja e botimit të artikujve dhe librave sjell edhe rritje të impaktit e cila sigurohet edhe me rritjen e numrit të botimeve në revista e botime me faktor të lartë impakti. USH-ja e inkurajon këtë, nëpërmjet pagesës së punimeve, stimulimit të projekteve, sigurimit të lidhjeve me Universitete e Rrjete etj. (Evidenca 4.12).

Një numër i konsiderueshëm profesorësh përfshihen në periudha të shkurtra studimi dhe mësimdhënie në universitete të huaja, duke krijuar mundësi për zhvillim profesional dhe përforsim të kapaciteteve kërkimore. Institucioni, nga ana tjetër, synon të integrojë studiues të huaj në veprimtarinë akademike përmes bashkëpunimit në mësimdhënie, pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare dhe evente të tjera shkencore të organizuara. Këto iniciativa kontribuojnë në rritjen e ndikimit shkencor të fakultetit dhe rritjen e cilësisë së veprimtarisë kërkimore. (Evidenca 4.15.4), (Ref. [Link](#)), (Evidenca 4.15.5).

Standardi IV.16 Institucioni siguron transferimin e rezultateve të veprimtarive kërkimore e shkencore në funksion të zhvillimit të vendit, ekonomisë dhe shoqërisë.

Institucioni ka një veprimtari të pasur shkencore, artistike dhe sportive. Në këtë mënyrë, impakti tek komuniteti është shumëdimensional. Redaksitë e ngritura në universitet, gjatë procesit të shqyrtimit të

artikujve dhe punës kërkimore-shkencore kujdesen që kjo punë shkencore të jetë origjinale, si dhe të ruhet pronësia intelektuale të cilën institucioni e mbron duke dhënë të drejta ekskluzive për studiuesit dhe duke promovuar veprimtarinë kërkimore botuese. Në projektet kërkimore ndiqet politika e nxitjes së përfshirjes së studiuesve të rinj. USH-ja aktivizon studentët e ciklit të dytë të studimeve me pjesëmarrje në konferenca shkencore të organizuara nga institucioni.

Në kuadër të transferimit të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor USH-ja ka nënshkruar marrëveshje me institucione private dhe publike brenda vendit. Një pjesë e madhe e praktikave profesionale të studentëve realizohen pranë bizneseve të ndryshme që veprojnë në rajonin e Veriut të Shqipërisë, si: Dhoma e Tregtisë, banka të nivelit të dytë, kompani, shkolla dhe institucione të tjera të ndryshme, etj. (Evidenca 4.16.1).

Departamenti i së Drejtës Publike dhe Klinika e Ligjit kanë zhvilluar projektin e titulluar “Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit për ndihmën juridike falas, përmes angazhimit të stafit dhe studentëve të Fakultetit të Drejtësisë”, i cili ka konsistuar në veprimtari shkencore (desk review dhe monitorim të zbatimit të legjislacionit) dhe aktivitete ndërgjegjësuere si dhënie e ndihmës ligjore parësore në shërbim të komunitetit (Evidenca 4.16.2).

Departamentet organizojnë trajnime profesionale në bashkërendim me DRAP dhe shkollat e qarkut në përputhje me nevojat e mësuesve dhe tregut të punës. Kjo është realizuar në bashkëpunim me ELTA, kryesisht për mësuesit aktual, por edhe për studentët.

Studentët janë përfshirë në trajnime e seminare, ku janë pajisur me dije shkencore në fushën e së drejtës (disa herë duke u certifikuar) dhe aftësi për të ofruar konsulencë, të cilën kanë pasur mundësi ta ushtrojnë më tej në ndihmë të komunitetit, përmes angazhimit edhe në OJF-të lokale, kryesisht lidhur me dhunën në familje, mbrojtjen nga diskriminimi, ndihmën juridike në përfitimin e shërbimeve etj. Një rol të rëndësishëm në rritjen e ndikimit shkencor të universitetit luan revista “Buletin shkencor” i USH-së, ndërkombëtarizimi i të cilit ka kontribuar në rritjen e cilësisë së artikujve të botuar dhe në afirmimin e punës kërkimore që zhvillon stafi akademik i USH-së, duke e pozicionuar këtë publikim si një platformë të rëndësishme shkëmbimi akademik në nivel rajonal. (Ref. [Link](#)).

Standardi IV.17 Institucioni garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato me qëllim zhvillimin ekonomik dhe financiar të tij.

USH-ja mbron pronësinë intelektuale duke dhënë të drejta ekskluzive për studiuesit dhe promovon veprimtarinë kërkimore botuese duke ndjekur politikën e inkurajimit dhe përfshirjes së studiuesve të rinj në fushën e kërkimit shkencor dhe duke aktivizuar vazhdimisht studentët me pjesëmarrje në konferenca shkencore apo projekte (Evidenca 4.17.1) Me mjaft interes është dhe zhvillimi i trajnimeve në fushën e mësuesisë, apo zhvillimi i veprimtarive sportive e artistike. (Ref. [Link](#), [Link](#)).

Kështu FSHN-ja ka shumë resurse, të cilat duhet të përdoren për rritjen financiare të tij. Mund të përmendim e Qendrën e Diagnostikimit Mikrobiologjik “Wolf Dieter Sixl”, Qendrën e Fizioterapisë që ofrojnë ndërmjet të tjerave edhe shërbim për të tretët. Në fazën përfundimtare është dhe laborator i Analizës Ushqimore, i cili do të mundësojë vlerësimin e cilësisë së ushqimeve në rajonin e Shkodrës. (Evidenca 4.17.2), (Evidenca 4.17.3).

Objektivi kryesor i USH-së në promovimin dhe mbështetjen e kërkimit shkencor përfshin krijimin e një mjedisi kërkimi të qëndrueshëm, të një kulture bashkëpunimi ndërmjet stafit akademik nga disiplina apo fusha të ndryshme studimi, si dhe bashkëpunimin e stafit akademik me studentët. USH-ja ka në qendër nxitjen e veprimtarisë së kërkimit shkencor nëpërmjet sigurimit të burimeve si dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së përshtatshme për zhvillimin e kërkimit shkencor (Evidenca 4.17.3). Mbrojtja dhe garantimi i pronësisë intelektuale apo rezultateve të tjera në fushën e kërkimit shkencor janë po ashtu në qendër të vëmendjes të strukturave përkatëse. Institucioni mundëson që këto dije e kërkime të reja shkencore të vihen në shërbim të shoqërisë, të zhvillimit të saj ekonomik dhe social apo të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore, gjuhësore, natyrore apo historike. Gjithsesi, më tepër mund të bëhet në këtë drejtim.

Përfundimet dhe Vlerësimi

USH-ja ka miratuar planin strategjik 2022-2026. Misioni i institucionit synon krijimin, zhvillimin, mbrojtjen dhe transmetimin e dijeve me anën e mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore. Me vendimin e Senatit Akademik nr. 97, nr. Prot. 1026, datë 29.02.2021, USH-ja ka përcaktuar qartë prioritetet e kërkimit shkencor:

1. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, me qëllim formimin e specialistëve të aftë.
2. Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor.
3. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara për studentët.
4. Monitorimi i cilësisë së programeve të studimit.
5. Përmirësimi i aksesit për studentët me nevoja të veçanta.
6. Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit.
7. Rritja e bashkëpunimit me komunitetin.

Çdo vit departamentet, dekanatet dhe Senati Akademik analizojnë punën mësimore-shkencore dhe nxjerrin në pah pikat e forta e të dobëta, me qëllim përmirësimin e punës. Gjithashtu, çdo vit SA miraton raportin e vlerësimit të brendshëm.

Secili departament planifikon punën e vet shkencore për vitin në vijim. Ka edhe bashkëpunime ndërmjet departamenteve për organizime konferencash apo veprimtarish të tjera.

Në planin strategjik të USH-së 2022-2026 rritja e cilësisë së kërkimit shkencor përbën një nga objektivat e punës në vazhdim. Theksi vihet tek botimet në revista prestigjioze, organizimi i një konference ndërkombëtare në nivel fakulteti, rritja e numrit të pedagogëve pjesëmarrës në borde editoriale ndërkombëtare, përmirësimi i angazhimit të studentëve në punë kërkimore-shkencore.

Institucioni garanton pronësinë intelektuale të punimeve shkencore dhe promovon publikimet, ndër to Buletinin e Shkencave, i cili ka arritur përhapje të gjerë rajonale.

Edhe pse ka pasur përpjekje të suksesshme nga ana e fakulteteve, duhet punuar akoma më shumë në drejtim të përfshirjes në veprimtaritë mësimore e shkencore/artistike të personelit të huaj akademik dhe diasporës.

USH-ja ka shumë resurse të cilat duhet të përdoren për rritjen financiare të institucionit. Mund të përmendim e Klinikën e Ligjit, Klinikën e Shërbimit psikologjik dhe social, Qendrën e Diagnostikimit Mikrobiologjik, Qendrën e Fizioterapisë, që ofrojnë ndërmjet të tjerave edhe shërbim për të tretët. Në fazën përfundimtare është dhe laborator i Analizës Ushqimore i cili do të mundësojë vlerësimin e cilësisë së ushqimeve në rajonin e Shkodrës.

Zyra e marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve.

USH-ja siguron organizimin dhe dokumentimin efikas të planeve mësimore të cikleve të ndryshme të studimit, në përmbajtjen e programeve harmonizojnë kompetencat e përgjithshme me ato profesionale. Kjo përmbajtje është në qendër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Institucioni vë në dispozicion kapacitete të mjaftueshme për realizimin e formimit praktik e profesional të studentëve. USH-ja garanton tekste mësimore cilësore dhe literaturë plotësuese që është në gjuhë shqipe si dhe gjuhë të huaj.

Institucioni ka ngritur struktura ndihmëse që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies por për t'iu përgjigjur standardeve të mësimdhënies është e domosdoshme të përditësohet teknologjia në përputhje me standardet bashkëkohore. Një praktikë e mirë është bashkëpunimi ndërmjet departamenteve në organizimin e aktiviteteve trajnuese.

USH-ja mbështet mobilitetin pedagogëve në universitete të tjera jashtë vendit nëpërmjet projekteve lidhur me eksperimentimin e mësimdhënies.

USH-ja ka tashmë një politikë të konsoliduar në kuadër të mbështetjes së punës kërkimore shkencore të personelit akademik, e cila realizohet më së miri nëpërmjet publikimeve të kërkimeve shkencore të stafit akademik në revista shkencore në fusha të ndryshme sipas fakulteteve. Institucioni është gjithmonë i gatshëm për të promovuar punën shkencore të personelit akademik, brenda dhe jashtë tij. Organizohen gjithmonë promovime të punimeve shkencore të personelit akademik apo edhe leksione

të hapura, konferenca në të cilat prezantohen dhe diskutohen punime të ndryshme shkencore të personelit akademik në USH dhe stafeve akademike nga Universitete të tjera brenda apo jashtë vendit. Në këto aktivitete shkencore ka gjithmonë pjesëmarrje të studentëve nga programeve të ndryshme të studimit.

USH-ja me qëllimin kryesor mbështetjen dhe promovimin e personelit akademik në kuadër të ngritjes profesionale të stafit ka vendosur të mbështesë stafin akademik me kohë të plotë duke financuar projektet kërkimore për pedagogët që janë pranë marrjes së titujve akademikë dhe për pedagogët që janë të angazhuar në kërkim shkencor.

Vlerësimi i fushës: Kjo fushë përmbush standardet plotësisht.

FUSHA V – STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve.

Procedura e pranimit të studentëve realizohet në përputhje të plotë me parimet e Ligjit Nr.80/2015 “ *Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë*” dhe me aktet normative të dala në zbatim të tij (Evidenca 5.1.1). Universiteti i Shkodrës ka të miratuar “*Statutin*” dhe “*Rregulloren e Studimeve*” (Evidenca 5.1.2/a), këto akte, përfshirë dhe Strategjitë, rregullojnë juridikisht të gjithë karrierën e ndjekjes së studimeve nga momenti i pranimit në universitet e deri në fazën e diplomimit (Evidenca 5.1.3). Politikat e pranimit të studentëve janë të mbështetura mbi bazën e kriterëve që lejojnë një përzgjedhje selektive. Përzgjedhja bazohet në kriterin e mesatares të vendosur me akte nënligjore si dhe mbi bazën e kriterëve të tjera. (Ref. [Link](#)).

Fillimisht kriteret e pranimit dhe numri i studentëve propozohen nga departamentet, miratohen në dekanat dhe pastaj kalojnë dhe miratohen nga Senati Akademik (Evidenca 5.1.4/a). Faqja zyrtare e institucionit siguron informacion mbi kuotat dhe kriteret e pranimit, përfshirë studentët nga Shqipëria dhe nga jashtë.

Gjatë përzgjedhjes respektohen parime kushtetuese që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi, ndërmjetësimin e target grupeve të ndryshme si edhe respektimin e kuotave për student që i përkasin pakicave kombëtare (Evidenca 5.1.5), po kështu, në faqen zyrtare publikohen listat e fituesve për secilin program studimi. (Evidenca 5.1.6).

USH-ja nëpërmjet njërive bazë dhe njërive kryesore (fakulteteve dhe departamenteve), si dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës bazuar në Statut dhe rregullore ofron informacion për studentët e ardhshëm (maturantë), për politikat e pranimit të studentëve dhe për organizimin e programeve të studimit. Kriteret e pranimit të studentëve në programet e cikleve të studimeve përcaktohen nga MAS nëpërmjet udhëzimeve dhe kuotave të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MAS për vitin akademik përkatës. (Evidenca 5.1.7)

Procesi i rekrutimit të studentëve të rinj fillon që me prezantimet e programeve të USH-së tek maturantët e shkollave të mesme të rajonit. Ky mision kryhet çdo vit nga grupe stafi akademik

të ngritura në fakultet, me anë të takimeve të organizuara sipas një agjende paraprake, me maturan të shkollave të mesme në kuadrin e “Ditëve të hapura”. Njësitë bazë, në bashkëpunim me njësinë kryesore, përcaktojnë pedagogët përkatës për secilën prej shkollave të mesme të Shqipërisë së Veriut. Gjatë këtyre takimeve bëhet informimi i të rinjve në lidhje me kuotat dhe kriteret e pranimit, si dhe mundësitë e ndryshme të studimit që USH-ja ofron duke parashtruar dhe eksploruar secilën alternativë studimi. Për secilin prej programeve të studimit pedagogët paraqesin edhe mundësitë që ofron tregu i punës në përputhje me formimin e studentëve të ardhshëm, në këtë mënyrë nxënësit janë më të qartë paraprakisht për drejtimit që mund të ndjekin pasi përfundojnë studimet Bachelor. Gjatë këtyre takimeve u jepen përgjigje pyetjet e ngritura nga nxënësit dhe bëhen diskutime të ndryshme etj.

Rregullorja e USH-së përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikën e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit deri në përfundim të studimeve apo transferimit të tyre, gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit. Kriteret e përgjithshme hartohen duke u bazuar në ligjin e arsimit të lartë dhe në formimin që marrin studentët në maturën shtetërore, duke iu dhënë më shumë përparësi formimit të përgjithshëm të studentëve nga shkolla e mesme. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. Informacione të vazhdueshme mbi kriteret e pranimit dhe listat e fituesve sipas rundeve të aplikimeve në USH paraqiten në faqen online të USH-së. (Ref. [Link](#)).

Pranimi i studentëve në ciklin e dytë të studimeve në programet Master Shkencor dhe Profesional është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të miratuara nga Senati Akademik pas propozimit nga departamentet. Kuotat dhe kriteret bëhen publike për të gjitha programet e studimit që ofron USH-ja duke u shpallur online në faqen zyrtare dhe në ambientet e godinave të fakulteteve.

Çdo cikël i studimeve në USH ndiqet dhe nga studentët e huaj, kryesisht nga trojet shqiptare jashtë territorit kombëtar, bazuar në marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe (theksuar kjo në rregulloret e studimeve dhe statutin e USH-së të përmendura më sipër). Procedura për pranimin e studentëve nga trojet shqiptare bazohet në udhëzimin e MAS Nr. 26, dt. 30.07.2018 (Ref. [Link](#)).

FE ofron mundësi për studentët e huaj të ndjekin lëndët e programeve ekonomike në gjuhën angleze dhe të përfshihen në eksperiencën shkëmbimesh akademike dhe kërkimore përmes programeve Erasmus dhe CEEPUS. Për shembull, një student nga Universiteti i Varshavës, Poloni, ka ndjekur një semestër akademik në Fakultetin Ekonomik, Shkodër, në kuadër të projektit Erasmus “Sigma”.

Në faqen web pasqyrohen vazhdimisht informacionet për kuotat dhe kriteret e pranimit ku përfshihen edhe kuotat e studentëve nga trojet dhe të huaj. (Ref. [Link](#), [Link](#)). Në këtë drejtim, departamenti Administrim- Biznes po punon për hapjen e bachelor në gjuhën angleze, si i pari program studimi i ofruar në gjuhë të huaj pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Në kuotat e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në USH për vitin akademik 2024-2025, përveç kuotave të kandidatëve brenda vendit, janë të parashikuara edhe kuotat e kandidatëve nga trojet (Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë), kandidatëve të huaj, personat me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, romë dhe ballkano - egjiptian.

Për këtë qëllim, në bashkëpunim me njësitë kryesore, departamentet caktojnë grupe për zhvillimin e takimeve me maturan të shkollave të mesme, kryesisht në zonat veriore të vendit, në kuadër të “Ditëve të hapura” apo panairove të punës dhe studimit, siç është pjesëmarrja në Panairin “Work and Study”: (Ref. [Link](#), [Link](#), [Link](#)). Takime të ndryshme të drejtuesve të USH-së dhe personelit akademik me maturan të shkollave në veriun e Shqipërisë janë organizuar dhe në trojet shqiptare në Malin e Zi: (Ref. [Link](#), [Link](#), [Link](#), [Link](#), [Link](#)).

Gjatë këtyre takimeve informuese, që zhvillohen sipas një agjende të përcaktuar paraprakisht, pedagogët që janë pjesë e grupit, i informojnë maturan të shkollave për kriteret e pranimit të studentëve

në programet e studimit të ofruara nga USH. Atyre u shpërndahen materiale të ndryshme informuese edhe lidhur me mundësitë e punësimit që ofrojnë këto programe studimi. (Evidenca 5.1.8).

Prezantimet në media janë gjithashtu pjesë e politikës së rekrutimit të maturantëve. Përveç se në faqen e USH-së ku publikohen listat e fituesve për secilin program studimi, kandidatët aplikues mund të informohen po ashtu edhe në sekretaritë mësimore. (Evidenca 5.1.9).

Standardi V.2 Institucioni u ofron mbështetje nëpërmjet shërbimeve universitare për të lehtësuar ecurinë e tyre .

USH-ja në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe Studentët, bazuar edhe në Statutin dhe Rregulloret e USH-së krijojnë një klimë të përshtatshme për të favorizuar kalimin e studentëve nga sistemi i arsimit të mesëm në atë të arsimit të lartë. Institucioni ofron informacion për studentët e ardhshëm si për politikën e pranimit ashtu edhe për organizimin e programeve të studimit. Java e parë e mësimit në fakultete i dedikohet njohjes së studentit të vitit të parë me “Rregulloren e studimeve” të Universitetit të Shkodrës si dhe me organizimin e programit respektiv të studimit apo stafin akademik.

Me vendim të posaçëm, Këshilli i Ministrave përcakton kategoritë që përjashtohen nga pagesa e tarifës dhe Bordi i Administrimit miraton kategoritë që përfitojnë e vit pas viti, ai harton strategji lidhur me përcaktimin e tarifave dhe kushtet e përjashtimit të studentëve.

Drejtoria e kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë dhe ajo e Marrëdhënieve me publikun dhe studentët, në USH, kanë bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Fakultetet raportojnë aty lidhur me çështje që i përkasin kësaj veprimtarie.

Zyra e Karrierës iu ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës, ajo mirëpret studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me plotësimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.

Institucioni ka pjesë të punës së tij të vazhdueshme mënyrën të organizimit të mësimdhënies, mbështetjen dhe kontrollin e këtij procesi nëpërmjet një plani të caktuar duke përdorur edhe sistemin e tutoriatit dhe të koordinatorëve të programeve të studimit. (Evidenca 5.2.1) Kohëzgjatja normale e studimeve në ciklin e parë të studimeve është 3 (tre) vite akademike. Numri total i krediteve që duhet të grumbullojë një student për finalizimin e këtij cikli studimi është 180 ECTS. Studentët programi studimi diplomohen me provim diplome ose tezë diplome dhe në përfundim lëshohet diploma përkatëse.

Në zbatim të Rregullores së USH-së dhe “Rregullores së studimeve”, lektorët informojnë qartësisht studentët lidhur me syllabuset e planin kalendrar të lëndëve, kriteret për vlerësimin e dijeve në lëndë të ndryshme të programit të studimit, duke përfshirë këtu: sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, format e kontrollit të dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, organizimin e provimeve, komisionet e provimit, zhvillimin e provimit, shpalljen e rezultateve të provimit, ankimimin dhe përmirësimin e notës. Studenti informohet edhe në mënyrë elektronike përmes emailëve zyrtarë të pedagogëve (@unishk.edu.al).

Personeli akademik i USH-së është gjithnjë i gatshëm që të komunikojë me kontakt direkt apo email në lidhje me informacionin për leksionet e lëndëve përkatëse, rastet studimore, detyrat e kursit e materiale të tjera. Pedagogët organizojnë seanca konsultimi mbështetëse për studentët në lëndët që ata mbulojnë, në lidhje me vështirësitë që mund të kenë pasur gjatë procesit mësimor. Konsultimet kryhen rregullisht nga pedagogët sipas orareve që afishohen në departamentet përkatëse. Gjithashtu sekretaritë mësimore kanë orare të caktuara pritjeje çdo ditë për nevojat apo sqarime të çështjeve administrative si regjistrime, data, etj.

Secili departament aplikon shërbimin e tutoriatit për studentët. Me studentët e viteve të para organizohen orë të hapura, ku studentët njihen me programin e studimit, me Rregulloren, Kodin

e Etikës etj. Çdo student ka të drejtë të ketë një pedagog mbikëqyrës për të përgatitur temën e diplomës, duke u orientuar dhe këshilluar në lidhje me literaturën e nevojshme apo me kriteret redaksionale. Problemet që studentët kanë përcillen nga pedagogu në departament, ku, zakonisht, gjejnë zgjidhje përmes bashkëpunimit me strukturat e tjera. (Evidenca 5.2.2)

Informacioni që u nevojitet studentëve është lehtësisht i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit nëpërmjet faqes së USH-së <https://unishk.edu.al/> ku gjendet i publikuar. Ai u vihet në dispozicion dhe u prezantohet studentëve që ditën e parë të fillimit të studimeve, nga tutorët e më pas u bëhet i njohur edhe gjatë prezantimit të syllabuseve nga pedagogët përkatës. Burimet e informimit të studentëve janë të shumëllojshme. Në faqen e USH-së publikohen të gjitha vendimet, urdhrat, njoftimet etj., të MAS-it, Senatit Akademik dhe të Rektoratit të USH-së që lidhen me procesin mësimor dhe studentët. (Ref. [Link](#), [Link](#))

Platformat e ndryshme si Teams, LMS, Pitagora përdoren me qëllim të komunikimit sa më të mirë me studentët dhe lehtësimin të procesit të mësimdhënies. Studentët, personeli akademik dhe ai administrativ janë të pajisur me një adresë e-maili personale (@unishk.edu.al) që e lehtëson dhe përshejton komunikimin e tyre. Përveç sekretarive mësimore, që ofrojnë shërbime të ndryshme për studentët një pjesë e departamenteve kanë hapur llogari në rrjetet e ndryshme sociale: (Ref. [Link](#), [Link](#)) duke i njoftuar studentët e tyre me informacione të nevojshme për ta. (Evidenca 5.2.3) (Evidenca 5.2.4) (Evidenca 5.2.5).

Faqe e zyrtare e USH www.unishk.edu.al

Faqe zyrtare e aktiviteteve <https://unishk.edu.al/aktivitete>

Standardi V.3 Institucioni përdor sistem efikas informimi për studentët.

USH realizon informimin e studentëve nëpërmjet faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale nëpërmjet të cilave informacioni shpërndahet më shpejt tek të rinjtë. Në faqen e universitetit janë të publikuara të gjitha informacionet që u nevojiten studentëve në lidhje me Rregulloren e Universitetit, Kodin e Etikës së USH-së si dhe të gjitha informacionet dhe udhëzimet që lidhen me programet e studimit. Faqja e internetit <https://unishk.edu.al> ka gjithë informacionin e nevojshëm të studentëve në lidhje me fakultetet e ndryshme dhe programet e studimit të ofruara nga secili fakultet (Evidenca 5.3.1) Në faqen përkatëse të fakulteteve gjendet informacioni i nevojshëm për studentët. (Ref. [Link](#), [Link](#)).

Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve u referohen rezultateve të vlerësimit të dijeve në raport me kreditet e përcaktuara për çdo kurrikul si edhe me vlerësimin e pikëzuar për çdo rast nga nota më e ulët kaluese deri të ajo më e larta. Sekretaria mësimore ka të ngritur sistemin e pasqyrimin të vlerësimeve dhe bën çdo vit veprimin e kalimit të studentëve nga një vit në tjetrin si dhe pasqyron mesataret e arritura në regjistrin përkatës.

Programet të cilat miratohen në departament, kanë të pasqyruar dhe numrin e krediteve (ECTS) që iu bëhen me dije studentëve. Gjithashtu, “Rregullorja e studimeve” ka të përcaktuar numrin e krediteve (ECTS) që i duhen studentit për të vijuar studimet. (Evidenca 5.3.2) Studentët njihen me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, përmes vendimeve të Dekanatit dhe “Rregullores së studimeve”. Dekanati përcakton modalitetet e vlerësimit për çdo rast, duke u bazuar në programet e lëndëve të paraqitura nga studentët dhe përputhshmërisë së tyre me programet e miratuara sipas departamenteve përkatëse, si dhe nivelin e përputhshmërisë dhe mbi bazën e tij realizon njohjen.

USH-ja ka krijuar një traditë shumë pozitive lidhur me politikën e komunikimit studentë-pedagogë. Një rol të konsiderueshëm luan edhe sistemi i menaxhimit të studentëve, më parë ESSE 3,tani Pitagora. (Evidenca 5.3.4), por në ndihmë të komunikimit sa më cilësor dhe të rritjes së cilësisë së mësimdhënies janë edhe platformat LMS, Moodle dhe Teams në institucionin tonë.

Secili pedagog, stafi administrativ dhe studentët janë të pajisur me një adresë elektronike të brendshme të personalizuar, gjë që lehtëson komunikimin pedagog-student-staf administrativ. Studentëve të çdo viti u caktohet tutor një pedagog i brendshëm i departamentit. Pedagogu tutor ndjek nga afër studentët që ka nën kujdestari dhe është në shërbim të tyre për çdo paqartësi që ata kanë (Evidenca 5.3.5/a) dhe çdo fillim viti akademik organizon takime me studentët e viteve të para ku ofrohet informacion për organizimin e programeve të studimit duke specifikuar objektivat dhe strukturën e moduleve, sistemin e vlerësimit në lidhje me kontrollin e dijeve përmes komponentëve të vlerësimit, gjetjen dhe pajisjen me literaturë, frekuentimin, detyrimet dhe metodologjinë e mësimdhënies si dhe me çështje etike të lidhura me aspekte studentore. (Evidenca 5.3.6; 5.3.7).

Në ambientet e USH-së ka postera informimi ku pasqyrohen kurrikulat, oraret mësimore dhe njoftime të ndryshme. Gjithashtu, pjesa më e madhe e departamenteve kanë krijuar faqet e tyre në rrjete të ndryshme sociale si elementë të rëndësishëm të përcjelljes së informacionit. Për çdo vit akademik, studentëve u vihet në dispozicion Manuali Studentor si udhëzues i plotë për procesin e studimeve (Evidenca 5.3.8).

Standardi V.4 Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale.

Studentët janë aktorë dhe partnerë të rëndësishëm për të siguruar cilësinë e programit të studimit. Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë” ka parashikuar në nenin 99, Këshillat e Studentëve. Institucioni në tërësi, por dhe fakultetet, kanë marrë masa për të organizuar Këshillin Studentor pranë tyre. Si organizma të pavarura studentore ato koordinojnë përfaqësimin e studentëve në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, kryesisht në Senatin e Universitetit. (Evidenca 5.4.1) Këshillat zgjidhen çdo dy vjet nga votat e studentëve. Në aspektin e sigurimit të cilësisë së programeve të studimit, Këshilli Studentor mund të shprehë mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm për programet e studimit, si për programet mësimore, planet mësimore, cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin e pedagogëve etj (Evidenca 5.4.2)

Studentët përfaqësohen në organet e drejtuese të USH-së sipas përqindjeve të përcaktuara në Statut; në Senat (Statuti i Universitetit të Shkodrës, neni 17, pika 11) dhe në Bordin e Administrimit (Evidenca 5.4.3) si dhe janë të organizuar në Këshillat me përfaqësues nga secili fakultet, rezultat i një procesi gjithëpërfshirës zgjedhor. (Evidenca 5.4.4 a/b/c/d).

Fakultetet kanë, gjithashtu, praktikën e përfshirjes së studentëve në vendimmarrje: KSGC-të dhe grupet e RVB-ve të programeve kanë në përbërje të tyre një student, i cili ka të drejtën të jetë pjesë e organizimeve të ndryshme të karakterit konsultativ si edhe të shprehë vlerësime lidhur me problematikat e konstatuara gjatë procesit vendimmarrës, ata janë pjesë edhe të Komisionit të Përhershëm që Mbikëqyr mbarrëvajtjen e veprimtarisë së USH-së dhe marrëdhëniet me studentët. (Evidenca 5.4.5/a)

Njësia kryesore dhe departamentet zhvillojnë takime periodike me studentë e grupe studentësh. Si pjesë e zhvillimit të mbledhjeve të departamentit, mbledhja e së martës së tretë apo të fundit të muajit është parashikuar të zhvillohet me studentët e programeve të ndryshme të studimit, për të diskutuar në lidhje me problematikat e ndryshme që u interesojnë studentëve. (Evidenca 5.4.6) Gjithashtu, stafi i pedagogëve ka për detyrë të respektojë oraret e pritjes së studentëve të vendosur nga secili departament dhe të afishuara në departamentet përkatëse. Përfaqësuesit e studentëve janë të ftuar të marrin pjesë në takimet dhe të shprehin mendimin dhe propozimet e tyre, rreth kurrikulave, programeve të studimit dhe rregulloreve. (Evidenca 5.4.7), (Ref. [Link](#), [Link](#), [Link](#), [Link](#)).

Standardi V.5 Institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve.

Zyra e Këshillimit të Karrierës është zyra kryesore për orientimin dhe këshillimin e studentëve. Ajo mirëpret studentët duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në

institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Që prej disa vitesh, kjo zyrë organizon akordimin e “Çmimit të Karrierës”. (Ref. [Link](#)).

Në bashkëpunim me fakultetet ndahen medaljet e arta për ish-studentët e suksesshëm, si dhe certifikata “Student i shkëlqyer” për studentët e këtij universiteti: (Ref. [Link](#)).

Informimi dhe orientimi i studentëve realizohet nëpërmjet teknologjisë së informacionit. Në faqen web të universitetit studentët mund të gjejnë informacione në lidhje me procesin mësimor, orarin e mësimave dhe provimeve, riprovimeve, tarifave të shkollimit, njoftimeve të llojeve të ndryshme që i përkasin procesit mësimor, aktiviteteve ekstrakurrikulare apo mobiliteteve dhe bursave të ofruara nga universitetet e huaja. (Evidenca 5.5.1).

Përveç orarit mësimor të rregullt, çdo departament në fakultet ka të shpallur një orar për konsultime me studentët për këshillimin e tyre. Fakulteti vë në dispozicion të studentëve materiale informuese si p.sh., rregulloret për çdo program studimi, guidën e fakultetit, programin e temave që përfshihen në provimin e diplomës, manual udhëzues për përgatitjen e diplomës etj. Në faqen web studentët mund të gjejnë gjithashtu informacione të ndryshmeve të strukturës, njoftime të llojeve të ndryshme që i përkasin aspektit mësimor, por edhe për mundësi të mobiliteteve si dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare. (Ref. [Link](#)). Thirrjet për trajnime, për aplikime kombëtare dhe ndërkombëtare jashtë vendi, për mundësi shkëmbimesh eksperiencë mësimore dhe kulture në vende të huaja, shpallen dhe përditësohen vazhdimisht në faqen web si dhe në faqet e mediave sociale të vetë fakulteteve. Informacioni i hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e avancimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin paraqitet qartë në “Rregulloren e studimit” si dhe në programin e studimeve. Njëkohësisht me sekretarinë mësimore edhe sekretaria e dekanit kanë orare pritjeje çdo ditë për të gjitha nevojat për informacion apo sqarime të studentëve. (Evidenca 5.5.2), (Evidenca 5.5.3), (Evidenca 5.5.4), (Ref. [Link](#)), (Ref. [Link](#)), (Ref. [Link](#)), (Ref. [Link](#)), (Ref. [Link](#)), (Ref. [Link](#)).

Në USH sekretaria mësimore orienton studentët që dëshirojnë të transferojnë programet e studimeve. Procesi është i dokumentuar dhe arkivuar edhe për të gjitha prurjet e studentëve nga IAL të tjera apo anasjelltas.

Në këtë kuadër departamenti i Romanistikës ka organizuar një ditë të veçantë informimi më 7 tetor 2024 ku ishin të pranishëm edhe nxënësit e shkollave të mesme ku këto gjuhë studiohen si gjuhë e parë (Evidenca 5.5.5). Në kuadër të informimit të studentëve të programit të studimit gjuhë italiane dhe gjuhë frënge, ky departament ka organizuar një takim informues me temë: “Ftojme dhe bashkëndajmë përvoja” (Ref. [Link](#)).

Gjatë muajit maj, Departamenti i Gjuhës angleze dhe i Gjuhës gjermane kanë zhvilluar takime me maturantët e shkollave të mesme “Shejnaze Juka”, “28 Nëntori”, “Jordan Misja”. (Evidenca 5.5.6), (Ref. [Link](#), [Link](#), [Link](#), [Link](#), [Link](#))

Standardi V.6 Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta dhe aktivitete jashtëkurrikulare.

USH respekton të drejtat e studentëve që u përkasin kategorive të veçanta dhe i mbështet ata gjatë procesit mësimor duke i lehtësuar aksesin në mësimnxënie dhe duke krijuar ambiente të përshtatshme që janë gjithmonë në përmirësim. Ka ndërtesa që janë pajisur me rampë në hyrjen e godinës dhe me ashensor, me qëllim lehtësimin e aksesueshmërisë për studentët me aftësi ndryshe. Dekanatet propozojnë në krye të çdo viti akademik numrin e kuotave për studentët që pranohen nga trojet ose pakicat. Kuotat miratohen nga Ministria e Arsimit dhe në çdo rast ka pasur një bashkëpunim të mirë në lidhje me këtë aspekt. Lidhur me kategoritë sociale të veçanta, të tillë si jetimë, studentë me aftësi ndryshe, viktimë të dhunës, studentë të punonjësve të policisë të rënë në krye të detyrës, akordohen edhe bursa që u përkasin programeve të studimit prioritare. Të gjitha informacionet si dhe mënyrat e aplikimit publikohen në faqen zyrtare të Universitetit <https://unishk.edu.al>. por mund të thuhet se ende ka disa mangësi lidhur me infrastrukturën që u mundëson atyre pjesëmarrjen në leksione dhe seminare. Njëkohësisht,

kandidatët që vijnë nga shtete të tjera për të kryer studime u nënshtrohen kushteve të përgjithshme të pranimit. Kriteret e hartuara publikohen në faqen web të universitetit në fillim të çdo viti akademik, zakonisht studentët që paraqesin interes vijnë nga trojet dhe shtetet fqinje. Për studentët me nevoja të veçanta FGJH ka krijuar mundësinë e realizimit të procesit mësimor në ambientet e katit të parë.

USH-ja ka pjesë të politikave të saj mbështetjen shumë dimensionale të studentit. Edhe FSHN kontribuon në këtë drejtim përmes përfshirjes dhe mbështetjes së studentëve në organizimin e aktiviteteve/projekteve kombëtare me karakter social, kulturor dhe sportiv. Në këtë mënyrë, Fakulteti përmes këtyre aktiviteteve kontribuon në përmirësimin e jetës studentore dhe plotësimin e saj me aktivitete ekstrakurrikulare.

Përveç mbështetjes për kategori të veçanta, Fakulteti Ekonomik inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet sportive dhe përkrah ata që angazhohen në sporte të niveleve të larta kombëtare dhe ndërkombëtare, si futboll, volejbol dhe basketboll.

Në faqen zyrtare të Universitetit shpallen datat e aplikimit dhe të regjistrimit për studentët që kanë mundësinë e përfitimit të lehtësirave financiare sikurse studentët me status të veçantë dhe studentët me aftësi ndryshe. (Evidenca 5.6.1) Fakultetet ofrojnë mbështetje dhe lehtësira shtesë për studentët me aftësi ndryshe, si p.sh., për studentët me dëmtime shikimi, vlerësohen vetëm në provim me gojë. Modulet e ndryshme dhe lëndët që ofrohen nga programet e studimit të FD- së dhe prania e Klinikës së Ligjit, mundësojnë studentët nga grupet e veçanta të marrin njohuritë e nevojshme në lidhje me të drejtat e tyre për trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim, veçanërisht përsa i takon të drejtës për arsimim (Evidenca 5.6.2). Nga përvoja ndër vite me studentë me aftësi ndryshe është vërejtur se studentët si p.sh., të FSHE-së dhe FSHN- së i mirëpresin studentët që janë në rrezik për marginalizim, i ndihmojnë ata dhe, një gjë e tillë ndikon pozitivisht te të gjithë studentët dhe te cilësia e mësimdhënies.

FSHSH organizon aktivitete të ndryshme me qëllim angazhimin e studentëve, bëhet pjesë e nismave dhe projekteve që vijnë nga organizata të ndryshme: (Evidenca 5.6.3) (Ref. 5.6.3.[Link](#), 5.6.4.[Link](#), 5.6.5. [Link](#), 5.6.6.[Link](#), 5.6.7.[Link](#), 5.6.8.[Link](#), 5.6.9.[Link](#), 5.6.10. [Link](#), 5.6.11.[Link](#), 5.6.12 [Link](#), 5.6.13.[Link](#), 5.6.14. [Link](#), 5.6.15.[Link](#), 5.6.16. [Link](#), 5.6.17.[Link](#), 5.6.18.[Link](#), 5.6.19.[Link](#), 5.6.20.[Link](#), [Link](#)), gjithashtu nxit studentët për të publikuar botimet e tyre në organe të ndryshme letrare e kulturore etj. (Ref. 5.6.22.[Link](#)) Po ashtu pedagogët e këtij fakulteti dhurojnë edhe botime të tyre jashtëkurrikulare për t'u shërbyer studentëve. (Evidenca 5.6.4) (Evidenca 5.6.5).

Vlejnë të përmenden edhe klubet studentore të cilat janë ngritur që në fillim të vitit akademik 2024-2025 si p.sh. Klubi studentor “English Club” në kujdesin e lektorese amerikane Marissa Foti, i cili gjatë vitit akademik 2024–2025, ka zhvilluar disa aktivitete të rëndësishme me fokus në gjuhën angleze dhe shkëmbimin ndërkulturor, të cilat kanë pasuruar jetën akademike dhe studentore. Departamenti i Romanistikës ka krijuar klubin studentor “Kulturë dhe Jo Vetëm”, i cili periodikisht ka realizuar aktivitete. Departamenti i Gjermanistikës ka krijuar klubin studentor “Klubi letrar”, i cili ka realizuar aktivitete, në bashkëpunim me pedagogen austriake Karoline Kuttner; klubi “Ernest Koliqi” dhe “Arshi Pipa” (Evidenca 5.6.6), Klubi Studentor “Ndhima e parë” (Ref. [Link](#)).

Standardi V.7 Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët.

Pedagogët e USH-së çdo vit akademik përpilojnë syllabuset e lëndëve në të cilat janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar të gjitha informacionet në lidhje me literaturën bazë dhe ndihmëse. Pedagogët vënë në dispozicion të studentëve tekste të autorëve të njohur në fushat përkatëse, leksione të printuara apo tekste të botuara nga pedagogët e USH-së apo edhe nga Universitete të tjera. Revista “Buletini shkencor” ku publikojnë kërkimin shkencor stafi akademik i USH-së shërben dhe si burim literature ndihmëse për studentët. Ai mund të gjendet në bibliotekën e universitetit si dhe *on line* në faqen zyrtare të universitetit me akses të hapur për të gjithë. (Ref. [Link](#), [Link](#)) (Evidenca 3.3)

Nevojat e studentëve për literaturë ndihmëse mund të përmbushen edhe nga Biblioteka e Universitetit të Shkodrës ashtu dhe bibliotekat brenda departamenteve të pajisura me literaturë bashkëkohore. Vlen të përmendet se biblioteka e USH-së ka një fond prej rreth 170 mijë librash. Godina aktuale e bibliotekës është një godinë bashkëkohore me tre kate dhe me sipërfaqe rreth 3000 m², e përfunduar në vitin 2006. Ajo është e pajisur me rafta librash që kanë një gjatësi 8 km linear dhe janë me një kapacitet mbajtës deri në 400 mijë libra. Aktualisht, 88% e fondit është i kataloguar elektronikisht dhe 51,520 tituj librash dhe 480 tituj periodikësh janë të aksesueshëm edhe nga jashtë. Fondi i bibliotekës përfshin rreth 112,100 ekzemplarë, nga të cilët 70,560 janë në gjuhë shqipe dhe 41,440 në gjuhë të huaj. Biblioteka ofron për përdoruesit e saj një sërë shërbimesh si: shërbimin e informacionit dhe të huazimit, vë në dispozicion të tyre mediatikën, me 26 vende multimediale, si dhe tri salla leximi me 300 vende leximi në total. Godina e bibliotekës ka në përbërjen e saj edhe sallën e konferencave “Hoeflechner”, me një kapacitet prej 120 vendesh, e cila mundëson zhvillimin e një sërë aktiviteteve të karakterit akademik, mësimdhënës apo promovues. Njëkohësisht, nëpër fakultete apo departamente ka biblioteka të cilat janë relativisht të pajisura me literaturë bashkëkohore, qoftë në shqip qoftë në gjithë të huaj. Këto biblioteka u shërbejnë studentëve në çdo kohë dhe disponojnë një kontingjent librash të cilat kanë burim kryesisht donacione nga fakultete të universiteteve partnere dhe organizata, kryesisht të huaja. Pozitiv është fakti se biblioteka e Universitetit është e aksesueshme lehtësisht nga pedagogë dhe studentë. Çdo vit, departamentet bëjnë kërkesat e veta për shtimin e literaturave bashkëkohore dhe periodike. Libra bashkëkohorë të literaturës ekonomike janë shtuar në bibliotekën e USH-së përmes përkthimeve të autorëve të njohur nga Fondi i Zhvillimit Shqiptar Amerikan (AADF) (Evidenca 5.7.1) (Evidenca 5.7.2) Ref. [Link](#) Ref. [Link](#), (Ref. [Link](#)), (Ref. [Link](#)).

Pranë Departamentit të Gjermanistikës është Biblioteka me një fond prej më shumë se 3000 librash, çdo student mund të hyjë lirisht në bibliotekë, të studiojë aty dhe/ose të huazojë libra. Gjithashtu, Biblioteka Austriake pranë BUSH-së, ka një fond shumë të pasur librash, dhe kjo bibliotekë pasurohet çdo vit me tituj të rinj, falë mbështetjes së vazhdueshme të Ambasadës Austriake, Tiranë.

Për të mundësuar konsultimin me literaturën bashkëkohore në disiplina të ndryshme shkencore vjen në ndihmë biblioteka digjitale e krijuar nga Ministria e Arsimit. Në bashkëpunim me RASH-in, Drejtoria e IT e USH-së ka siguruar mundësinë e përdorimit të këtij shërbimi për të gjithë pedagogët dhe studentët e universitetit në funksion të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimit shkencor. (Evidenca 5.7.2).

Biblioteka Universitare ofron qasje të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online. Ajo ofron po ashtu arkiv të digjitalizuar ([Arkivat Digjital | Biblioteka Universitare Shkodër](#)), si dhe ofron faqen e Bibliotekës, ku mund të gjendet informacion i përgjithshëm për bibliotekën dhe për OPAC ([OPAC | Biblioteka Universitare Shkodër](#)), që lejon kërkimin në gjithë fondin e BUSH-it. Po ashtu në shërbim të studentëve është ofruar edhe shërbimi elektronik U-library. Ref. 5.7.8.[Link](#)).

Biblioteka e Universitetit përmes strukturave të saj orientuese bën të mundur qasjen e studentëve në revistën “Buletini Shkencor” (me seritë përkatëse), që publikojnë artikujt dhe studimet shkencore të pedagogëve, të cilat shërbejnë edhe si burim literature ndihmëse për studentët, si në formën e librave ashtu edhe online në faqen zyrtare të Universitetit, me qasje të hapur për të gjithë (Ref. [Link](#), Ref. [Link](#)), (Ref. [Link](#))

Institucioni nëpërmjet financimeve të projektit T@ask/ Erasmus+ ka bërë një punë të mirë për shtimin e zërave në bibliotekë dhe përditësimin e fondit ekzistues në shërbim të njëjësive bazë të FSHSH-së. Një kontribut të veçantë në pasurimin e fondit të studimeve albanologjike dhe letrare japin edhe pedagogët e FSHSH-së, duke i dhuruar Fondit të Albanologjisë në BUSH, botimet e tyre, si monografi, ashtu edhe tekste universitare.

Standardi V.8 Institucioni favorizon punësimin e studentëve.

Programet e studimeve që ofrojnë njësitë bazë të USH-së hartohen dhe ofrohen edhe në përputhje të nxitjes së punësimit të studentëve dhe zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar, mbështetur në Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015 (Ref. [Link](#)); Statutin e USH-së (Ref. [Link](#)); Strategjinë e studimit të tregut të punës (Ref. [Link](#)), si edhe në “Strategjinë e Zhvillimit” të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” 2022-2026. (Ref. [Link](#)).

Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më të mirë me kërkesat e tregut të punës, personeli akademik konsultohet dhe merr parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe të partnerëve nga tregu i punës, si koordinatorët apo mentorët e praktikave profesionale që zhvillohen në ciklin e dytë të studimeve dhe stafi i Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër, me të cilët zhvillojnë konsultime dhe bashkëpunime.

Njësitë bazë po ashtu, kujdesen për përfshirjen e studentëve në aktivitete që rrisin informacionin e tyre për mundësitë e punësimit. Për të pasur një informacion më të plotë në këtë drejtim, në rang fakulteti është hartuar dhe “Studimi i Tregut të Punës”, por edhe në rang të njësisë bazë, p.sh. FSHE-ja, departamenti i Mësuesisë kanë një përvojë të mirë në këtë drejtim. Gjetjet e këtyre studimeve shërbejnë për një orientim më të qartë të studentëve. FSHN hedh, gjithashtu, bazat e punësimit të studentëve pas diplomimit përmes bashkëpunimit me institucione të ndryshme të rajonit sikurse lidhjeve me SRSB, DSHP, Klinika/laboratore private, Shkolla publike dhe private, etj (Evidenca 5.8.1).

Zyra e Këshillimit të karrierës dhe ALUMNI janë strukturat në nivel Universiteti që grumbullojnë dhe disponojnë të dhënat statistikore në lidhje me punësimin e studentëve. Zyra e Këshillimit të karrierës në faqen e Alumnit ka aktiv formularin e regjistrimit të studentëve që kanë mbyllur studimet në Universitetin e Shkodrës. Pasi plotësohet formulari të gjitha të dhënat ruhen në *database-n* e USH-së. (Ref. [Link](#), Ref. [Link](#)). Një nga pikat e formularit i referohet konkretisht punësimit aktual të të diplomuarit, pyetje e cila ka për qëllim analizimin e të dhënave në mënyrë që në të ardhmen të vlerësohet përputhshmëria e programeve të ofruara nga USH me kërkesat e tregut të punës, duke hedhur në këtë mënyrë hapat e parë drejt një studimi mbi tregun e punës (Evidenca 5.8.2). Fakulteti i Edukimit, Departamenti i Mësuesisë, ka bërë përpjekje me anë të pyetësorëve, (Evidenca 5.8.2/a), por duhet theksuar se stafi ka nevojë për asistencë për realizimin e një studimi të tillë. (Ref. [Link](#)).

USH-ja ndihmon punësimin e studentëve pas diplomimit përmes bashkëpunimit me institucione të ndryshme të rajonit sikurse lidhjeve me DAR-in, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Shkodrës dhe të tjerë aktorë, zhvillimit të praktikave, organizimit të Panairit të Punës në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, DRSHP-së dhe Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë. Ky panair, traditë e Fakultetit Ekonomik, krijon mundësinë e takimit midis punëkërkuësve (studentëve dhe të diplomuarve) dhe punëdhënësve (firmave dhe bizneseve të ndryshme) duke krijuar mundësi kontakti midis tyre. panairit të punës, etj. (Evidenca 5.8.3).

Fakultetet përpiqen të mbajnë kontakte të vazhdueshme me të diplomuarit pranë auditorëve të tij. Takime të organizuara me ALUMNI- n realizohen edhe në përvjetorë të USH-së dhe të Fakulteteve. Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon vazhdimisht aktivitete informuese për mundësitë e punësimit të rinjve brenda dhe jashtë vendit.

Universiteti i Shkodrës është në favor të punësimit të studentëve pasi, shumë ish-studentë janë tashmë pjesë e stafit akademik dhe administrativ të Universitetit. Gjithashtu, zhvillimi i praktikave profesionale me institucione të ndryshme me të cilat Universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi kanë ndihmuar në punësimin e studentëve, sepse disa studentë janë punësuar në këto institucione pas përfundimit të studimeve. Spitali Rajonal i Shkodrës dhe Drejtoria e Shëndetit Publik kanë të punësuar një pjesë të madhe të stafit nga degët e mjekësisë së FSHN-së. FD ka vendosur marrëdhënie me organet e drejtësisë në qarkun Shkodër, për dhënien e mundësisë studentëve të vitit të 5-të të programit të integruar të studimit “Master i Shkencave në Drejtësi” apo masterave Shkencore në të “Drejtë Kushtetuese dhe administrative” dhe të “Drejtë private dhe e biznesit” që të kryejnë praktikën profesionale për një periudhë 1 mujore

pranë këtyre organeve. Në zbatim të marrëveshjes së USH (lidhur me funksionimin e Klinikës së Ligjit (Evidenca 5.8.4) me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas (drejtori pranë Ministrisë së Drejtësisë), është krijuar mundësia prej tre vitesh që disa studentë të angazhohen për periudha 3-mujore pranë Zyrës për NJF-të që kjo drejtori ka të ngritur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. (Evidenca 5.8.5)

Stafi i departamentit të Romanistikës kanë zhvilluar takime me përfaqësues të Call-Center-ave Edernet dhe Transcom, ku operohet me gjuhën italiane dhe frënge. Departamenti i Romanistikës, me qëllim promovimin e programeve të studimit që ai mbulon, ka informuar nxënësit e shkollave të mesme që studiojnë gjuhën italiane dhe frënge për mundësitë e shumta të punësimit që krijohen përmes shkëmbimit në kuadër të marrëveshjeve të Erasmus me Universitetin Haute-Alsace dhe Universitetin Caen Normandie në Francë, si edhe Universitetin e Mesinës. (Evidenca 5.8.6).

FSHSH ka krijuar bashkëpunim me institucione dhe subjekte të ndryshme të rajonit, si me DAR-in, me qëllim të krijimit të lehtësive të punësimit të studentëve pas diplomimit të tyre. Përvojë pozitive në ndihmë për integrimin e studentëve në punësim kanë edhe projektet në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër (në hartimin e strategjisë së zhvillimit të qytetit), në bashkëpunim me Qarkun (për strategjinë e zhvillimit të turizmit në zonën e Dukagjinit), me TEULEDEN (për organizimin e panairove të artizanatit), me Dhomën e Tregtisë, REC-in dhe Bashkinë Shkodër (për organizimin e disa panairove të turizmit). Për aktivitete të tilla jepen informacione të hollësishme dhe publikime në media. (Evidenca 5.8.7).

Në favor të punësimit të studentëve është edhe vetë FE-ja e USH-së, ku nga 30 pjesëtarë të stafit akademik të punësuar me kohë të plotë pranë këtij universiteti, 25 janë ish-studentë të diplomuar në auditoret e tij. (Evidenca 5.8.8).

Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më të mirë me kërkesat e tregut të punës, personeli akademik konsultohet dhe merr parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe të partnerëve nga tregu i punës, si koordinatorët apo mentorët e praktikave profesionale që zhvillohen në ciklin e dytë të studimeve dhe stafi i Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër, me të cilët zhvillojnë konsultime dhe bashkëpunime. (Ref. [Link](#)).

Standardi V.9 Institucioni ruan lidhje të vazhdueshme me ish-studentët e tij.

USH ka infrastrukturën e nevojshme për të ruajtur evidencat e sakta lidhur me numrin e studentëve dhe të diplomuarve. Statistikat janë të pasqyruara në regjistrat përkatës dhe të informatizuara në sistem. Sekretaria mësimore disponon:

1. regjistrin themeltar të studentëve;
2. regjistrin e arritjeve akademike;
3. regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave;

ALUMNI është zyra kompetente në nivel Universiteti e cila ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon dhe mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe i vë ato në dispozicion studentëve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse. Për këtë vit akademik, Specialisti i ALUMNI-t ka konceptuar një formular në Microsoft Forms, i cili shërben për regjistrimin e studentëve në Alumni duke hedhur të dhënat e tyre personale dhe profesionale. (Ref. [Link](#)). Më pas, studenti do të ndiqet periodikisht për të kuptuar nëse është punësuar apo jo. Fakultetet, dërgojnë listat e studentëve në zyrën e ALUMNI -t dhe ajo mban kontakte të vazhdueshme lidhur me përditësimin e të dhënave. Disa prej tyre janë të punësuar në USH, si pjesë e administratës apo e stafit akademik. Disa të tjerë janë pjesë e GVB-ve dhe NJSBC-së së fakultetit. (Evidenca 5.9.1) (Evidenca 5.9.2). Ish-studentët ftohen në aktivitetet që organizojnë njësitë bazë.

Fakultetet, i kushtojnë rëndësi të veçantë ruajtjes së marrëdhënieve afatgjata me ish-studentë. Në këtë drejtim, në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë, Drejtorinë e Kurikulave është planifikuar studimi gjurmues për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve, kohë pas kohe

realizohen hulumtime në formën e pyetësorëve me ish-studentë për t'u njohur me shkallën e punësimit të tyre. Këto rezultate përdoren për studimin e tregut të punës në nivel të njësisë bazë. Departamenti Infermieri organizon trajnimet për edukimin në vazhdim për personelin shëndetësor dhe ka një lidhje mjaft të ngushtë me ish studentët. Në kuadër të lëndëve didaktike, pedagogët e FSHSH-së zhvillojnë herë pas here praktika pedagogjike pasive në shkollat ku japin mësim ish-studentë të diplomuar ndër vite në këtë fakultet. (Ref. [Link](#)). Fakulteti Ekonomik ruan kontakte të vazhdueshme me të diplomuarit e tij. Shembull i këtyre nismave është takimi “25 vite FE “apo “30 vite FE “, ku stafi dhe ish-studentët festuan së bashku. Takime të tilla shërbejnë për ndarjen e përvojave, rikthimin në kohë, si dhe krijimin e urave lidhëse ndërmjet brezave të ndryshëm (Evidenca 5.9.3).

Përfundimet dhe Vlerësimi

Procedura e pranimit të studentëve realizohet në përputhje të plotë me parimet e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” dhe me aktet normative të dala në zbatim të tij. Universiteti i Shkodrës ka miratuar *Statutin* dhe *Rregulloren e Studimeve*. Këto akte rregullojnë juridikisht të gjithë karrierën e ndjekjes së studimeve nga momenti i pranimit në universitet e deri në fazën e diplomimit. Politikat e pranimit të studentëve janë të mbështetura mbi bazën e kriterëve që lejojnë një përzgjedhje selektive. Përzgjedhja bazohet në kriterin e mesatares së vendosur me akte nënligjore si dhe mbi bazën e kriterëve të tjera. Gjatë përzgjedhjes respektohen parime kushtetuese që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi, ndërmjetësimin e target grupeve të ndryshme si edhe respektimin e kuotave për student që i përkasin pakicave kombëtare.

Ka një larmi burimesh informimi për studentët, krahas faqes zyrtare, si p.sh., guida përkatëse, broshurë informuese e USH-së. Po kështu, dekanati, sekretaria mësimore dhe sekretaria e dekanatit, si dhe njësitë bazë të fakultetit kanë orarin e pritjes së studentëve, me qëllim ofrimin e informacionit dhe sigurimin e mbështetjes së tyre për procesin mësimor apo problematika të tjera të lidhura me të. Secili departament në fakultete përcakton pedagogët tutorë për secilin program studimi që mbulon.

Çdo fillim viti akademik organizohen takime me studentët e viteve të para ku ofrohet informacion për organizimin e programeve të studimit, duke specifikuar objektivat dhe strukturën e moduleve, sistemin e vlerësimit në lidhje me kontrollin e dijeve përmes komponentëve të vlerësimit, kërkesat lidhur me literaturën, frekuentimin, detyrimet dhe metodologjinë e mësimdhënies si dhe me çështje etike të lidhura me aspekte studentore.

Një rol të konsiderueshëm luan edhe sistemi i menaxhimit të studentëve “PITAGORA”, i adoptuar nga USH në vitin akademik 2021.

Në ambientet e fakulteteve ka postera informimi ku pasqyrohen kurrikulat, oraret mësimore dhe njoftime të ndryshme. Gjithashtu, pjesa më e madhe e departamenteve kanë krijuar faqet e tyre në rrjete të ndryshme sociale si elementë të rëndësishëm të përcjelljes së informacionit.

Secili pedagog, stafi administrativ dhe studentët janë të pajisur me një adresë elektronike të brendshme të personalizuar, gjë që lehtëson komunikimin pedagog-student-staf administrativ. Në ndihmë të komunikimit sa më cilësor dhe të rritjes së cilësisë së mësimdhënies janë edhe platformat LMS, Moodle dhe Teams në institucionin tonë.

Në secilin fakultet sekretaria mësimore orienton studentët që dëshirojnë të transferojnë programet e studimeve. Procesi është i dokumentuar dhe arkivuar edhe për të gjitha prurjet e studentëve nga IAL të tjera apo anasjelltas.

USH-ja mbështet kategori sociale të veçanta, duke krijuar kushte lehtësuese dhe ambiente të përshtatshme për ta. Çdo vit akademik akordohen bursa studimi. Të gjitha informacionet si dhe mënyrat e aplikimit publikohen në faqen zyrtare të Universitetit.

